



**NOTIM
I PËRPARIMIT
TË ARRITJEVE
TË NXËNËSVE**

Udhëzime për shkollat

NCCA

National Council for Curriculum and Assessment
An Chomhairle Náisiúnta Curaclaim agus Measúnachta





NOTIM I PËRPARIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Udhëzime për shkollat

Ky përkujtues për arsimtarë është financuar nga populli amerikan përmes **Agjencisë së SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtar – USAID Maqedoni**, në kuadër të **Projektit të arsimit fillor**, komponenti *Përparimi i notimit të nxënësve*, të cilin e aplikon **Akademia për Zhvillim të Arsimit (AZHA)** në partneritet me **Qendrën Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ)**.



NOTIM I PËRPARIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE Udhëzime për shkollat

Titulli i origjinalit:
ASSESSMENT IN THE PRIMARY SCHOOL CURRICULUM:
Guidelines for Schools

Redaktor:

Mr. Gorica Mickovska

Përkthyes:

Zeqirija Ibrahim

Redaktor gjuhësor:

Zeqirija Ibrahim

Rregullimi grafik i botimit shqip:

Biljana Mihajlovska

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

373.3.091.279.9(035)

NOTIM i përparimit të arritjeve të nxënësve: udhëzime për shkollat /
[redaktor Gorica Mickovska; përkthyes Zeqirija Ibrahim]. - Shkup:
Qendren maqedonase për edukim qytetar, 2008. - 96 str.: ilustr.; 24 cm.

Превод на делото: Assessment in the primary school curriculum: guidelines
for schools. - Parathënie / Gorica Mickovska: str.6. - Библиографија: стр. 89–92

ISBN 978-608-4529-01-9

a) Оценување – Основно воспитание и образование – Прирачници
COBISS.MK-ID 75245834

ASS-400-002-ALB

Qëndrimet e autorëve të shprehura në këtë botim nuk i përfaqësojnë edhe qëndrimet e Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Përmbajtja

Parathënie	4
Hyrje	5
Tema 1: Rishqyrtimi i notimit	8
Cili është qëllimi i notimit në realizimin e programeve mësimore për arsim fillorë?	9
Çka përfshin notimi?	9
Si u zhvillua notimi pas botimit të materialit <i>Programet mësimore për arsim fillor</i> ?	10
Tema 2: Metodatat e notimit në mësim	14
Vetënotimi	16
Bisedat me nxënës	24
Notimi i portofolit	28
Përgatitja e hartave mendore	33
Parashtrimi i pyetjeve	39
Vëzhgimi i punës së nxënësve nga arsimtari	42
Detyra dhe teste të përgatitura nga arsimtari	49
Testimi i standardizuar	53
Tema 3: Qasje më e afërt ndaj NSHM-së dhe NAM-it	64
Grumbullimi i informacioneve	64
Regjistrimi i informacioneve të notimit	65
Interpretimi i informacioneve të notimit	65
Përdorimi i informacioneve të notimit	65
Raportimi për informacionet e notimit	66
Tema 4: Politika shkollore e notimit	70
Përmbajtja e politikës për notim	71
Pse duhet të notohet mësimi i fëmijëve?	71
Çka duhet të notohet?	71
Kur duhet të realizohet notimi?	72
Si duhet të notohet mësimi i fëmijëve?	73
Ku duhet të regjistrohen/evidentohen të dhënat e notimit?	73
Si duhet të regjistrohen/evidentohen të dhënat e notimit?	74
Me kë duhet të këmbëhen informacionet e notimit?	74
Si duhet të këmbëhen informacionet e notimit me subjekte të tjera?	74
Sa duhet të ruhen gjatë informacionet e notimit?	75
Shtojca Shtojca A	
Informacione plotësuese për metodatat e notimit në orë	78
Shtojca B	
Resurset për fotokopjim	85
Bibliografia	89

Parathënie

Notimi i përparimit të të arriturave të nxënësve është përkthim i publikimit të botuar nga Këshilli Kombëtar për Programe Mësimore dhe Notim i Republikës së Irlandës. Ky libër parimisht është përgatitur t'u ndihmojë shkollave të Irlandës për ta përmirësuar notimin, ndërsa ne e përkthym si material plotësues për nevojat e shkollave dhe arsimtarëve në komponentin *Përparimi i notimit* të Projektit të USAID-it për arsim fillor. Ky botim u përkthye me lejen e Këshillit Kombëtar për Programe Arsimore dhe Notim¹, për çka shumë ne jemi mirënjohës.

Në këtë botim janë prezantuar qasjet e njëjta drejt një notimi cilësor për të cilat angazhohet Projekti për Arsim Fillor i USAID-it, që në fakt janë në hap me trendët bashkëkohorë për vënien e notimit në funksion të përmirësimit të mësimit. Ne vlerësuam se mënyra se si është bërë kjo, si dhe shembujt e prezantuar në të, janë njësoj të zbatueshëm si në Maqedoni, ashtu edhe në Irlandë. Madje edhe lidhshmëria e disa pjesëve të tekstit me rregullat ligjore të Irlandës nuk e zbehin përdorimin këtyre qasjeve të ne.

Teksti është përkthyer pa kurrfarë ndryshimesh, përpos që janë lëshuar dy shtojcat e fundit që kanë të bëjnë me kërkesat që burojnë nga rregullat ligjore të Irlandës dhe rolin e disa institucioneve të ndryshme të Irlandës të cilat merren me mësimin fëmijëve.

Gorica Mickovska,
Udhëheqëse e komponentit
Përparimi i notimit
në projektin e USAID-it
për arsim fillor

¹ PSI General Licence No: 2005/08/01, Licence to Re-use Public Sector Information under the European Communities (Re-use Public Sector Information) Regulations 2005 (SI 279/05).

Hyrje

Dokumenti *Notimi i përparimit të të arriturave të nxënësve* është përgatitur për t'u ndihmuar arsimtarëve që t'i zgjerojnë njohuritë dhe të kuptuarit e tyre për notimin, si dhe t'u ndihmojë shkollave për të krijuar dhe zbatuar politikë notimi. Udhëzimet përmbajnë shembuj se si arsimtarët duhet të mbledhin të dhëna për përparimin dhe të arriturat e nxënësve, si t'i shfrytëzojnë informacionet e tilla për ta përmirësuar mësimdhënien dhe mësimin, si dhe si t'i informojnë për rezultatet e notimit të gjithë ata që janë të interesuar për arsimimin e fëmijëve.

Dokumenti i përmban katër tema. Tema 1 – *Rishqyrtimi i notimit i prezanton të dyja qasjet drejt notimit* – Notim për shkak të mësimit (**NSHM**) dhe Notimi i asaj që është mësuar (**NAM**). Këto qasje janë ndërtuar në bazë të katër qëllimeve për notim të cilat janë të ekspozuara në *Programet për arsim fillor* (1999) – formativ, përmbledhës, evaluativ dhe diagnostik. Kjo temë i përshkruan shkurtimisht qasjet NSHM dhe NAM, ndërsa detajet plotësuese janë dhënë në Temën 3.

Tema 2 – *Metodat e notimit në mësimdhënie* i pasqyron metodat e ndryshme të cilat shfrytëzohen nga arsimtarët gjatë notimit të të mësuarit të nxënësve. Këtu gjithashtu janë përfshirë edhe përshkrime se si duhet t'i shfrytëzojnë arsimtarët këto metoda, pastaj mbështetja e mësimit të nxënësve dhe përmirësimi i mësimit.

Tema 3 – *Pasqyra e detajuar e qasjeve NSHM dhe NAM* i krahason dhe kundërshton të dyja qasjet e notimit. Për të dëshmuar se si do të dukeshin në praktikë këto dy qasje, përdoren pesë aktivitete të notimit – grumbullimi i informacioneve, regjistrimi, interpretimi, shfrytëzimi dhe informimi.

Tema 4 – *Politika shkollore e notimit* – jep këshilla për zhvillimin e politikës për notim në shkolla. Janë theksuar kërkesat ligjore për regjistrim dhe komunikim të informacioneve për përparimin e të arriturave të nxënësve.

Në Shtojcën A janë dhënë informacione plotësuese për metodat e notimit në mësimdhënie si plotësim ndaj Temës 2 me materiale të cilat mund të fotokopjohen për disa metoda të paraqitura në Shtojcën B.



TEMA 1:

**RISHQYRTIMI
I NOTIMIT**



Tema 1:

Rishqyrtimi i notimit

Shembulli i aktivitetit 1. Notimi i praktikës

Sfera mësimore/ lënda mësimore:	Matematikë
Tema mësimore:	Masat
Njësia tematike:	Gjatësia
Detyra programore:	Fëmija duhet të aftësohet të llogarisë, krahasojë, masë dhe regjistrojë gjatësi duke përdorë njësi jostandarde.
Klasa:	E parë ose e dytë
Sfera:	Numra
Njësia tematike:	Operacione - Mbledhje
Detyra programore:	Fëmija të aftësohet të mbledhë numra me ose pa riemërtim deri në numrin 99.

Z-nja Kofej i organizon 26 nxënësit e saj të klasës së parë dhe të dytë në katër grupe – tre grupe me nga pesë fëmijë të klasës së dytë dhe një grup më të madh prej njëmbëdhjetë nxënësish të klasës së parë. Duke e plotësuar materialin për punë praktike nga ditët e mëparshme për grumbullimin e numrave me ose pa riemërtim deri në numrin 99, z-nja Kofej secilit grup të klasës së dytë ua parashtron një sërë problemesh me numra dhe një shportë me materiale (lëpirëse, katrorë, shkopinj kënddrejtë dhe shirita me numra). Fëmijët punojnë bashkërisht në zgjidhjen e problemit.

Ndërkohë z-nja Kofej punon me nxënësit e saj të klasës së parë në zhvillimin e aftësive të tyre për matje të gjatësisë duke shfrytëzuar njësi jostandarde. Pas bisedës se pse nevojiten njohuri për nocionin gjatësi, duke e ndërlidhur atë me aktivitetet e jetës së përditshme, ajo tregon se si matet gjatësia e një libri duke përdorë kuti shkrepësesh, pastaj si matet gjatësia e një bankë duke përdorë brusha për vizatim si dhe si matet gjatësia e klasës duke e matur me hapa. Z-nja Kofej kërkon nga fëmijët të punojnë në çifte (ose në grupe me nga tre nxënës) që ta matin gjatësinë e sendeve duke përfshirë fletoret e tyre të matematikës, çantat, shtrirjen e krahëve të tyre dhe bibliotekën e shkollës. Gjatë këtyre aktiviteteve ajo i mbikëqyrë fëmijët se si punojnë dhe bisedon me ta lidhur me qasjet e tyre. Ajo ua përkujton strategjitë e rëndësishme gjatë matjes, për shembull, vendosjen e njësisë matëse njëra pranë tjetrës (që të bashkohen të dyja skajet), vendosjen e njësisë së parë në skaj të sendit i cili matet, si dhe ofrimin e njësisë matëse derisa numërohen.

Pasi fëmijët t'i përfundojnë detyrat e tyre me matje, z-nja Kofej i fton t'i prezantojnë konstatimet e tyre si grup. Duke u dhënë informacione kthyesë përmes diskutimit, ajo u ndihmon t'i analizojnë shkaqet e dallimeve të mëdha ndërmjet konstatimeve të tyre. Këto dallime kryesisht ndodhin për shkak se nxënësit nuk i kanë vendosur njësitë matëse njëra pranë tjetrës, ndërsa disa të tjera janë si rezultat i gabimeve gjatë matjes. Duke e vërejtur se një numër i caktuar i nxënësve ka nevojë për ushtrime plotësuese për të qenë më preciz në matje, z-nja Kofej planifikon t'u japë detyra të njëjta edhe në ditën e ardhshme.

Kjo paraqitje e praktikës së një arsimtari në orë dëshmon se sa është notimi (ashtu siç sugjerohet në Programet mësimore për shkollë fillore) pjesë integrale e të gjitha sferave të programeve mësimore, si dhe fakti që ai i përfshin aspektet e llojllojshme të mësimit (Programet mësimore për arsim fillore, Hyrje fq. 18). Në këtë shembull procesi i notimit i siguron arsimtarit informacione të nevojshme për marrjen e vendimeve të rëndësishme për mësim dhe për procesin e mësimit – duke bërë zgjidhje të detyrave arsimore, duke i identifikuar metodat përkatëse mësimore, duke planifikuar aktivitete për mësim, duke zgjedhur materiale të volitshme, duke e dalluar mësimin dhe duke u dhënë nxënësve informacione kthyesë se si t'i zgjidhin detyrat më së miri. Aktivitetet e këtyra të përditshme e vendosin notimin në qendër të mësimdhënies dhe mësimit.

Cili është qëllimi i notimit në realizimin e programeve mësimore për arsim fillore?

Notimi ka të bëjë me: krijimin e pasqyrës për përparimin e të arriturave të fëmijës gjatë mësimit të programeve mësimore për shkollë fillore në periudhë të caktuar. Informacionet për atë se si mëson fëmija (procesi i mësimit) dhe për atë se çka është ajo që fëmija e mëson (produkti i mësimit) praktikisht e formojnë atë fotografi. Arsimtari i shfrytëzon këto informacione që t'i identifikojë dhe lavdërojë përparimet e deritanishme të mësimit të fëmijës, si dhe që t'i japë mbështetje të duhur në mësimet e mëtejme.

Çka përfshin notimi?

Për arsimtarin notimi përfshin grumbullim të informacioneve me qëllim që ai të jetë në dijeni se si përparon secili fëmijë në shkollë dhe informacionet e tilla t'i shfrytëzojë që t'i ndihmojë fëmijët në mësim. Andaj notimi është diçka më tepër se testimi. Ai ka të bëjë me bashkëveprimet e përditshme ndërmjet arsimtarit dhe secilit fëmijë një nga një, të cilat përfshijnë biseda të herëpashershme, mbikëqyrje dhe veprime.

Notimi paraqet proces të **grumbullimit, regjistrimit, interpretimit dhe shfrytëzimit** të informacioneve, si dhe proces **të raportimit** për përparimin dhe të arriturat e nxënësit në përvetësimin e diturive, aftësive dhe qëndrimeve.


Pavarësisht nga ajo se a parashton arsimtari pyetje dhe a i dëgjon përgjigjet e fëmijëve, a i mbikëqyrë fëmijët se si punojnë në ndonjë detyrë apo a i shfrytëzon rezultatet e ndonjë testi javor që të japë informacione për mësimdhënien dhe mësimin, notimi përfshin shumë aktivitete të cilat përputhen dhe shpeshherë janë të njëpasnjëshme, siç janë: grumbullimi, regjistrimi, interpretimi, shfrytëzimi dhe raportimi i informacioneve.

Aktivitetet e tilla ndodhin për disa sekonda ose në periudhë disaditëshe ose disajavëshe, varësisht nga qëllimi i notimit dhe metodat të cilat shfrytëzohen. Informacionet e grumbulluara e pasurojnë të kuptuarit e arsimtarit për atë se çka dhe si mëson nxënësi. Arsimtari i shfrytëzon informacionet e këtyra për t'i planifikuar aktivitete për mësim duke u bazuar në qëllimet adekuate arsimore të programeve

mësimore dhe në bazë të asaj që fëmija e ka mësuar më parë. Përmes notimit arsimtari fiton një fotografi gjithëpërfshirëse për nevojat afatshkurtra dhe afatgjate të fëmijës dhe, sipas kësaj, e planifikon punën e mëtejme (Programet mësimore për arsim fillore, Hyrja fq. 17). Duke i shfrytëzuar informacionet e notimit, arsimtari ofron përkrahje dhe e zgjeron mësimin e nxënësit.

Prandaj notimi paraqet pjesë të asaj që arsimtari e bën për çdo ditë në mësimin e tij, mu siç është paraqitur në diagramin 1.

Diagrami 1: Notimi si pjesë e mësimdhënies



Si u zhvillua notimi pas botimit të materialit “Programet mësimore për arsim fillor”?

Programet mësimore për arsim fillor në korniza të përgjithshme e theksojnë domethënien e notimit që t’i mundësojë arsimtarit ta zgjerojë dhe pasurojë mësimin fëmijëve në të gjitha sferat e programeve mësimore. Në vitet e fundit hulumtimet, teoria dhe praktika në mësimdhënie dhe mësim e theksojnë në mënyrë më specifike problemin se si mund ta përdorë arsimtari notimin që ta bëjë mësimin më interesant, më motivues dhe më të suksesshëm për çdo fëmijë. Duke i shfrytëzuar këti njohur të reja, udhëzimi përmban *Rishqyrtim të notimit* në shkollën fillore dhe i siguron arsimtarit informacione dhe shembuj që udhëzojnë se si ta zbatojë notimin në praktikën e përditshme.

Në *Programet mësimore* theksohet se notimi i ka katër funksione – formativ, përmbledhës, evaluativ dhe diagnostik. Në *Rishqyrtimin e notimit* këta udhëzime bazohen në ato funksione dhe fokusohen në dy qasje kryesore të notimit:

- notim për shkak të mësimit (**NSHM**);
- notim i asaj që është mësuar (**NAM**).

Këta aktivitete të ndërsjella dhe komplementare i theksojnë të dyja aspektet e notimit të cilat kanë vend qendror në punën e arsimtarit:

- Arsimtari për çdo ditë i shfrytëzon të dhënat si bazë për mësimdhënie dhe mësim (**NSHM**);
- Në periudha të caktuara arsimtari e regjistron përparimin e të arriturave të fëmijëve me qëllim që t’i informojë prindërit², arsimtarët e tjerë dhe personat e tjerë relevantë. (**NAM**).

² Në këto udhëzime termi *prind* ka të bëjë me ato persona që kujdesen para së gjithash për zhvillimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre. Ata janë babai dhe nëna e fëmijës dhe/ose tutorët e tij.

Notimi për shkak të mësimit (NSHM)

Koncepti i notimit për shkak të mësimit (**NSHM**) i zgjerohet mundësitë e notimit formativ. Ai e thekson rolin aktiv të fëmijës në mësimin e tij në mënyrë që arsimtari dhe fëmija pajtohen lidhur me atë se si duhet të jenë rezultatet e mësimit, si dhe cilat duhet të jenë kriteret e vlerësimit të rezultateve të arritura. Parimisht **NSHM-ja** i ndihmon arsimtarit dhe fëmijëve të fokusohen në tri çështje kryesore::

- **Ku janë (deri në çfarë shkalle kanë arritur gjer tani)** fëmijët në mësimin e tyre?
- **Ku (në çfarë drejtimi)** fëmijët përparojnë në mësimin e tyre?
- **Si** do të arrijnë fëmijët deri te **faza tjetër** në mësimin e tyre?

Prandaj, vetë fakti që fëmijëve u jepen informacione kthyesë, kjo ka rol qendror në **NSHM**. Këto informacione kthyesë bazohen në të dhëna për atë se si dhe çka mësojnë fëmijët. Informacionet kthyesë të orientuara kah mësimi që është në rrjedhë e sipër ose kah ndonjë detyrë e caktuar mund t'u ndihmojnë fëmijëve ta identifikojnë përparimin e tyre dhe të jenë të kënaqur me të arriturat, t'i përcaktojnë në mënyrë precize sfidat me të cilat ballafaqohen dhe të vendosin se cilët do të jenë hapat e tyre të ardhshëm. Ky nivel i inkuadrimit në formësimin e mësimit të tyre mund ta shtojë njohuritë e fëmijëve për veten e tyre si nxënës, t'i nxisë ata të ndërmarrin përgjegjësi më të madhe personale dhe të krenohen me mësimin e tyre.

NSHM-ja zakonisht nuk praktikohet në fund të ndonjë pjese të materialit mësimor ose në një periudhë të caktuar kohore. Ajo rëndom është e pranishme në bashkëveprimin e përditshëm gjatë orëve ndërmjet arsimtarit dhe nxënësit. Gjithçka bëjnë dhe tregojnë nxënësit – duke parashtruar pyetje, duke punuar në ndonjë projekt ose detyrë të pavarur ose në bashkëpunim me fëmijët tjerë, duke luajtur, duke konceptuar ose përgatitur ndonjë model etj. – mundëson që arsimtari dhe fëmijëve t'u sigurojë informacione për atë se çka kuptojnë e çka nuk kuptojnë, çka mund e çka nuk mund të bëjnë. Duke e shfrytëzuar **NSHM-në**, arsimtari i interpreton ato informacione dhe i shfrytëzon që t'u ndihmojnë fëmijëve në punën e tyre si dhe të bëjnë plane të mëtejme. Në atë mënyrë arsimtari mund ta integrojë **NSHM-në** në bashkëveprimin mes tij dhe fëmijës, ndërsa fëmijët atë do ta konsiderojnë si pjesë natyrore të mësimit në shkollë.

Gjithashtu arsimtari mund t'i shfrytëzojë informacionet e **NSHM-së** për ta vlerësuar punën e tij. Në bazë të informacioneve të grumbulluara nga fëmijët, arsimtari mund të bëjë ndryshime në planet e tij, në strategjive që kanë të bëjnë me organizimin e mësimit, si dhe në metodat e mësimdhënies me qëllim që ta bëjë mësimin më të suksesshëm për fëmijët.

Notimi i asaj që është mësuar NAM

Për dallim nga ajo që u tha më sipër, notimi i asaj që është mësuar **NAM** më shumë fokusohet në notimin afatmesëm dhe afatgjatë. **NAM-i** zakonisht përfshin notim të asaj që ndonjë fëmijë e ka mësuar në fund të ndonjë periudhe të caktuar, siç është në fund të një mësimi, në fund të javës, gjysmëvjetorit ose në fund të vitit shkollor. Theksi i

NAM-it qëndron në matjen e arritjes kumulative të fëmijës në përvetësimin e qëllimeve të programeve mësimore. Shpeshherë nota ose shumica e notave të fituara është informacioni i vetëm kthyes të cilin e merr fëmija. Nëse rezultatet e këtyre të shërbejnë vetëm arsimtarit, ato mund të kenë vlerë të kufizuar për fëmijën, përveç nëse arsimtari përmes tyre nuk i identifikon informacionet thelbësore të cilat ata i ofrojnë për përparimin dhe të arriturat e fëmijës dhe ato ia prezanton fëmijës. **NAM-i** gjithashtu i ndihmon arsimtarit ta planifikojë punën e ardhshme, të parashtrorë detyra të reja, të sigurojë informacione kthyesë periodike, si dhe informacione për notim në fund të vitit shkollor.

Arsimtari i shfrytëzon informacionet e **NAM-it** që ato para së gjithash t'ua komunikojë prindërve dhe arsimtarëve të tjerë. Inspektori i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës mund të ketë qasje në të dhënat e notimit që kështu ta vërtetojë se a po realizohen standardet për mësimin e gjuhës dhe të matematikës dhe/ose ta vlerësojë përparimin në realizimin e programeve mësimore si pjesë të procesit të tërësishëm të evaluimit të shkollës. Gjithashtu shërbimi pedagogjikopsikologjik mund të ketë qasje në informacionet e grumbulluara përmes **NAM-it** me qëllim që të punojë bashkë me shkollën në përmbushjen e nevojave arsimore të nxënësve të caktuar.

Në Temën 3 të këtyre udhëzimeve në mënyrë më të hollësishme janë paraqitur **NSHM-ja** dhe **NAM-i** dhe akronimet janë shënuar me shkronja të errëta që të dallohen më lehtë. Aty krahasohen dhe bëhet dallim i qartë ndërmjet të dyja qasjeve duke i shfrytëzuar pesë aktivitetet në procesin e notimit: mbledhjen, regjistrimin, interpretimin, shfrytëzimin dhe raportimin e informacioneve për avancimin e të arriturave të nxënësit.



A black and white photograph of a young boy sitting on a large, white, inflatable ball. He is wearing a shiny, patterned, long-sleeved outfit and dark boots. He is smiling and looking towards the camera. The background is a dark, dense hedge or wall of bushes. The ground is grass. A white, tilted rectangular box is overlaid on the right side of the image, containing text.

TEMA 2:

**METODAT
E NOTIMIT
NË MËSIM**

Tema 2: Metodat e notimit në mësim

Kjo temë përmban informacione hyrëse për llojlojshmërinë e metodave për grumbullimin dhe shfrytëzimin e informacioneve për atë se sa mësojnë fëmijët në shkollë. Zgjedhja e metodave bëhet sipas mbikëqyrjes dhe parashtrimit të pyetjeve si pjesë e mësimin të përditshëm, deri në metodat më formale dhe më të strukturuar, siç është testi standard. Duke bërë kombinimin të metodave, arsimtari arrin në të dhëna për përparimin e të dhënave të fëmijëve. Në bazë të këtyre të dhënave, ai planifikon se si t'u ndihmojë nxënësve në mënyrë më efektive në mësimin e tyre në të ardhmen.

Nuk ka nevojë të testohet gjithë ajo që e mëson fëmija, madje as që ka nevojë të jepet notë për gjithçka. Në bashkëpunim me kolegët, arsimtari mund t'i shfrytëzojë Programet mësimore për arsim fillor që kështu t'i përcaktojnë prioritetet për çka duhet të aftësohet fëmija për dituritë, aftësitë, vlerat, qëndrimet dhe prirjet. Nganjëherë ai fokusohet në mësimin e fëmijës që ka të bëjë vetëm me një lëndë mësimore, ndërsa herë tjera punon bashkërisht për më tepër lëndë. Pasi të vendosë se **çka** duhet të notojë, arsimtari përcakton se si do të notohet ajo dhe si do të shfrytëzohen informacionet e notimit.

Pjesën më të madhe të notimeve arsimtari e bën me intuitë, ndërsa një pjesë e caktuar planifikohen me përkushtime të posaçme. Notimi intuitiv dhe notimi i planifikuar kompletohen dhe të dy janë të nevojshëm nëse arsimtari duhet të fitojë pasqyrë gjithëpërfshirëse për përparimin e secilit fëmijë. Për shembull nëse grupit të nxënësve më të rritur derisa i ofrohet ndihmë për të bërë plan për elaborimin e vizitës së tyre në parkun më të afërt, arsimtari vëren se njëri prej fëmijëve nuk e ka të saktë pikën "a", ndërsa fëmija tjetër bën gabim edhe në pikën "b", "c" dhe "ç". Kjo mund ta nxisë që arsimtari të planifikojë mbikëqyrje të orientuar kah këta fëmijë gjatë disa ditëve të ardhshme. Përmes mbikëqyrjes së fokusuar, arsimtari mund ta identifikojë nevojën për t'i ndihmuar ndonjë fëmijë në përgatitjen e formulimeve të theksuara në pikat "c", "o", "ç", "p". Përmes interpretimit të një pjese të madhe të informacioneve për atë se si i shkëmbejnë fëmijët dituritë – me fjalë të veta, përmes heshtjes, përmes aktiviteteve të tyre dhe bashkëveprimeve, arsimtari mund ta balancojë notimin intuitiv dhe të planifikua, ashtu që secili nxënës të ketë dobi nga kjo.

Kjo temë i ndihmon arsimtarit t'u përgjigjet pyetjeve vijuese:

- Si do të **notoj**?
- Si do t'i **shfrytëzoj** informacionet që do t'i grumbulloj?

Në këtë temë janë dhënë informacione për tetë metoda të notimit dhe tregohet se si mund të shfrytëzohen ato për **NSHM** dhe **NAM** (shih Temën 1 dhe Temën 2). Ato metoda janë: vetënotimi, bisedat me nxënësit, notimi i portofolit, përgatitja e hartave mendore, parashtrimi i pyetjeve, vëzhgimi i nxënësve nga arsimtari, detyra dhe teste të përgatitura nga arsimtari dhe testimi i standardizuar.

Përkundër asaj që ekzistojnë shumë metoda të tjera të cilat arsimtarët mund t'i shfrytëzojnë dhe në fakt i shfrytëzojnë, në këto udhëzime shfrytëzohen tetë metodat e dhëna që kështu të paraqitet llojlojshmëria e metodave për notim, si dhe dobia e kombinimit të tyre. Asnjë metodë për notim vetvetiu nuk do t'i sigurojë arsimtarit informacione të dobishme që do të mjaftojnë. Në fakt secila metodë përfshin edhe shfrytëzim të metodave të tjera në përmasa të mëdha ose të vogla; për shembull, përgatitja e detyrave nga arsimtari mund të përfshijë edhe parashtrim të pyetjeve dhe mbikëqyrje të fëmijëve.


Në këto udhëzime secila metodë përshkruhet në pikëpamje të pyetjeve vijuese:

- **Cili është qëllimi i kësaj metode të notimit?**
- **Si përdoret ajo metodë?**
- **Cilat informacione duhet të regjistrohen?**
- **Si do të përdoren ato informacione?**

Metodat janë paraqitur përmes shembujve nga praktika. Shembujt e këtyre, të theksuara si **shembuj reprezentativë të aktiviteteve**, ndihmojnë që të tregohet se si funksionojnë ato metoda në orët e mësimin. Shembujt reprezentativë të aktiviteteve fokusohen në lëndë të caktuara mësimore ose në sfera të programeve mësimore dhe në nivele të caktuara klasore. Megjithatë, shumica e metodave të tilla mund të shfrytëzohen edhe në lëndë ose sfera të tjera të programeve mësimore, madje mund të adaptohen edhe për nivele tjera klasore³. Shembujt reprezentativë të aktiviteteve fillojnë me pasqyrë të shkurtër të sferave relevante të programeve mësimore, pastaj vijon lënda, tema, njësia tematike, qëllimi programor dhe niveli klasor që bën pjesë në *Programet mësimore për shkollën fillore*, që mund të shihet ose shkarkohet në ueb-faqen <http://www.curriculumonline.ie>. Në shembujt reprezentativë, të cilët fokusohen në mësimin e gjuhës angleze shfrytëzohet shenja "/", janë paraqitur temat përkatëse mësimore si dhe njësitë tematike. Kjo strategji i merr parasysh informacionet e dhëna në *Materialin ndihmës plotësues për gjuhë angleze* të botuar në vitin 2005.

³ Në disa prej shembujve reprezentativ të aktiviteteve përmendet emri i arsimtarit, ndërsa në disa të tjerë përmendet mbiemri i tij. Kjo e reflekton llojlojshmërinë e praktikës së shkollave fillore në Irlandë.

Diagrami 2: Vazhdimësia e metodave të notimit



Tetë metodat për notim në diagramin 2 janë paraqitur në vazhdimësi. Metodatat e vëna në anën e majtë janë ato në të cilat fëmija ka rol drejtues në vlerësimin e punës së tij, ndërsa në anën e djathtë të madhësisë së vazhduar janë ato metoda në të cilat arsimtari ka rol të rëndësishëm në udhëheqjen e notimit. Përkundër asaj që asnjë metodë nuk përdoret vetëm për **NSHM** ose vetëm për **NAM**, ato në anën e majtë të vazhdimësisë (në të cilat fëmija ka rol kryesor) zakonisht më shumë janë të fokusuar në **NSHM**, ndërsa ato në anën e djathtë zakonisht janë të fokusuar në **NAM**.

Diskutim për metodatat e notimit në këtë temë shkon sipas radhitjes së paraqitur në diagramin 2. Secila metodë është paraqitur si pjesë e posaçme.

- Vetënotimi fq. 16
- Bisedat me nxënësit fq. 24
- Notimi i portofolit fq. 28
- Përgatitja e hartave mendore fq. 33
- Parashtrimi i pyetjeve fq. 39
- Vëzhgimi i punës së nxënësve nga arsimtari fq. 42
- Detyra dhe teste të përgatitura nga arsimtari fq. 49
- Testimi i standardizuar fq. 53

Vetënotimi

Çka nënkupton vetënotimi?

Fëmijët përfshihen në vetënotim kur e shqyrtojnë punën e tyre personale në një mënyrë reflektive, kur i identifikojnë aspektet e gjërave që janë në rregull dhe ato që mund të përmirësohen, e pastaj parashtrojnë qëllime personale për mësimin tyre të mëtejshëm.

Vetënotimi e përfshin metakognicionin – proces i të qenit i vetëdijshëm dhe të menduarit për mësimin. Aftësitë për vetënotim e përfshijnë parashtrimin efektiv të pyetjeve, të menduarit, zgjidhjen e problemeve, analizat komparative dhe aftësinë për shkëmbimin e mendimeve në mënyra të ndryshme. Vetënotimi mund të shfrytëzohet nga fëmijët e niveleve të ndryshme të aftësive dhe në të gjitha sferat arsimore. Nëse këto mënyra të vetënotimit janë në përputhje me moshën, ato mund të shfrytëzohen gjatë tërë shkollës fillore dhe në të gjitha lëndët mësimore. Diskutimet me tërë paralelen, bisedat nëngrupe ose bisedat individuale paraqesin bazë për vetënotim.

Duke i parë shembujt e vetënotimit në mësim, fëmija mund t'i shfrytëzojë aftësitë për vetënotim në përgatitjen e drafteve, revidimeve, rregullimeve dhe botimeve të një pjese të punimeve të tija me shkrim. Ai mund t'i shfrytëzojë këto aftësi gjatë zgjedhjes së shembujve më të mirë të punës së tij dhe t'i përfshijë ato në portofolin e lëndës së shoqërisë, ekologjisë dhe të shkencave natyrore, në portofolin e edukatës mjekësore (shoqërore dhe personale) ose në atë të artit figurativ. (Shih Temën 2, fq. 28-32 për informacione më të hollësishme për notimin e protolisë). Vetënotimi gjithashtu mund të ketë rol kritik në përpilimin, prezantimin dhe shënimin e kompozicioneve muzikore. Mbatja e portofolit si evidencë personale për përparimin dhe revidimi i përmbytjes së tij e nxit fëmijën për vetënotim duke i ndihmuar t'i qartësojë qëllimet dhe të parashtrojë qëllime të reja mësimore. Portofoli mund të shfrytëzohet që të nxitet të menduarit verbal dhe joverbal, si dhe të bëhet zhvillimi i aftësive më të ndërlikuara mendore. Për ta dokumentuar vetënotimin dhe të menduarit e fëmijës për produkte ose përmbledhje personale, mund të shfrytëzohet ditari për mësim.

Cila është vlera e tij si një nga metodat e notimit?

Vetënotimi është pjesë thelbësore e **NSHM-së**. Ai i mundëson fëmijës të ndërmerren përgjegjësi më të mëdha për mësimin e tij. Fëmija mund të shfrytëzojë strategji të ndryshme kur mendon për atë çka ka mësuar si dhe mund të shfrytëzojë një grup të kriterëve që të japë gjykime për atë që është mësuar. Strategjitë më të suksesshme janë ato që paraprakisht janë caktuar ndërmjet arsimtarit dhe paraleles. Vetënotimi i ndihmon fëmijës t'i dallojë hapat vijues në suazat e mësimin të tij dhe të bëhet sa më i pavarur dhe më i motivuar. Duke e zhvilluar vetëbesimin, ai ndihet më i sigurt dhe e di se jo gjithnjë për gjithçka ka përgjigje të drejtë. Në këtë mënyrë vetënotimi kontribuon në krijimin e klimës pozitive në orët në të cilat analiza e gabimeve konsiderohet si çështje qendrore në procesin e të mësuarit. Rezultatet e vetënotimit të fëmijës (p.sh. ditarët e mësimin, portofolat, punimet me shkrim) mund të kontrollohen së bashku me prindërit e tyre në takimet e caktuara të prindërve

me arsimtarin. Kjo mund t'u japë prindërve më shumë informacione për mësimin e fëmijës nga pikëpamja e vetë fëmijës.

Si përdoret vetënotimi?

Aftësitë për vetënotim duhet të përvetësohen në një periudhë më të gjatë kohore. Kjo përfshin një proces të vazhdueshëm afatgjatë i cili planifikohet në nivel të paraleles ose në nivel të shkollës. Aftësitë të cilat i nevojiten fëmijës ai mund t'i mësojë nga arsimtari, gjegjësisht arsimtari mund t'ia modelojë ato. Fëmija i shfrytëzon këto aftësi përdërisa nuk krijon shprehje që lirshëm t'i shfrytëzojë ato në mënyrë të pavarur.

Arsimtari mund ta nxitë fëmijën të mendojë për punën e tij duke shfrytëzuar pyetje të dedikuara, gjegjësisht instrumente ose mjete ndihmëse. Për shembull, ato përfshijnë fletë për notim analitik, dritare koordinuese *Di, Dua të dijë, Mësova* (DDM), diagrame *Plus, Minus, Interesant* (PMI), shkallë, semaforë, partnerë për biseda (shokë), çek-lista dhe fletë të dritareve (për më shumë informacione lidhur me instrumentet e vetënotimit, shih Shtojcën A, fq. 78-79). Arsimtari mund t'i inkorporojë qëllimet dhe kriteret arsimore për sukses në diskutimet e orëve. Atëherë fëmija do të mund të mësojë ta notojë punën e tij sipas atyre qëllimeve ose kriterëve arsimore. Duke i dhënë fëmijës informacione kthyesë pozitive arsimtari do të mund t'i ndihmojë atij në dallimin dhe ndërmarrjen e hapave të tjerë përkatës për mësim.

- Cilat gjëra të reja i mësova?
- Cilat gjëra konsideroj se janë të vështira?
- Çka bëra që t'i ndihmojë vetvetes në detyrat e vështira?



Shembull i aktivitetit 2.1. Përdorimi i fletës për vetënotim

Fusha programore:	Art figurativ
Lënda mësimore:	Artet vizuale
Tema mësimore:	Përgatitja e konstruksioneve
Njësia tematike:	Mbikëqyrja dhe reagimi
Detyra programore:	Të aftësohet fëmija ta kontrollojë punën e tij dhe të bisedojë për të dhe për punën e fëmijëve tjerë.
Niveli klasor:	Klasa e tretë dhe e katërt

Z. Birn ua dha fëmijëve të klasës së tretë dhe të katërt një detyrë që të përgatisin model të urës. Ata tashmë kishin mësuar për shumë lloje të urave gjatë disa orëve të kaluara. z. Birn me këtë detyrë dëshironte t'ua bëjë me dije se ata i kuptojnë funksionet kryesore të një ure, konstruksionin dhe karakteristikat e saj. Fëmijët duhet ta shfaqin planin e urës së vizatuar dhe duhet të tregojnë se pse ura është bërë në atë mënyrë. Ata mund të shfrytëzojnë çfarëdo materialesh përkatëse për ta përpunuar urën. Arsimtari tashmë ka diskutuar me fëmijët në klasë për elementet e rëndësishme të planifikimit dhe të përgatitjes së një modeli të këtitillë. Tabela (fleta) vijuese për vetënotim shfrytëzohet pasi të përgatitet modeli.

Shembull i fletës për vetënotim analitik

Karakteristikat	1	2	3
Plani	Përgatita plan për modelin tim me pak detaje	Përgatita plan për modelin tim me shumë detaje	Përgatita plan shumë tëdetajuar për modelin tim
Drafti	Nuk i paraqita karakteristikat e rëndësishme të urës	I paraqita vetëm disa karakteristika të modelit tim	E paraqita shumicën ose të gjitha karakteristikat
Materialet	Materialet e përdorura për përgatitjen e urës nuk ishin adekuate	Vetëm disa nga materialet e përdorura ishin adekuate	Të gjitha materialet e përdorura ishin shumë të duhura
Pse u përgatit ura në këtë mënyrë	Këtë nuk e kam shpjeguar	Këtë e shpjegova pjesërisht	Këtë e shpjegova shumë mirë
Pamja	Si duket ura ime është në rregull	Ura ime ka pamje të mirë	Ura ime ka pamje shumë të mirë

Fëmijët e plotësojnë fletën analitike duke e shënjuar ose ngjyrosur nivelin e duhur të cilësisë të cilin konsiderojnë se e paraqet modeli i tyre. Duke bërë dallime ndërmjet aftësive të fëmijëve, z. Birn u ndihmon disa fëmijëve të përdorin fletë analitike, ashtu që do t'i shfrytëzojnë pohimet dhe do të bisedojnë për atë se çka mendojnë ata për cilësinë e urave të tyre.

Variacionet në këtë fletë analitike ndoshta mund të kenë lidhje me zgjerimin e cilësisë, mbase në katër nivele. Për shembull, për fëmijët që kanë përvojë më të madhe në përdorimin e notimit analitik kjo mund të përfshijë edhe njoftimin e tyre me standardet e pritura ose me nivelet e cilësisë para se ata të fillojnë me përgatitjen dhe demonstrimin e modeleve të këtitilla, duke u treguar modele të ngjashme të përgatitura nga fëmijët e tjerë.

Shembulli i aktivitetit 2.2. Përdorimi i pyetjeve për vetënotim

Fusha programore/ lënda mësimore:	Matematikë
Tema mësimore:	Forma dhe hapësira
Njësia tematike:	Format 3-D
Detyra programore:	Të aftësohet fëmija për ta studiuar lidhjen ndërmjet formave 2-D dhe 3-D.
Niveli klasor:	Klasa e parë dhe e dytë

Shkolla në të cilën jep mësimin Rej një kohë e zbaton vetënotimin me fëmijë e klasave të para deri në klasë të gjashtë. Meqenëse fëmijët e klasës së parë dhe të dytë tashmë kanë punuar me vetënotim, ata janë mësuar me këtë proces. Rej shpeshherë i nxit ata të punojnë në çifte ose në grupe të vogla dhe të diskutojnë se si ndjehen lidhur me mësimin e tyre. Nganjëherë ai punon bashkërisht me të gjithë fëmijët.

Në muajin maj në fund të një ore nga lënda e matematikës për llojet e formave ai i nxit fëmijët të mendojnë dhe të flasin për atë që e kanë mësuar. Pastaj për ata ai përgatit disa

pyetje të dedikuara:

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Ku hasa në probleme? • Çka bëra? • Çka më ndihmoi më së shumti? | <ul style="list-style-type: none"> • Kë e pyeta për të? • Cilën punë të re e mësova? |
|---|--|

Ai ua sugjeron fëmijëve disa përgjigje të mundshme, pastaj u jep dy minuta për të menduar. Duke punuar me tërë paralelen, Rej i dëgjon përgjigjet e fëmijëve për secilën pyetje.

Ahmedi	(posedon aftësi të mira kritike): <i>Unë mendoj se është vështirë të mbahet mend dallimi ndërmjet formave 2-D dhe 3D.</i>
Tomi	(ka mbështetje plotësuese në mësim): <i>Disa emra janë të vështirë për të shprehur.</i>
Kjara:	<i>E po, unë i kontrollova format 3-D në këndin e matematikës për emrat që nuk munda t'i mbaj mend.</i>
Shejni:	<i>Unë posa e pyeta Darën.</i>
Mari-Kleri:	<i>Unë e mësova fjalën kuadër.</i>
Ana:	<i>Kuadri është i njëjtë me katrorin.</i>

Duke i pasur parasysh komentet e fëmijëve, Reji bëri porositi më shumë libra për format gjeometrike, këto për nevojat e bibliotekës së shkollës. Ai gjithashtu u furnizua me disa programe kompjuteristike për koleksionin me softuer arsimor. Ai i nxit fëmijët të kërkojnë në libra dhe në programe për t'i gjetur kështu përgjigjet e disa pyetjeve të tyre.

Pesë pyetjet për vetënotim të shënuara me shkronja të mëdha i var në tabelën e shpalljeve në klasë. Pastaj gjatë disa javëve në fund të orës së matematikës u jep kohë të caktuar që të mendojnë për pyetjet. Derisa ata përgjigjen në pyetjet e dhëna, ai u jep mundësi tre fëmijëve më të aftë të tregojnë se për cilat gjëra mendojnë se kanë qenë të vështira, ashtu që të gjithë në paralele mund të shohin se secili gjatë mësimit mund të ballafaqohet me ndonjë sfidë dhe se një gjë e tillë është normale!

Shembull i aktivitetit 2.2. (vazhdim)

Rej zakonisht i nxit nxënësit t'i shprehin përgjigjet e tyre gojarisht. Nganjëherë kërkon që ata t'i shënojnë përgjigjet e tyre, edhe pse është i vetëdijshëm se vetënotimi i fëmijëve mund të shtrihet vetëm në atë që për fëmijët është më e lehtë ta shkruajnë. Nganjëherë ai bisedon me nxënës të caktuar lidhur me mundësinë që ata vetë ta notojnë punën e tyre. Për regjistrim arsimtari mund të shfrytëzojë edhe çek-listë të cilën paraprakisht e ka përgatitur. (Shiko shembullin e dhënë më poshtë.)

Shembuj të listës për vetënotim

Data: 01.10.07 Emërtimi i sendeve 2-D				
Emri	katrori	kënddrejti	rrethi	trekëndëshi
Klasa e parë				
Klara	✓	✓	✓	✓
Nuri	E përzien katrorin me kënddrejtin.		✓	✓
Klasa e dytë				
Julia	✓	✓	✓	✓
Peti	E përzien katrorin me kënddrejtin.		Nuk mund ta emërtojë.	Nuk mund ta shqiptojë.
Xhesi	✓	✓	✓	✓

Çek-lista i ndihmon Rejit ta orientojë planifikimin e orëve dhe njëherazi i ndihmon t'i përcaktojë gjërat për çka dëshiron të bisedojë me prindërit e fëmijëve kur ata të kërkojnë takim me të më vonë gjatë vitit shkollor.

Shembull i aktivitetit 2.3. Shfrytëzimi i fletës së evaluimit për vetënotimin grupor

Fusha programore:	Edukimi shoqëror, ekologjik dhe natyror-shkencor
Lënda mësimore:	Gjeografi
Tema mësimore:	Mjedisi natyror
Njësia tematike:	Toka, lumenjtë dhe detet në vendin tim
Detyrat programore:	Të aftësohet fëmija t'i dallojë emrat dhe lokalitetet e karakteristikave të caktuara natyrore në vendin e tij.
Niveli klasor:	Klasa e tretë dhe e katërt
Tema mësimore:	Mjedisi natyror
Njësia tematike:	Karakteristikat fizike të Evropës dhe të botës
Detyra programore:	Të aftësohet fëmija të mësojë diçka për një numër të vogël të karakteristikave kryesore natyrore të Evropës.
Niveli klasor:	Klasa e pestë dhe e gjashtë

Zonja Kaningam mban mësim në rajonin Galvej. Ajo u jep mësim njëzet fëmijëve nga katër grupe klasore – klasa e tretë, e katërt, e pesë dhe e gjashtë. Paralelet e klasës së tretë dhe të katërt mësojnë për disa karakteristika fizike të rajonit Galvej, ndërsa paralelet e saj të klasës së pestë dhe të gjashtë mësojnë për karakteristikat e Evropës. Të dyja grupet kanë mundësi të shfrytëzojnë projektor digjital dhe tabelë interkative që t'i zumojnë (zmadhojnë dhe zvogëlojnë) karakteristikat e hartave relevante gjeografike. Fëmijët e klasës së tretë dhe të katërt angazhohen në zumimin e një fotografie të shkollës së tyre të incizuar nga lartë, si pjesë e mësimin të rajonit tyre.

Që ta kuptojë se çka kanë mësuar fëmijët e paraleleve të ndryshme, zonja Kaningam u parashtron atyre detyra të diferencuara. Klasat e ulëta punojnë në grupe që ta gjejnë gjirin Galvej. Lof Korib, malet Maamturk, malet Partri, ishujt Aran, Inishbofin dhe katër karakteristika të tjera sipas zgjedhjes së tyre, me ç'rast në njërin prej tyre nuk do të ketë hartë. Fëmijët e tjerë punojnë gjithashtu në grupe që në një hartë memece të Evropës ta gjejnë shumicën e objekteve gjeografike të cilat i kanë mësuar. Fëmijët mund ta shfrytëzojnë kompjuterin në klasë si ndihmë gjatë realizimit të detyrave të tyre. Zonja Kaningam kërkon prej tyre t'i ekspozojnë punimet e tyre. Para se të fillojnë paralelet t'i realizojnë detyrat e tyre, ata iniciojnë diskutim për atë se cilat kritere do të zbatohen që të arrihet sukses. Me një ndihmë të caktuar të znj. Kaningam ata merren vesh për tre kriteret vijuese.

Kriteret e suksesit:

- Karakteristikat e objekteve gjeografike duhet të caktohen saktësisht.
- Hartat gjeografike duhet të jenë të lexueshme qartë.
- Hartat gjeografike duhet të jenë të vizatuara.

Paralelet fillojnë me punë në grupe të vogla.

Shembull i aktivitetit 2.3. (vazhdim)

Pasi që secili grup do ta paraqes punën e vetë, zonja Kanningham u jep fëmijëve një kohë ta caktuar të mendojnë për atë që e kanë mësuar, si kanë punuar së bashku në grupe dhe deri në çfarë shkalle i kanë përmbushur kriteret e tyre të suksesit. Pastaj të gjithëve ua jep nga një fletë për evaluim dhe ua lë një kohë ta caktuar për ta plotësuar atë. Ajo u ndihmon disave fëmijëve më të vegjël dhe disa fëmijëve me aftësi më të pakta. Pastaj inicion diskutim për idetë e tyre dhe u ndihmon t'i regjistrojnë ato. (Shih fletën për evaluim të plotësuar nga Aoife.)

Shembull i fletës për evaluim

Emri:	Data:
<i>Aoife O' Saliven</i>	<i>10.9 '07</i>
1. Për çka mësove në Gjeografi? <u><i>Mësua për Evropën.</i></u>	
2. Shënoi tre gjëra të cilat i mësove për këtë temë. <u><i>Londra është buzë lumit Temzë. Alpet janë vargmali më i lartë. Mali Vezuv është në Itali.</i></u>	
3. A u dëshmove si anëtar i mirë i ekipit? <u><i>Po.</i></u>	
4. Navedi edna pri-ina za tvojot odgovor. <u><i>Unë e zbatova studimin duke kërkuar informacione në ueb-faqe, ndërsa të tjerët bënin kërkime të tjera.</i></u>	
5. Çka do të mund të bënte më mirë ekipi yt për herën tjetër? <u><i>Do të mund ta shënjonim hartën gjeografike më mirë.</i></u>	

Komenti i arsimtarit:

Aoife, detyra jote projektuese është përgatitur mirë. Harta gjeografike e ekipit tënd mund të lexohet lehtë!

Zonja Kanningham deri në fund të javës i lexon të gjitha fletët për evaluim. Të premtën ajo ua kthen fëmijëve dhe u jep një kohë të caktuar t'i lexojnë komentet e saj. Përderisa nxënësit e paraleles një nga një i lexojnë fletët e tyre, zonja Kanningham i nxit ata fëmijë të cilët dëshirojnë të diskutojnë me të lidhur me komentet e saj.

Shembull i aktivitetit 2.4. Shfrytëzimi i tabelës DDM për vetënotim

Fusha programore/ lënda mësimore:	Matematika
Tema mësimore:	Numrat
Njësia tematike:	Thyesat
Detyra programore:	Të aftësohet fëmija t'i shprehë thyesat e parregullta si numra të përzier dhe anasjelltas – t'i vendosë në boshtin numëror.
Niveli klasor:	Klasa e pestë dhe e gjashtë

Inion Ui Murçu mban mësim me klasën e pestë. Ajo i ka në paralele dhjetë ose shtatë fëmijë. Shumica prej tyre janë me aftësi të ulëta matematikore. Konceptet abstrakte për ta paraqesin sfidë të posaçme. Të premtën në mëngjes Inion Ui Murçu shpjegon se gjatë javës së ardhshme do të punojnë me thyesa. Ajo e përsërit materialin i cili tashmë është mësuar. Në fund të orës për përsëritje ajo i nxit fëmijët t'i plotësojnë tabelat e tyre DDM (çka di, çka dua të di, çka mësova).

Disa tabela DDM të fëmijëve janë paraqitur më poshtë

Tabela DDM e Shonit

Emri: <u>Shon</u>		
Data: <u>3 dhjetor</u>		
Lënda: <u>Matematikë – Thyesa</u>		
D (Çka di)	D (Çka dua të di)	M (Çka mësova)
<i>Thyesat janë më të vogla se një.</i>	<i>Dua të di për thyesat e parregullta. Zita di shumë për to.</i>	
Plotësoje në fillim të mësimit		Plotësoje në fund të mësimit

Tabela DDM e Adit

Emri: <u>Adi</u>		
Data: <u>3 dhjetor</u>		
Lënda: <u>Matematikë – Thyesa</u>		
D (Çka di)	D (Çka dua të di)	M (Çka mësova)
<i>Thyesa mund të grumbullohen deri në numrin një.</i>	<i>Nuk e kuptoj se çka është numri i përzier</i>	
Plotësoje në fillim të mësimit		Plotësoje në fund të mësimit

Gjatë planifikimit të orëve të matematikës për javën e ardhshme Inion Ui Murçu me të shpejtë i lexon tabelat e plotësuara. Ajo e kontrollon se a i ka përfshirë të gjitha njësitë e theksuara në kolonën Çka dua të di; për shembull, identifikimi i numrave të përzier nga mjedisi i drejtpërdrejtë i fëmijëve (numri i këpucëve, paketimi i produkteve ushqimore), si dhe studimi se çfarë domethënie kanë ato numra. Gjatë javës ajo e nxit çdo fëmijë të punojë në përmbajtjen e detyrës për të cilën dëshiron të dijë diçka më tepër. Disa fëmijë sjellin shembuj nga shtëpia, disa të tjerë kontrollojnë në programet kompjuterike, të tjerët e shfrytëzojnë internetin që të gjejnë informacione, ndërsa disa të tjerë lexojnë në librat e bibliotekës ose në librat shkollorë. Disa fëmijë i parashtronë pyetje Inion Ui Murçus ose ndonjë nxënësi. Para se ta përfundojë punën me thyesat Inion Ui Murçu, ajo kërkon nga çdo fëmijë ta plotësojë tabelën e tij duke e theksuar së paku një përmbajtje që e ka mësuar.

Shembull i aktivitetit 2.4. (vazhdim)

Disa tabela DDM të fëmijëve janë paraqitur më poshtë.

Tabela DDM e Shonit

Emri: Shon
 Data: 14 nëntor
 Lënda: Matematikë – Thyesa

D (Çka di)	D (Çka dua të di)	M (Çka mësova)
<i>Thyesat janë më të vogla se një.</i>	<i>Dua të di për thyesat e parregullta. Zita di shumë për to.</i>	<i>Mësova se disa thyesa janë më të mëdha se numri një. Nëse është më e madhe se numri një, atëherë është thyesë e parregullt.</i>
Plotësoje në fillim të mësimit		Plotësoje në fund të mësimit

Tabela DDM e Adit

Emri: Adi
 Data: 13 nëntor
 Lënda: Matematikë – Thyesa

D (Çka di)	D (Çka dua të di)	M (Çka mësova)
<i>Thyesa mund të grumbullohen deri në numrin një.</i>	<i>Nuk e kuptoj se çka është numri i përzier.</i>	<i>Numat e përzier hasen gjithandej. Unë jam i gjatë 121/5. Ky është numër i përzier - pra një numër e një thyesë.</i>
Plotësoje në fillim të mësimit		Plotësoje në fund të mësimit

Inion Ui Murçu i mbledhi dritaret. Ajo i përdor tabelat e plotësuara në orë gjatë përsëritjes së thyesave, gjatë dhënies së detyrave të shtëpisë dhe gjatë përgatitjes së testeve të diferencuara për paralelen e saj.

Shembull i detyrës së shtëpisë

Detyra e shtëpisë nga lënda e matematikës, 14 janar:

1. Shënoji 5 numra të përzier.
2. Shënoji 5 thyesa që kur t'i mbledhësh bëjnë një
3. A e përbëjnë $3/4$ dhe $1/2$ numrin një?
4. A është > 1 thyesë e parregullt?
5. Shënoji pesë thyesa të parregullta.

Mirçu i mbledh tabelat si pjesë e dokumenteve të saj për secilin fëmijë. Ajo konsideron se tabelat ndihmojnë shumë gjatë bisedave me prindërit për përpërimin e fëmijëve të tyre dhe gjatë mbushjes së dëftësive të nxënësve në fund të vitit.

Bisedat me nxënësit

Çka paraqesin bisedat me nxënësit?

Bisedat me nxënësit në kontekst të notimit nënkuptojnë se ata të cilët janë të interesuar për mësimin e fëmijës gjatë një bisede të planifikuar ose gjatë një bisede të rastit, i shkëmbejnë njohuritë dhe të kuptuarit e tyre për punën e fëmijës, për mënyrën e punës dhe për rezultatet. Në periudha të caktuara kohore gjatë vitit shkollor, puna dhe përparimi i fëmijës mund të jenë temë bisede ndërmjet fëmijës dhe arsimtarit të tij, mes arsimtarit dhe prindit ose mes të gjithë atyre së bashku.

Cila është vlera e bisedave si metoda të notimit?

Bisedat japin mundësi të shkëmbehen informacione që ashtu të shtohen njohuritë për të mësuarit e fëmijëve. Biseda paraqet aktivitet notues. Biseda ndërmjet arsimtarit dhe nxënësit ka të bëjë me punën e portofolit, p.sh. arsimtari bisedon me fëmijën për anët e tij të forta dhe për të arriturat e tij si dhe jep sugjerime për atë se ku dhe si mund të përmirësohet mësimi i tij. Gjatë bisedës arsimtari i dëgjon idetë e fëmijës për atë se çka konsideron ai se e ka të vështirë ose të lehtë gjatë mësimin dhe e nxit mënyrën e këtillë të transparencës të fëmija. Ja një shembull të NSHM-së: njohuritë e bisedës i ndihmojnë fëmijës të shohë se si mund të përmirësohet puna e tij.

Si përdoret biseda?

Biseda ndërmjet arsimtarit dhe fëmijës

Arsimtari lë një kohë të caktuar për biseda të dedikuara të cilat mund të emërtohen si vështrim, takim ose thjeshtë bisedë. Nëse bisedat e dedikuara mbahen me rregull, për shembull njëherë në javë, me siguri që arsimtari do të mund të jetë në gjendje që secilit fëmijë t'i kushtojë nga disa minuta. Nëse fëmijët janë të rinj në këtë proces, bisedat e këtilla mund të jenë të dobishme që të fillohet me të. Kohëzgjatja ose mbajtja e tyre e shpeshtë nuk janë aq shumë të rëndësishme sa pjesëmarrja e fëmijës dhe vlerësimi i praktikës së tillë.

Objekt i bisedës mund të jetë ndonjë punim individual gjatë mësimin (punim me shkrim, vizatim ose projekt) ose përvojat e përgjithshme arsimore, siç janë TIK-ja ose pjesë-

marrja e seksionin dramatik a ndonjë aktiviteti sportiv në terren të hapur. Biseda duhet të jetë joformale dhe nuk duhet të jetë e pakëndshme. Qëllimi kryesor është që biseda të ketë lidhje me punën në shkollë. Në fazën e mëtutjeshme ose me fëmijët e klasave më të larta arsimtari do të mund ta shfrytëzojë bisedën e dedikuar që të japë përgjigje për ndonjë punim të caktuar individual të cilin fëmija e ka përgatitur. Në këtë rast me rëndësi do të jetë diskutimi për kriteret: Çka është ajo që e bën këtë punim të jetë i mirë? Si mund të përmirësohet ai? Për këtë aktivitet do ishte e dobishme edhe një fletë e thjeshtë për notim analitik. Fleta analitike paraqet instrument për notim i cili i përshkruan nivelet e ndryshme të cilësisë së një punimi të posaçëm. (Për më shumë informacione për fletën e notimit shih Shtojcën A, fq. 78) Shembulli i aktivitetit 2.6 në faqen tjetër paraqet shembull se si një fletë notimi mund të shfrytëzohet me fëmijët e klasës së gjashtë që kështu të notohen punimet e tyre me shkrim.

Klima në klasë paraqet faktor të rëndësishëm në procesin e realizimit të bisedave me nxënës. Fëmijët duhet të dinë dhe të pranojnë se ata nuk do të merren në pyetje gjatë bisedës me arsimtarin dhe se ata mund ta shprehin atë që mendojnë për punën e tyre për ndonjë aktivitet ose fushë të caktuar arsimore. Më e besueshme është se biseda do të jetë e suksesshme në atmosferë në të cilën respektohen mendimet e fëmijëve, gjegjësisht kur fëmijët nxiten t'i shprehin mendimet e tyre. Gjithashtu fëmijët kanë nevojë të shohin se bisedat paraqesin mundësi që ata të mësojnë diçka edhe për veten tyre si nxënës. Shembulli i aktivitetit 2.7. në faqen 26 e paraqet një bisedë ndërmjet arsimtarit dhe fëmijës në mjedisin i cili e mbështet atë.



Shembull i aktivitetit 2.6. Përdorimi i fletës për notim si pjesë e bisedës me nxënës

Fusha programore: Gjuhë
Lënda mësimore: Gjuhë angleze
Tema mësimore: Aftësia dhe vetëbesimi në përdorimin e gjuhës/shkrimit
Njësia tematike: Shkrimi: zhvillimi i aftësisë, vetëbesimi dhe shkathtësia për shkrim të pavarur

**Detyrat/
qëllimet programore:** Fëmija duhet të aftësohet të shkruajë, pa ndonjë paraformulim, për ndonjë temë të dhënë ose të zgjedhur në kuadër të disa kufizimeve kohore; të aftësohet për shkrim, t'i respektojë rregullat gramatikore, shenjat e pikësimit dhe drejtshkrimin; të aftësohet t'u ndihmojë të tjerëve në korrigjimin e punimeve të tyre me shkrim.

Niveli klasor: Klasa e pestë dhe e gjashtë

Tema mësimore: Kuptueshmëria e gjuhës/shkrimi

Njësia tematike: Shkrimi: krijimi dhe nxitja e dëshirës për shkrim

Kuptueshmëria e gjuhës: krijimi dhe nxitja e dëshirës për shkrim

Detyra/qëllimi programor: Të aftësohet fëmija të pranojë dhe të japë përgjigje konstruktive për shkrimin.

Niveli klasor: Klasa e pestë dhe e gjashtë

Fëmijët e klasës së gjashtë e shfrytëzojnë fletën e dhënë më poshtë për notim analitik që të notojnë diçka që ata e kanë shkruar. Elementet e posaçme të fletës analitike bazohen në gjërat të cilat e bëjnë përmbajtjen të jetë e mirë, në gjëra të cilat paraprakisht kanë qenë të diskutuara dhe të caktuara ndërmjet fëmijëve dhe arsimtarit të tyre (kriteret për suksesin e shkrimit në punimet me shkrim). Në këtë rast mund të shfrytëzohen edhe fletë të tjera analitike për punimin e ardhshëm me shkrim për notimin e shenjave të pikësimit; për shembull, shfrytëzimi i thonjëzave, pikëçuditjes etj.

Shembull i fletës analitike për notim

Karakteristika	Nuk e bëra mirë	Dhashë mund solid	Dhashë shumë mund
Struktura dhe veprimi	Punimi im nuk ka fillim, mes dhe fund të qartë	Punimi im ka strukturë dhe veprim, por disa prej tyre nuk janë të qarta	Punimi im ka strukturë dhe veprim të qartë.
Paragrafë	Kam shumë (shumë pak) paragrafë ose ato nuk fillojnë ku duhet.	Disa paragrafë janë në vend të duhur, ndërsa disa të tjerë nuk janë.	Paragrafët e mi fillojnë në vendet në të cilat ka ndryshime të veprimit dhe i ndihmojnë lexuesit ta përcjellë punimin.
Kurioziteti	Punimi im nuk është aq interesant	Punimi im është pak a shumë interesant.	Punimi im është shumë interesant
Personazhe	Në punimin tim nuk e përshkrova ndonjë personazh të fortë	Në punimin tim së paku e përshkrova një personazh të fortë	Personazhet në punim janë të përshkruar mirë

Çdo mendim i fëmijës për punimin e tij me shkrim ndihmon që të zhvillohen aftësitë e tij për metakognicion (mendimi për mësimin personal). Rezultat kryesor për çfarëdo lloj bisede të tillë të dedikuar është se njësoj edhe arsimtari edhe nxënësi mund të kuptojnë diçka më tepër për mësimin dhe për hapat e mëtejme që duhet të ndërmerren për përkrahjen e mësimin të tyre. Ndërkohë natyra e individualizuar e bisedës së dedikuar nënkupton se arsimtari mund ta diferencojë mbështetjen në bazë të aftësive dhe nevojave të secilit fëmijë.

Shembull i aktivitetit 2.7.

Bisedat ndërmjet arsimtarit dhe nxënësit

Fusha programore:	Gjuhë
Lënda mësimore:	Gjuhë angleze
Tema mësimore:	Aftësitë dhe vetëbesimi në shfrytëzimin e gjuhës/shkrimit
Njësia mësimore:	Shkrim: zhvillimi i aftësisë, vetëbesimit dhe shkathtësisë për shkrim të pavarur
Detyra programore:	Aftësia dhe vetëbesimi në shfrytëzimin e gjuhës: zhvillimi i aftësisë, vetëbesimit dhe shkathtësisë për shkrim të pavarur
Detyra programore:	Të aftësohet fëmija të përvetësojë përvoja të llojllojshme gojore lidhur me gjuhën si pjesë e procesit para shkrimit; të aftësohet të shkruajë në mënyrë të pavarur përmes një procesi të përgatitjes së draftit për punimin me shkrim, përpunimin e tij, redaktimin dhe publikimin.
Niveli klasor:	Klasa e pestë dhe e gjashtë

Z. Svift i përdor rregullisht bisedat me njëzet e gjashtë nxënësit e tij prej klasës së pestë deri në klasën e gjashtë. Ai të premtën paradite planifikon kohë për bisedë me grupe të vogla të nxënësve. Në atë mënyrë fëmijët fitojnë mundësi të bisedojnë për punën e tyre nga tre ose katër minuta çdo të tretën javë. Ja biseda me Shejnin për punimin me shkrim të cilin klasa e përpunoi paraprakisht gjatë javës. Titulli i saj është: *Një UFO atëron sonte këtu.*

Z. Svift: *Pra Shejn, çka mendon për atë që e kë shkruar? A je i kënaqur me përmbajtjen?*

Shejn: *Nuk e di ... ma merr mendja se është pak i shkurtër.*

Z. Svift: *E po, sipas meje ai është tepër i shkurtër. Por, çka mendon për përmbajtjen? Ai ia lexove përmbajtjen shokut tënd?*

Shejn: *Po. Ai mendon se fillimi është shqetësues, ndërsa fundi i bezdisshëm.*

Z. Svift: *E çka mendon ti për të?*

Shejn: *Po shihni, unë mendoj se është në rregull. I kam disa fjali të mira në fillim – fjali të shkurtra për të cilat biseduam para se të fillojmë ta shkruajmë punimin... që ta mbaj sa më mirë koncentrimin.*

Z. Svift: *Pajtohem. Pjesën hyrëse e kë shumë interesante. I përdor edhe disa fjali rrëqethëse të cilat i regjistruam në listë. Por, e pyes veten se a ke pasur plan se si do të jetë përfundimi. Mendoj se pastaj mbaron shumë shpejt.*

Shejn: *Po. Nuk pata ide. Andaj, thjesht e përfundova punimin.*

Z. Svift: *Në rregull. A do ta përmirësosh përfundimin? Mbaje mend se ndokush që e lexon këtë punim dëshiron ta dijë se çka ka ndodhur me dy personazhët kryesorë. Andaj shkruaje edhe një paragraf tjetër në fund, por pak me më shumë informacione, por mbaje mend se duhet ta sjellësh punimin në ndonjë përfundim të interesant. Nëse e ke vështirë, eja te unë nesër në mëngjes dhe do ta shikojmë përsëri atë.*

Shejn: *Në rregull arsimtar, posa më shkoi mendja për një përfundim më të mirë të punimit!*

Gjatë bisedës z. Svifti e udhëzon Shejnin ta përcaktojë atë që mund ta përmirësojë në punimin e tij. Ekzistojnë edhe gjëra tjera në të cilat do të mund të ndalet arsimtari, mirëpo ai e shfrytëzon këtë bisedë që ta theksojë fundin e punimit, për shkak se para do kohe në paralele kanë punuar në ndërtimin e strukturës së punimeve me shkrim. Tani Shenji do të shkruajë një version të dytë të punimit. Para se të arrihet versioni përfundimtar ndoshta do të ketë edhe ndryshime të mëtejme.

Z. Svifti gjithashtu shfrytëzon sistem të shokëve – partnerë në paralele që t'i inicojnë fëmijët t'ia lexojnë njëri-tjetrit punimin në mënyrë konstruktive. Nga secili fëmijë kërkohet ta shënojë një pikë të fuqishme dhe një ide për përmirësimin e punimit të shokut – partnerit të tij. Çdo bisedë e tillë ndërmjet arsimtarit dhe fëmijëve zgjat vetëm disa minuta, ndërsa për tërë grupin nevojiten 50-55 minuta. Z. Svifti është i bindur se koha e kaluar në biseda të tilla është shfrytëzuar mirë, duke e pasur parasysh me këtë rast përmirësimin e vërtetë që ai e ka regjistruar në punimet e fëmijëve.

Bisedat në funksion të NSHM dhe NAM

Biseda është e dobishme për **NSHM-së** kur kryhet në një bazë interaktive gjatë vitit shkollor. Pastaj mund të ndërmerren hapa dhe kështu fëmijës t'i ofrohet mbështetje më e veçantë. Një bisedë e dedikuar në fund të vitit shkollor me siguri do të ndihmojë për **NSHM-në** kur të gjitha palët e interesuara do ta shqyrtojnë përparimin fëmijës gjatë në periudhe arsimore ose gjatë tërë vitit shkollor. Biseda e këtillë mund t'u referohet rezultateve të testeve të standardizuara nëse teste të tilla janë realizuar gjatë atij viti shkollor.

Lloje tjera të bisedave

Bisedat e prindërve me arsimtarin

Informacionet e notimit gjithashtu shqyrtohen gjatë bisedave të prindërve me arsimtarin. Disa biseda të tilla planifikohen, ndërsa disa të tjera nuk planifikohen. Si për arsimtarin, ashtu edhe për prindin, biseda e këtillë paraqet mundësi që ata të mësojnë diçka më tepër për atë se si mëson fëmija në shtëpi dhe në shkollë dhe t'i shqyrtojnë mundësitë me anë të të cilave fëmijës do të mund t'i ofrohet mbështetje gjatë mësimin. Bisedat e tilla gjithashtu paraqesin mundësi të bisedohet edhe për interesat e posaçme të fëmijës, brengën dhe keqkuptimin lidhur me mësimin në shkollë ose lidhur me detyrat e shtëpisë.

Bisedat e arsimtarit me arsimtarë të tjerë

Mund të organizohen edhe takime të përbashkëta me arsimtarët, në të cilat do të shqyrtohet puna e fëmijëve në shkollën gjegjëse si dhe në shkolla të tjera. Lloji i këtillë i bisedave mund t'u ndihmojë arsimtarëve:

- të krijojnë notim më efektiv;
- të përgatisin standarde të përbashkëta përmes kuptimit të përbashkët për cilësinë dhe punën e fëmijëve;
- të grumbullojnë dhe të shqyrtojnë ide për përmirësimin e praktikës mësimore.

Gjatë bisedave të këtij lloji arsimtari i përcakton kriteret për gjykimin e cilësisë së punës në fusha të ndryshme programore/lëndë mësimore në nivel të ndryshëm klasor duke i shfrytëzuar shembujt e punimeve të nxënësve si bazë për diskutim.

Notimi i portofolit

Çka paraqet portofoli?

Fëmijët qysh në moshën e hershme mund të zhvillojnë aftësi për vetënotim, pra gradualisht duke marrë përgjegjësi më të madhe për cilësinë e punës së tyre. Përgatitja e portofolit paraqet mënyrë të dobishme për nxitjen e aftësive të këtylla. Portofoli paraqet përmbledhje të punimeve të fëmijës dhe ai e pasqyron mësimin dhe zhvillimin e tij gjatë një periudhe të caktuar. Ai mund të sigurojë të dhëna për përparimin në mësim në ndonjë fushë të caktuar programore, lëndë mësimore, temë ose, më shumë se gjithë kjo, duke e pasur në fokus temën e caktuar. *Programet mësimore për shkollë fillore* rekomandojnë shfrytëzimin të portofolit si dhe shembuj të punimeve dhe projekteve për mësim në lëndë të caktuara mësimore: gjuhë kelte, gjuhë angleze, matematikë, shkenca natyrore dhe shoqërore, edukatë fizike dhe shëndetësore, art vizual, edukatë muzikore dhe aktivitete dramatike.

Varësisht nga qëllimi i tij, portofoli mund të shfrytëzohet gjatë vitit shkollor, gjatë gjysmëvjetorit ose gjatë një periudhe më të shkurtër. Portofolat gjithashtu mundësojnë notim të përbashkët kur arsimtari dhe fëmija së bashku e shqyrtojnë dhe bisedojnë për punimin, duke i identifikuar kështu karakteristikat pozitive dhe pikat për përmirësimin e tij.

Portofolat mund të jenë në formë të fletëve të shtypura dhe/ose portofola elektronikë. Portofoli elektronik, i njohur si e-portofol ose si portofol digjital paraqet përmbledhje të punimeve të fëmijëve duke i shfrytëzuar punimet me shkrim të nxënësve në versionin elektronik, prezantimin e krijimtarisë multimediale, hartave mendore, softuerëve me bazë të të dhënave dhe/ose pasqyrave tabelore të cilat kompletohen nga fëmija. Fëmijët më të vegjël mund të përgatitin kontribute të rëndomta me teste dhe ilustrim. E-portofolat gjithashtu mundësojnë ndërlikime të punimeve në kuadër të një portofoli (për shembull, ndërlikime e ndonjë video-dosjeje me ndonjë dokument të caktuar) dhe jashtë portofolit (për shembull, ndërlikime e ndonjë ueb-faqeje me ndonjë prezantim të caktuar). Në udhëzimet e NCCA-së *TIK-ja në Programet mësimore për shkollë fillore (2004)* thuhet se zgjidhja e shembujve të punimeve elektronike do të rritet kur fëmijët do të njoftohen më mirë me përgatitjen dhe mirëmbajtjen e e-portofolave të tyre. *Kjo do ta stimulojë interesin e tyre në shfrytëzimin e TIK-së në mësim dhe do ta kultivojë aftësinë e tyre për ta vlerësuar kontributin e tyre personal* (fq. 35). E-portofoli mund të azhurnohet dhe të mbahen në mënyrë interkative, gjë që mundëson shkëmbim të kontributit të fëmijës me fëmijët e tjerë dhe ruajtje të të dhënave në kompjuter në kuadër të paraleles dhe shkollës. Në shembullin e aktivitetit 2.9., i cili vijon më tej, përshkruhet shembulli i një e-portofoli të tillë.

Çka mund të vendosë fëmija në një portofol?

Përmbajtja e portofolit varet nga qëllimet e tij. Arsimtari vendos lidhur me qëllimet e portofolit para se ai të fillojë të shfrytëzohet. Shembuj të qëllimeve mund të jenë: të paraqiten përmirësimet në punën e fëmijëve: të paraqitet vëllimi i punës; të paraqiten anët e forta të interesimit të fëmijëve;

të paraqitet punimi i tyre më i mirë. Portofoli mund të shfrytëzohet njësoj për **NSHM** dhe për **NAM** dhe, varësisht nga qëllimet, ai mund të përmbajë shembuj të punës së fëmijës nga të gjitha programet arsimore ose nga një lëndë mësimore, duke përfshirë edhe:

- shembuj të punimeve me shkrim të fazave të ndryshme të zhvillimit të tij (punime me shkrim, letra, poezi);
- punë projektuese në ndonjë lëndë mësimore të shkencave natyrore, historisë ose gjeografisë;
- shembuj të punimeve të arteve vizuale;
- grafikë ose diagrame të matematikës ose të shkencave natyrore;
- fotografi ose video-sekuenca nga pjesëmarrja në aktivitetet e edukatës fizike;
- sequenca të incizuara të kontributeve muzikore.

Si funksionon portofoli si metodë notimi?

Pasi që arsimtari të vendosë për qëllimet e portofolit, ai ua shpjegon fëmijëve idenë e portofolit. Arsimtari siguron fashikuj ose kuti me madhësi natyrore, madje vetë fëmija mund t'i bëjë ato. Arsimtari e përcakton mënyrën e ruajtjes së tyre (në fletë të kopjuara dhe/ose në mënyrë elektronike). Arsimtari ose fëmija (ose të dy së bashku) herë pas herë zgjedhin punim për portofoli duke e pasur parasysh qëllimin dhe kriteret. Fëmija parashtron edhe një shënim të shkurtër me shkrim duke shpjeguar se pse është zgjedhur ai punim. (Theksi duhet të vendoset mbi atë që e ka mësuar fëmija). Arsimtari dhe fëmija mund të japin notë ose koment për secilin punim të bazuar në kriteret të cilat kanë të bëjnë me qëllimet arsimore ose me rezultatet, por me rëndësi është që arsimtari të jetë i vetëdijshëm se notimi i punimeve në vend të komenteve e ndryshon rolin e portofolit në notim. Paralelja mund të organizojë ekspozitë të portofolave në takimet e arsimtarit me prindërit. Disa fëmijë ndoshta do të dëshirojnë të thonë diçka për portofolin e tyre, për atë se çfarë rëndësie ka për ta dhe çka kanë mësuar nga ai.

Pyetjet që mund t'i parashtrorë arsimtari gjatë planifikimit të shfrytëzimit të portofolit

- Pse e shfrytëzoj portofolin?
- Çfarë njohurie do të notoj?
Cilin/cilat lëndë mësimore/aftësi/koncepte/prijrje do t'i notoj?
- Si do të kontribuojë portofoli në notimin e përparimit dhe të arriturave të fëmijës?
- Çfarë periudhe kohore do të përfshijë ai – gjysmëvjetor, muaj, tërë vitin shkollor? (Periudhat më të shkurtra do t'u përshtaten më shumë fëmijëve më të vegjël.)
- Sa do të jetë vëllimi i portofolit? Ku do t'i ruaj?
A ka mundësi të bëhet memorimi i tyre elektronik?
- Kush do ta bëjë përzgjedhjen e përmbajtjes së portofolit dhe sa shpesh do ta bëjë atë?

- Nëse planifikoj të jap nota ose komente të punimeve në portofol, cilat kritere do t'i shfrytëzoj për notim? Si do t'i dallojnë fëmijët ato kritere?
- Çka do të ndodhë me portofolin në fund të përdorimit të tij? A do të prezantohen portofolat para publikut më të gjerë (për shembull, prindërve, fëmijëve të tjerë të shkollës, në mbledhjen e shkollës ose në ndonjë ditë/mbrëmje të hapur) në shkollë?

Shembull të aktivitetit 2.8.

Përgatitja e portofolit me punime me shkrim

Fusha programore:	Gjuhë
Lënda mësimore:	Gjuha angleze
Tema mësimore:	Të kuptuarit gjuhës / shkrimi
Njësia tematike:	Shkrimi: krijimi dhe nxitja e dëshirës për shkrim / Pranimi e gjuhës
Detyrat programore:	Të aftësohet fëmija të shprehë dhe të përcjellë reagime lidhur me atë që është lexuar; të aftësohet të përvetësojë përvoja për interesat dhe sfidat e rëndësishme në shkrim; të aftësohet dhe të kuptojë se punimi i tij me shkrim vlerësohet.
Niveli klasor:	Klasa e pestë dhe e gjashtë
Tema mësimore:	Aftësia dhe vetëbesimi në shfrytëzimin e gjuhës / shkrimit
Njësia mësimore:	Shkrimi: zhvillimi i aftësisë, vetëbesimi dhe shkathhtësia për shkrim të pavarur Aftësia dhe vetëbesimi në shfrytëzimin e gjuhës
Detyrat programore:	Të aftësohet fëmija të mbikëqyrë / të vërejë se si e përmirëson arsimtari shkrimin.
Niveli klasor:	Klasa e pestë dhe e gjashtë

Znj. Kenedi mban mësim në klasë të pestë dhe gjatë vitit shkollor i shfrytëzon portofolat për t'i notuar punimet e fëmijëve në mësimin e gjuhës angleze. Ajo u jep për detyrë të bëjnë fashikuj (me A3 format) dhe t'i dizajnojnë kopertinat. Në fillim u thotë se qëllimi i portofolit është që të tjerëve dhe vetvetes t'i tregohet mënyra se si përmirësohet puna e tyre në lëndën e gjuhës angleze gjatë vitit shkollor. Çdo dy javë zonja Kenedi u lë në dispozicion fëmijëve një periudhë caktuar për t'i shqyrtuar punimet e tyre dhe kërkon prej tyre ta zgjedhin atë që e konsiderojnë se është punim i mirë. Në pjesën e pasme të punimit ata shkruajnë një ose dy fjali duke shpjeguar se pse ai punim është i mirë. Zonja Kenedi i ka shënuar karakteristikat/cilësitë e punimit të mirë të posterëve që ekspozohen në murin e klasës, ashtu që ajo dhe fëmijët mund t'i shohin ato. Kjo siguron bazë për diskutime të dobishme.

Me kalimin muajve në secilin portofol rritet sasia e punimeve. Kah fundi i vitit shkollor secili portofol i ka rreth pesëmbëdhjetë punime, duke përfshirë punime poetike, punime me shkrim (disa prej tyre janë në formë deskriptive, ndërsa disa të tjera në formë narrative), ritregimi i gjërave të mira të cilat janë diskutuar në klasë, si dhe raportet për festat dhe manifestimet në shkollë. Aty gjithashtu ka dhe gjëgjëza gjuhësore, kuize të shkurtra dhe tregime të ilustruara. Fëmijët i ruajnë portofolat në një raft të bibliotekës së paraleles.

Znj. Kenedi është e befasuar se sa mirë kujdesen fëmijët për portofolat e tyre. Në fund të vitit shkollor paralelja organizon prezantim të portofolit në të cilin çdo fëmijë e ka në dispozicion vetëm një minutë që të tregojë para paraleles për punën e vetë dhe për zgjedhjen e punimit më të mirë. Shumica e fëmijëve janë të aftë të tregojnë se si është përmirësuar punimi i tyre në orët e anglishtes gjatë vitit shkollor. Portofolat shkaktojnë interes të madh edhe te prindërit në mbledhjet e tyre me arsimtarët kur atyre u dorëzohen raportet për fëmijët e tyre.

Shembulli i aktivitetit 2.9. Përgatitja e portofolit

Fusha programore/	
Lënda mësimore:	Arsimimi personal, shoqëror dhe shëndetësor
Tema mësimore:	Vetë unë
Njësia tematike:	Identiteti personal
Qëllimet programore:	Të aftësohet fëmija t'i kuptojë dhe t'i prezantojë anët e tij të fuqishme, aftësitë dhe karakteristikat e tij; të aftësohet t'i dallojë dhe të mendojë për zgjedhjet të cilat i bën për çdo ditë.
Niveli klasor:	Klasa e parë ose e dytë
Tema mësimore:	Vetë unë
Njësia tematike:	Kujdesi për trupin tim
Qëllimet programore:	Të aftësohet fëmija t'i hulumtojë gjërat e ndryshme të cilat mund t'i bëjë trupi i tij; të aftësohet të zhvillojë shprehi higjienike.
Niveli klasor:	Klasa e parë ose e dytë

Gjatë gjysmëvjetorit të parë fëmijët përgatisin portofol për atë se çka kanë mësuar për kafshët në ferma. Zonja Farel ka punuar me fëmijë për përgatitjen dhe azhurimin e llojeve të ndryshme të portofolave. Disa portofola janë prezantuar në fashikuj me xhepa plastikë ose fashikuj të rëndomtë, ndërsa fëmijët e tjerë kanë shfrytëzuar kuti për pica.

Për ta nxitur te fëmijët shfrytëzimin e TIK-së në mësim, zonja Farel planifikon ta shfrytëzojë portofolin për notim të diturive të fëmijëve nga lënda e arsimimit personal, shoqëror dhe shëndetësor. Qëllimi i saj është ta dokumentojë ngritjen e vetëdijes dhe të kuptuarit e fëmijëve për trupin e tyre, si dhe për aftësitë e tyre për të bërë zgjedhje të mirë.

Z-nja Farel fillon duke u dhënë ndihmë fëmijëve që të hapin fashikull të ri në desktopin e kompjuterit në shkollë. Ata i emërtojnë fashikujt me emrat e tyre. Duke shfrytëzuar fashikull për shkrim, z-nja Farel përgatit udhëzim hyrës në një faqe për e-portofola (siç është treguar më poshtë) me çka i ndihmon secilit fëmijë ta kompletojë dhe ruajë fashikullin e tij.

Udhëzimi hyrës për e-portofol (portofol elektronik)

Mirë se erdhët në e-portofolin tim të parë. Ai paraqet gjithçka për mua.

Unë quhem

Unë mësoj në klasën

Unë dua të

Unë ndjehem i kënaqur kur

Shembull i aktivitetit 2.9. (vazhdim)

Zonja Farel dhe fëmijët përdorin kamerë digjitale për të bërë fotografi për secilin fëmijë dhe pastaj i fusin ato në pjesën hyrëse të secilit portofol.

Me qëllim që t'u ndihmohet fëmijëve që t'i emërtojnë dhe t'i mbajnë mend pjesët e trupit të njeriut, shtojca e ardhshme në portofol fokusohet në vendosjen e fjalëve të sakta përskaj një diagrami të trupit me pjesë të zbrazëta për emrat. Gjatë javëve të ardhshme secili fëmijë vazhdon të shtojë shembuj të punimeve në portofolin e tij duke përfshirë edhe fotografi të ndryshme të cilat fëmija dëshiron t'i bëjë, lista të gjërave të cilat fëmija dëshiron të mësojë t'i bëjë, ndonjë audio-dosje për diçka që e ka bërë fëmija, si dhe disa vizatime dhe fotografi të skanuara të fëmijëve për atë se si kujdesen ata për trupin e tyre.

Fëmijët gjithnjë e më shumë udhëzohen se si të gjejnë dhe të hapin dosje të reja në desktopin e kompjuterit të klasës së tyre dhe të shtojnë dosje të reja me shembuj të punimeve. Gjatë gjysmëvjetorit secili fëmijë e shqyrton portofolin e vetë së bashku me fëmijët e tjerë në grup, duke diskutuar me ta për atë se çka u pëlqen atyre në shembujt e punimeve të zgjedhura lidhur me gjërat që ata do të dëshironin të përmirësohen. Zonja Farel i noton aftësitë e fëmijëve për prezantimin e punimeve të tyre para personave tjerë. Nga përmasa dhe aftësitë të cilat i dëshmojnë fëmijët, ajo vëren se ku nevojitet punë e mëtejme dhe inkurajim i fëmijëve më të turpshëm në paralele, ashtu që i riorganizon grupet të cilat punojnë në portofol që t'i mbështesin fëmijët e këtyllë.

Në fund të gjysmëvjetorit z-nja Farel do t'u mundësojë fëmijëve t'i prezantojnë portofolat e tyre dhe ta prezantojnë para paraleles atë që e kanë mësuar për veten e tyre. Ajo planifikon t'i incizojnë prezantimet e fëmijëve si video- dosje të shkurtra të cilat do të paraqesin material dëshmuar për mendimet e fëmijëve për të mësuarit e tyre dhe për portofolat e tyre. Këto do të jenë shtojcat e fundit të punimeve në e-portofolin e secilit fëmijë.

Përgatitja e hartës mendore

Çka paraqet harta mendore?

Përgatitja e hartës mendore (e njohur edhe si rrjeti semantik) paraqet proces i cili shfrytëzohet për të përgatitur ide dhe lidhje të ideve të tyre. Hartat mendore (ose rrjetet semantike) janë të ngjashme me grafikët që përmbajnë ide dhe linja të shënjuara të cilat i përshkruajnë lidhjet ndërmjet tyre. Qëllimi i hartave është t'i ndihmojnë fëmijës të tregojë se çfarë mendon për ndonjë ide të caktuar. Ekzistojnë lloje të ndryshme të hartave mendore të cilat i ndihmojnë fëmijës ta organizojë dhe ta prezantojë mendimin e tij. Në këtë mënyrë hartat paraqesin organizatorë grafikë ose rezyme ilustruese të mendimit të fëmijës për idetë dhe lidhjet ndërmjet ideve.

Cili është përfitimi i përgatitjes së hartës mendore si metodë notimi?

Fëmijët vazhdimisht marrin informacione për botën rreth tyre. Ata i shfrytëzojnë informacionet e tilla që të ndërtojnë teori për atë se pse gjërat ekzistojnë në mënyrë si janë dhe pse gjërat ngjajnë ashtu siç ngjajnë. Këto teori mund të ndryshohen me kalimin e kohës, kjo si rezultat i përvojave të fëmijëve dhe interaksioneve me mjedisin e tyre dhe me njerëzit e tjerë. Përgatitja e hartave mendore i ndihmon arsimtarit të futet në mendimet e fëmijëve. Informacionet e këtilla mund të japin të dhëna të pasura për atë se si mësojnë fëmijët – si i ndërlidhin idetë. Përgatitja e hartave mendore gjithashtu është shumë e dobishme për vetë fëmijët. Ky proces i angazhon fëmijët në mësim më të plotë, duke u ndihmuar t'i integrojnë informacionet e reja në dituritë e mëparshme dhe kështu të sigurojnë tregues për kuptimin e këtyllë. Fëmijët mund t'i shfrytëzojnë hartat mendore edhe si udhëzues në mësim.

Informacionet të cilat arsimtari i grumbullon përmes hartave mendore mund të sigurojnë pika të rëndësishme nismëtare për mësimdhënie dhe mësim. Përgatitja e hartave mendore u ndihmon fëmijëve t'i ndërlidhin informacionet të cilat tashmë i posedojnë për ndonjë temë ose ide, si dhe t'i inkorporojnë informacionet e reja në të menduarit e tyre gjatë mësimin. Harta mendore gjithashtu mund ta përmirësojnë të kuptuarit e fëmijëve për nocione të veçanta dhe mund t'u ndihmojë atyre t'i dallojnë lidhshmëritë ndërmjet nocioneve. Ato mund të jenë të dobishme në veçanti për fëmijët me vështirësi në lexim, pikërisht për shkak se atë që e mësojnë e paraqesin edhe në mënyrë grafike. Duke i shfrytëzuar treguesit për mësimin e fëmijëve, të marra nga hartat mendore, arsimtari mund t'i identifikojë strategjitë, aktivitetet dhe përvojat mësimore me qëllim që kështu ta modifikojnë mësimin e tyre në rast të paqartësive ose që ta zhvillojë atë.

Përgatitja e hartave mendore në veçanti është e dobishme në notimin e fëmijëve në shkencat natyrore, histori dhe gjeografi. Kjo mund të shfrytëzohet me fëmijët e niveleve të ndryshme të klasave, por kërkon edhe orvatje më të mëdha nga arsimtari në punën me fëmijët më të vegjël.

Si të shfrytëzohet përgatitja e hartave mendore?

Përgatitja e hartave mendore fillon me diskutim për idenë ose nocionin e rëndësishëm. Përmes diskutimit të këtyllë, arsimtari ose fëmijët i regjistrojnë fjalët themelore të cilat e përfaqësojnë të kuptuarit e fëmijëve për idenë ose nocionin. Këto fjalë bëhen bazë për përgatitjen e hartave mendore me idenë ose nocionin si fokus qendror të skicës. Hartat mendore mund të jenë 3-D ose 2-D. Përgatitja e skicave 3-D kërkon resurse, si p.sh. letër ose karton, si dhe tel ose lesh, ndërsa skica 2-D mund të përgatitet duke shfrytëzuar letër dhe laps ose softuer kompjuterik, siç është ai për shkrim ose për përgatitje të hartave mendore.

Pavarësisht se çfarë formati përdoret, arsimtari u paraqet fëmijëve detyrë (një nga një, në çifte ose në grupe) që t'i organizojnë fjalët ose **nocionet** në atë mënyrë që do t'u mundësojë atyre t'i përshkruajnë lidhjet ndërmjet nocioneve dhe nocioneve të varura. Numri i nocioneve të prezantuar në hartën mendore të fëmijës na jep tregues për gjerësinë e të kuptuarit të fëmijës ose për fushën të cilën e mëson. Nivelet e nocioneve të prezantuar (nocion, nocion i varur, nocion i nënvarur) na bëjnë të ditur për thellësinë e të kuptuarit të fëmijës.

Për t'i prezantuar **lidhjet** ndërmjet nocioneve dhe nocioneve të varura, fëmijët shfrytëzojnë vija me akrepa të cilat e tregojnë drejtimin e lidhjeve. Arsimtari i nxit fëmijët të paraqesin sa më shumë lidhje. Numri i lidhjeve të prezantuar në skicën e fëmijës është tregues i përmasës së integruar të ideve të fëmijës në kuadër të temës ose të sferës të cilën ai e mëson. Arsimtari kërkon nga fëmijët t'i përshkruajnë lidhjet me sa më pak fjalë. Saktësia e përshkrimit paraqet indikator të mëtejme për përmasën e të kuptuarit të tij.

Disa fëmijë, në veçanti ata me aftësi të fuqishme vizuale-hapësinore mësojnë shpejt që të shfrytëzojnë harta mendore. Fëmijët e tjerë kanë nevojë për më shumë kohë që të zhvillojnë shkathtësi të tillë dhe ndoshta ata do të duhet të fillojnë me forma më të thjeshta të organizimit grafik dhe me rezyme ilustruese.

Kur duhet të shfrytëzohet përgatitja e hartave mendore si metodë notimi?

Në fillim të një njësie mësimore hartat mendore mund t'u japin arsimtarëve informacione për rrjedhën e të kuptuarit (ose për kuptim të gabuar) të nocioneve të caktuara nga ana e fëmijëve. Informacionet e këtilla i mundësojnë arsimtarit të identifikojë se çfarë njohuri i nevojiten fëmijës dhe në çka duhet të fokusohet ai që t'i përmbushë nevojat e drejtpërdrejta arsimore të fëmijëve, duke e shfrytëzuar me këtë rast përgatitjen e hartave mendore për **NSHM**. Gjatë zhvillimit ose në fund të procesit mësimor përgatitja e hartave mendore mund të sigurojë tregues për atë se si e kanë modifikuar ose zgjeruar përvojat ose aktivitetet të kuptuarit e nxënësve. Për ta bërë këtë, arsimtari mund të kërkojë prej

tyre t'i kontrollojnë skicat e tyre dhe t'i përshtatin ato ashtu siç dëshirojnë ose fëmijëve mund t'u jepet mundësi të përgatisin skica të reja për nocionin e njëjtë. Në këtë mënyrë harta mendore mund të përdoret për **NAM**. Përmes informacioneve të tilla arsimtari mund ta vlerësojë efektivitetin e mësimdhënies së tij në mbështetjen e fëmijës në mësim.


Shembull i aktivitetit 2.10. Shfrytëzimi i hartës mendore për NAM

Fusha programore:	Arsimimi shoqëror, ekologjik dhe natyror-shkencor
Lënda mësimore:	Shkencat natyrore
Tema mësimore:	Qeniet e gjalla
Njësia tematike:	Jeta e bimëve dhe e kafshëve
Qëllimet/detyrat programore:	Të aftësohet fëmija që ta thellojë njohurinë për bimët dhe kafshët nga mjedisi i gjerë jetësor.
Niveli klasor:	Klasa e tretë dhe e katërt

Zonja Deli në klasë të tretë u jep mësim njëzet e shtatë fëmijëve. Fëmijët mësojnë për brejtësit në Irlandë dhe jashtë vendit. Zonja Deli organizon orë demonstrative dhe bisedë për ta dhe i fton të gjithë fëmijët të marrin pjesë. Juri e sjell në shkollë kanakarin e vetë "Ngacmues", ndërsa Sajlli e sjell kanakarin e saj të cilin babai ia ka blerë për ditëlindje. Paralelja bën intervistë me veterinarin lokal i cili posedon shitore për kanakarë, duke bërë hulumtim interaktiv si detyrë shtëpie, lexon libra nga biblioteka e paraleles ose nga biblioteka vendore, shtyp në printer dhe vendos tituj në fotografitë e ndonjë CD-je duke e përdorë kompjuterin e klasës, si dhe përgatit broshurë informative për kanakarët e tyre shtëpiakë që edhe fëmijët e tjerë të mund të lexojnë për ta.

Gjatë notimit të mësimin të fëmijëve zonja Deli e dallon detyrën për përgatitjen e hartave mendore duke i shfrytëzuar dy harta mendore të ashtuquajtura rrjete të merimangës. Në një rrjetë të tillë ideja qendrore vendoset drejt qendrës së skicës, ndërsa idetë e varura degëzohen prej saj. Ajo ua ndan skicën e parë (shih më poshtë) një grupi prej gjashtë nxënësve të cilët kanë vështirësi me shkrim. Pastaj u tregon fëmijëve ta shikojnë dhe të mendojnë për skicën përdorur në fëmijëve tjerë të paraleles ndan skicë tjetër të ndryshme. Menjëherë pasi të fillojnë me zgjidhjen e pavarur të detyrës, ajo kthehet të punojë me grupin e parë. Zonja Deli u ndihmon atyre me fjalët ose frazat themelore, ndërsa i përshkruan edhe për Davidin i cilin vuan nga sindromi i Daunit.


Shembull i formularit për koncept – hartë



Shembull i aktivitetit 2.10. (vazhdim)

Skica e dytë (shih më poshtë) kompletohet nga fëmijët e tjerë të paraleles pa ndihmën e arsimtarit. Kjo skicë kërkon që fëmijët t'i përcaktojnë idetë e varura, si dhe t'i përcaktojnë lidhjet ndërmjet tyre dhe idesë kryesore.

Shembull i hartës mendore të përgatitur nga një fëmijë



Duke i kontrolluar skicat, znj. Deli mban regjistër për nivelin e të mësuarit të disa fëmijëve, në veçanti të fëmijëve me probleme në arsimim. Ajo e regjistron informacionin në regjistrat e saj të përditshëm për paralelen. Ndërkohë i ruan hartat mendore në fashikuj e fëmijëve dhe planifikon t'u tregojë dhe të bisedojë për ta me prindërit në takimet e ardhshme me prindër.


Shembull i aktivitetit 2.11. Përdorimi i hartave mendore për NSHM

Fusha programore:	Arsimimi shoqëror, ekologjik dhe natyror-shkencor
Lënda mësimore:	Shkencat natyrore
Tema mësimore:	Energjia dhe fuqitë natyrore
Njësia tematike:	Nxehtësia
Detyra programore:	Fëmija duhet të aftësohet t'i njohë burimet e ndryshme të energjisë së nxehtë.
Niveli klasor:	Klasa e parë dhe e dytë

Henri e shfrytëzon metodën e përgatitjes së hartave mendore me njëzet e katër nxënësit e tij të klasës së parë dhe të dytë. Të gjithë fëmijët ulen në qilim për të diskutuar në orën e njësishë tematike "Nxehtësia". Fëmijët i shfaqin idetë e tyre të mëdha për nxehtësinë, ndërsa Henri i shkruan ato në dërrasë.


Ditën e nesërme Henri i jep secilit grup, të përbërë prej pesë fëmijëve, nga një komplet letrash me idetë kryesore të cilat ai i ka shtypur ne printer. Ata i lexojnë fjalët së bashku me Henrin. Ai lëviz nga njëri grup në grupin tjetër, duke u ndihmuar t'i radhisin letrat në bankat e tyre në mënyrë që fjalët të cilat lidhen mes vete të vendosen njëra pranë tjetrit. Fëmijët i varin fjalët në një cope letre të madhe duke lënë hapësirë të mjaftueshme ndërmjet tyre që vijat lidhëse të mund të vizatohen. Ata vizatojnë vija ndërmjet atyre fjalëve për të cilat konsiderojnë se janë të lidhura mes vete. Në çdo vijë e shkruajnë nga një fjalë lidhur me natyrën dhe lidhjen ndërmjet atyre dy fjalëve. Nëse ka nevojë, Henri i shkruan ato edhe për fëmijët e tjerë. Një grup i përbërë nga tre fëmijë më të aftë e përdor kompjuterin e klasës për të përgatitur harta të tyre mendore. Kur skicat pothuajse janë të përfunduara, fëmijët e kontrollojnë se a ka ndonjë letër të cilën nuk e kanë shfrytëzuar dhe shtojnë letra të tjera për të cilat konsiderojnë se i përshtaten skicës. Ata shtojnë vija dhe fjalë të reja lidhëse. Grupet i vendosin emrat në to dhe i ekspozojnë skicat e tyre.

Shembull i hartës mendore të një fëmije (e përgatitur duke përdorur letra me fjalë dhe me shkrim)



Shembull i aktivitetit 2.11. (vazhdim)


Shembull i hartës mendore të një fëmijë (e përgatitur me anë të kompjuterit)



Gjatë disa ditëve të ardhshme Herni i kontrollon hartat mendore të fëmijëve dhe vëren se disa prej tyre nuk e kanë kuptuar plotësisht lidhshmërinë ndërmjet koncepteve e ngrohtë dhe e nxehtë. (Ata nuk i kanë vënë këto fjalë në skicat e tyre). Gjithashtu nga skicat nuk është e qartë se si e kuptojnë fëmijët lidhjen ndërmjet ngrohtësisë dhe diellit. Kjo gjë më shumë vërehet te fëmijët e klasës së parë. Në punën e mëtutjeshme lidhur me ngrohtësinë Henri përdor hulumtim në shkollë që të studiohet nocioni temperaturë dhe të krahasohet temperatura brenda dhe jashtë klasës, duke përfshirë edhe hulumtimin se dielli është burimi i ngrohtësisë.

Kah fundi i gjysmëvjetorit hartat mendore janë më komplekse (shih më poshtë); kur fëmijët bëhen më kompetentë gjatë përgatitjes së tyre.

Shembull i hartës mendore të një fëmije



Parashtrimi i pyetjeve

Çka paraqet pyetja e parashtruar nga arsimtari?

Pyetjet që i parashtron arsimtari i ndihmojnë të gjitha metodat e notimit të orëve. Arsimtarët rregullisht u parashtrojnë nxënësve pyetje me gojë lidhur me punën e tyre që të marrin vesh se çka kanë bërë dhe pse kanë bërë diçka. Arsimtarët i shfrytëzojnë pyetjet e këtilla që t'i notojnë dituritë dhe të kuptuarit e nxënësve, si dhe t'i orientojnë nxënësit kah mësimi i tyre. Fëmijët gjithashtu shfrytëzojnë pyetje të cilat u ndihmojnë atyre të mësojnë diçka; për shembull, ata i pyesin arsimtarët ose nxënësit e tjerë. Një pjesë të punës së arsimtarit lidhur me shfrytëzimin e pyetjeve si metodë notimi është modeli i parashtrimit të pyetjeve të mira. Ky model u ndihmon fëmijëve të bëhen më të aftë gjatë parashtrimit të pyetjeve të tyre të cilat do t'u ndihmojnë në mësim. (shih Vetënotimi fq. 16)

Ekzistojnë shumë lloje të ndryshme të pyetjeve gojore. Ato mund të jenë pyetje të mbyllura, në të cilat arsimtari pret përgjigje të thjeshtë me fakte ose pyetje të hapura, të cilat nxisin përgjigje më kritike dhe më analitike dhe mundësojnë rrugë të ndryshme për zgjidhje. (Për më shumë informacione lidhur me llojet e pyetjeve shih Shtojcën A, fq. 80-81). Pyetjet mund të shfrytëzohen që të notohet ajo që është mësuar (NAM) si dhe të ndihmohet në mësim (NSHM), ndonëse dallimi ndërmjet tyre nuk është e përcaktuar qartë dhe pyetjet mund t'i kryejnë të dyja funksionet deri në një masë të caktuar. Kapitujt në vijim i paraqesin disa parametër të teknikave të parashtrimit të pyetjeve gojore.

Cila është domethënia e parashtrimit pyetjeve si metodë e notimi?

Pyetjet e arsimtarëve mund ta notojnë thellësinë e mësimin të fëmijëve duke i nxitur të elaborojnë ndonjë përgjigje të caktuar. Pavarësisht se a është përgjigja e tyre ose e ndonjë fëmije tjetër. Kjo metodë quhet **kontrollim**. Kontrollimi përfshin parashtrim të pyetjeve të fëmijëve për atë se si kanë arritur deri në zgjidhjen e ndonjë problemi të caktuar ose si punojnë ata për momentin në ndonjë detyrë të caktuar. Kontrollimi mund të sjellë deri te qartësimi, të ofrojë informacione plotësuese ose ta drejtojë përgjigjen e fëmijës në drejtim më të dobishëm. Kontrollimet përfshijnë pyetje, siç janë: *Si erdhe deri te ajo përgjigje? Pse është ajo ashtu?* Gjatë shfrytëzimit të kontrollimit si metodë notimi është mirë të pyetni se a mund të jetë kontrollimi më efektiv në përcaktimin e të kuptuarit të fëmijëve dhe, nëse ajo është ashtu, si do ta bënit atë.

Pyetjet e arsimtarëve mund të kenë formë të **udhëzimeve nxitëse**. Udhëzimet përmbajnë kërkesa sipas të cilave nxënësit duhet t'i marrin parasysh aspektet e detyrave të caktuara me qëllim që atyre t'u ndihmohet të arrijnë deri në zgjidhjen e saktë ose të shfrytëzojnë ndonjë metodë më adekuate. Udhëzimet përfshijnë pyetje të këtij lloji: *A zbatohet kjo edhe në të gjitha numrat çift? Paramendo se forma është kënddrejtë, a do të shkaktojë kjo ndonjë dallim?*

Ja edhe një numër të caktuar të pyetjeve të cilat duhet të merren parasysh nëse shfrytëzoni udhëzime nxitëse si metodë notimi:

- A u referohen udhëzimet vështirësive të përgjithshme me të cilat me siguri se do të ballafaqohen nxënësit? Nëse përgjigja është jo, atëherë si do të duhej të ndryshoheshin udhëzimet?
- A ndodhë që disa udhëzime për nxitje të shkojnë më larg se niveli deri ku Ju në fakt u tregoni nxënësve se çka duhet të bëjnë ata në vend se t'i drejtoni t'i rishqyrtojnë planet e tyre?

Përgjigja në pyetje

Shembujt e lartpërmendur fokusohen në parashtrimin e pyetjeve nga arsimtari. Nxitja e fëmijëve që t'i parashtrojnë pyetje arsimtarit gjithashtu mund të sigurojë informacione për mbështetjen e NAM-it dhe NSHM-së. Kjo mund të arrihet:

- **Duke krijuar mundësi që nxënësit të parashtronë pyetje:** Bëni pauzë pas përfundimit të ndonjë pyetjeje të rëndësishme ose gjatë shpjegimit të ndonjë teme të caktuar ose pyetni: A ka ndonjë pyetje? A dëshironi që unë të them diçka më tepër për këtë? Jepuni fëmijëve kohë t'i formulojnë pyetjet e tyre para se të kaloni në temën tjetër.
- **Orvatja që të mos prolongohet dhënia e përgjigjes në ndonjë pyetje të caktuar, gjegjësisht të injorohet pyetja e parashtruar nga ndonjë fëmijë:** Nëse ndonjë fëmijë ka prirje ta monopolizojë kohën gjatë orës, orvatuni t'i thoni: Hajt të shohim a kemi pyetje edhe nga fëmijët tjerë të cilët deri më tani nuk i kemi dëgjuar. Ose: Vinsent, unë u përgjigja në disa pyetjeve tua, andaj eja t'i dëgjojme edhe pyetjet e fëmijëve tjerë.
- **Përgjigja adekuate në pyetjet e fëmijëve:** Nëse arsimtari nuk dëshiron që në mënyrë të drejtpërdrejtë t'i përgjigjet pyetjes, atëherë ai duhet të orvatet:
 - ta përsërisë ose ta riformulojë pyetjen që të mundësojë që e tërë klasa ta dëgjojë atë;
 - ta drejtojë pyetjen kah ndonjë fëmijë tjetër ose t'i drejtohet tërë klasës, duke kërkuar përgjigje, koment ose ndonjë shpjegim për atë çështje;
 - t'i përgjigjet pyetjes së fëmijës përmes orientimit të vëmendjes së tij kah gjërat të cilat vetë mund të nënkuptohen në përgjigje dhe në atë mënyrë t'i ndihmojnë fëmijës të përgjigjet në pyetjen e tij.
- **Dëgjimi i pyetjes me vëmendje:** Shikojeni fëmijën derisa ai flet; jepni shenjë se po e përcillni duke e lëvizur kokën; vërtetoni se e kuptoni me të vërtetë atë që e thotë ai përmes formulimit të pyetjes.
- **Nxitja e diskutimeve ndërmjet fëmijëve:** Inkuadrojeni pjesën më të madhe të fëmijëve në orvatjet e tyre që të përgjigjen në pyetjet e caktuara.

Shembull i aktivitetit 2.12.

Parashtrimi i pyetjeve për NAM

Fusha programore/ lënda mësimore:	Matematikë
Tema mësimore:	Numrat
Njësia tematike:	Thyesat
Qëllimi/ detyra programore:	Të aftësohet fëmija t'i identifikojë thyesat dhe format ekuivalente të thyesave me emërues 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10 dhe 12.
Niveli klasor:	Klasa e tretë dhe e katërt

Bon O'Brien u mban mësim njëzet e shtatë djelmohave dhe vajzave të klasës së katërt. Fëmijët tashmë një javë në orët e matematikës punojnë më thyesa. Arsimtarja, duke i parashtruar pyetje tërë paraleles, dëshiron ta kontrollojë se sa i kanë mësuar ata thyesat. Ajo fillon me një pyetje fillestare për të marrë përgjigje lidhur me njohuritë e mëparshme.

Bon O'Brien: *Çka paraqet thyesa? (ajo pret rreth pesë sekonda para se t'i thotë Anës të përgjigjet)*

Ana: *Thyesa është një numër i vogël.*

Bon O'Brien: *(e përsërit përgjigjen e Anës para të gjithë fëmijëve): Thyesa është një numër i vogël. (Pastaj ajo parashtron edhe një pyetje që ta qartësojë përgjigjen e Anës). A mund ndokush të më thotë se çka mendon me fjalën numër i vogël? (përsëri pret pesë sekonda. Këtë herë i drejtohet Llukës i cili nuk e ka ngrit gishtin, që ai të përgjigjet në pyetje.)*

Lluka: *Thyesa është numër i vogël, sepse nuk është patjetër ta kesh gjithë tërësinë e një gjëje.*

Bon O'Brien: *(e fton Llukën ta shpjegojë përgjigjen e tij duke e pyetur): A mund të ma sjellësh një shembull?*

Lluka: *Për shembull, nëse shkon në ndonjë festë të ditëlindjes dhe aty ka tortë, e cila duhet t'u ndahet të gjithë fëmijëve të pranishëm, ashtu që secilit prej tyre do t'i jepet vetëm një pjesë e tortës.*

Bon O'Brien: *Në rregull! Atëherë pse ka dy numra nën një thyesë? (Ajo e vëren një thirrje joverbale nga Pjeri dhe i jep shenjë me sy që të përgjigjet.)*

Pjeri: *Pra, nëse ka vetëm një tortë, atëherë kjo duhet të tregohet si numri 1 është i ndarë me numrin e fëmijëve të pranishëm mes të cilëve do të duhet të ndahet. Për shembull, të themi, nëse ka pasur tetë fëmijë, ajo duhet të tregohet si $1/8$ (një e teta).*

Bon O'Brien: *(E lëviz kokën në shenjë të miratimit të përgjigjes së Pjerit): Tani unë do të dëshiroja që ju të mendoni për këtë pyetje dhe ta shënoni përgjigjen. A jeni të gjithë të gatshëm? Nëse Ana e ka marrë $2/16$ e tortës, ndërsa Lluka $1/8$ e tortës, cili prej tyre ka marrë më shumë tortë?*

Una: *Unë mendoj se Ana ka fituar më shumë për shkak se 16 është më e madhe se 8 .*

Bon O'Brien: *A ka Una të drejtë?*

Tadigu: *Jo, Una nuk ka të drejtë sepse $2/16$ dhe $1/8$ janë të barabarta.*

Bon O'Brien: *Ky është një vështrim interesant Tadig. (Pastaj ua jep një detyrë që t'i nxisë fëmijët të ofrojnë informacione personale dhe opinione për temën e thyesave.) Këtë orë do të dëshiroja të punoni në grupet tuaja. Pyetja të cilën do të dëshiroja që secili grup t'i përgjigjet është: Kur mund të thoni se dy thyesa janë të barabarta? Para jush e keni një laps dhe një letër. Keni gjithsej dhjetë minuta t'i përgatitni përgjigjet tuaja në formë të prezantimit televiziv. Prej secilit grup do të kërkohet ta prezantojë përgjigjen e vet para klasës.*

Shembull i aktiviteti 2.13.

Parashtrimi i pyetjeve për mbështetje të NSHM-së

Fusha programore:	Arsimimi shoqëror, ekologjik dhe natyror-shkencor
Lënda mësimore:	Shkenca natyrore
Tema mësimore:	Energjia dhe forcat natyrore
Njësia tematike:	Tingujt
Detyra programore:	Fëmija duhet të aftësohet të bëjë skicë dhe përgatisë instrumente të thjeshta goditëse
Niveli klasor:	Klasa e parë dhe e dytë

Z. Trejnor njëzet e dy fëmijëve të klasës së parë dhe ty dytë u mban mësim në temën "Tingulli". Ai fillon me pyetje të cilat e orientojnë vëmendjen e tyre. Së pari e godet me një pirun anën e jashtme të një kavanozi të zbratur për xhem.

Z. Trejnori: *Çfarë tingulli mund të dëgjoni? A është i lartë ose i ulët?*
Mario: *Është tingull i lartë.*

Z. Trejnori e plotëson kavanozin me ujë deri në mes dhe përsëri e godet atë. Kësaj radhe ai përdor pyetje krahasuese.

Z. Trejnori: *A është tani tingulli më i lartë ose më i ulët sesa ishte herën e kaluar?*
Sara: *Më i ulët!*
Z. Trejnori: *Çka mendoni se do të ngjajë me tingullin nëse në kavanoz fusim më shumë ujë?*

Nga fëmijët kërkohet ta parashohin rezultatin. Ky proces përsëritet disa herë duke shtuar më shumë ujë ose duke e zvogëluar sasinë e tij. Kur fëmijët të merren vesh për mundësitë e niveleve të ndryshme të ujit në kavanoza, z. Trejnori vendos se ata janë të gatshëm për zgjidhjen e pyetjeve problemore. Ai ia jep një detyrë një grupi prej gjashtë fëmijëve që ata të orvaten të kompozojnë melodi duke shfrytëzuar kavanoza dhe ujë. Një grupi tjetër prej gjashtë nxënësve ua jep për detyrë të bëjnë shirita të ndryshëm elastik dhe kuti të kartonit, ndërkaq grupit të tretë ia jep disa mjete të ndryshme për goditje (lugë, vizore etj.) si dhe mjete tjera të ndryshme të klasës për t'i hulumtuar tingujt duke shfrytëzuar materiale të ndryshme.

Në fund të aktivitetit secili grup i prezanton konstatimet e tyre me çka z. Trejnor është në gjendje të vlerësojë se çka ka mësuar secili anëtar i grupeve duke përdorur me këtë rast pyetje plotësuese dhe mbikëqyrje.

Vëzhgimi i punës së nxënësve nga arsimtari

Çka paraqet vëzhgimi i punës së nxënësve nga arsimtari?

Vëzhgimi i punës së nxënësve nga arsimtari, pavarësisht se a është spontane ose e planifikuar, gjithnjë mund të shfaqet në bashkëveprim ndërmjet arsimtarit dhe nxënësit.

Vëzhgimi i arsimtarit në orë i ofron disa informacione më të drejtpërdrejta dhe të sakta lidhur me mësimin e fëmijës. Kur përcjellja nga ana e arsimtarit do të formohet në formë të shënimeve me shkrim, kjo i mundëson ta përshkruajnë diturinë e një nxënësi në kontekstin e dhënë. Evidenca e këtillë mund të sigurojë që planifikimi i punës së ardhshme të fëmijëve të caktuar, të grupeve ose të tërë paraleles të jetë më e orientuar dhe më sistematike.

Cila është vlera e vëzhgimit nga arsimtari si metodë e notimit?

Arsimtari mund të mbledh informacione për mësimin e fëmijës përmes regjistrimit të detajeve lidhur me atë se çka flet ose çka bën fëmija, aq më tepër përmes mënyrës se si i tregon ose si i bën gjërat. Ai mund t'i identifikojë nevojat arsimore dhe prirjet e fëmijës dhe mund të vlerësojë se sa është efektiviteti i përmbushjes së nevojave të orës. Vëzhgimi i mundëson arsimtarit informacione lidhur me atë se si komunikon dhe punon fëmija me fëmijët e tjerë. Pra, i ndihmon ta notojë jo vetëm aftësinë e fëmijës për t'i përdorë shkathtësitë dhe dituritë edhe në programet tjera mësimore, por gjithashtu i ndihmon që ta shfrytëzojë aftësinë e tij që t'i përdor edhe materialet dhe resurset mësimore.

Vëzhgimi i ndihmon arsimtarit t'i gjejë nivelet e ndryshme të suksesit me të cilin fëmija i përvetëson aftësitë dhe dituritë e ndryshme dhe, në bazë të kësaj, ta përshtatë mësimin dhe kontekstin arsimor. Disa dituri dhe aftësi të përvetësuara nga nxënësi më së mirë vëzhgohen gjatë ndonjë aktiviteti dhe, në këtë mënyrë, Vëzhgimi i arsimtarit shpeshherë mund të jetë mënyra e vetme përmes së cilës ai do ta notojë saktë përparimin e ndonjë fëmije.


Programet mësimore për shkollë fillore rekomandojnë zbatim të vëzhgimit të arsimtarit në të gjitha lëndët mësimore. Ekzistojnë disa mënyra të ngjashme për përcjelljen e punës së fëmijëve nga ana e arsimtarit. (shih diagramin 3 fq. 43)

Si përdoret vëzhgimi nga arsimtari?

Vëzhgimi nga arsimtari paraqet pjesë të punës në orë. Ajo përfshin dëgjim dhe shikim dhe kërkon nga arsimtari ta vërejë, dallojë dhe reagojë ndaj mendimit dhe aktivitetit të fëmijës. Vëzhgimi mund të fokusohet në një nxënësi ose në ndonjë grup të caktuar, por të gjithë fëmijëve nuk u nevojitet nivel i njëjtë i përcjelljes gjatë tërë kohës. Vëzhgimi mund të fokusohet në një nxënësi ose në ndonjë grup, mirëpo nuk ka nevojë për nivel të njëjtë të vëzhgimit për tërë fëmijët gjatë gjithë kohës. Vëzhgimi bëhet spontanisht derisa fëmijët janë të angazhuar në aktivitete arsimore dhe vëzhgimet e tilla mund të regjistrohen. Vëzhgimi më efektiv dhe më i gjithanshëm i ndonjë fëmije është ai që është i planifikuar dhe i cili regjistrohet në një mënyrë të strukturuar dhe të fokusuar.

Kur duhet të përdoret vëzhgimi nga arsimtari?

Vëzhgimi mund të zbatohet në çdo kohë nga arsimtari. Për shembull, ndonjë arsimtar mund të vendosë ta përcjellë diskutimin në kuadër të ndonjë grupi të caktuar në klasë ose punën e ndonjë fëmije me vështirësi në mësim. Ai bën orar të posaçëm për ta vëzhguar fëmijën ose grupin, ku mund të përfshijë organizim të punës grupore për fëmijët tjerë, të sigurojë bashkëpunim me ndonjë kolegë dhe/ose të përgatit fletë kontrolluese. Vëzhgimi zakonisht bëhet gjatë një periudhe të shkurtër kohore. Arsimtari e vëzhgon nxënësin ose grupin derisa i realizon detyrat e planifikuara dhe/ose i regjistron informacionet relevante. Vëzhgimet e mëtejme mundësojnë vëzhgime të vazhdueshme të fëmijës ose të grupit.



Vëzhgimi i orientuar në fëmijë të caktuar:

fokusohet vetëm në një fëmijë; kombinohen një sërë vëzhgimesh për ta pasqyruar zhvillimin e posaçëm të fëmijës.

Vëzhgimi i aktiviteteve të caktuara:

regjistrohen të arritura të caktuara të cilat janë karakteristike për skemën e sjelljes së fëmijës në një periudhë të caktuar kohore.

Vëzhgimi në periudha të pacaktuara kohore:

përfshin vëzhgime të përsëritura, të shkurtra dhe të fokusuara në zhvillimin e ndonjë fëmije; ato mund të përdoren për grumbullimin e të dhënave precize gjatë një periudhe më të gjatë kohore.



Vëzhgimi anekdotik:

spontane ose i planifikuar; paraqet tregim narrativ me shkrim për momente interesante të zhvillimit të sjelljes së ndonjë fëmije.

Vëzhgimi më afatgjatë:

Paraqet vëzhgim të dokumentuar, të planifikuar dhe sistematik të aspekteve të mësimin dhe të sjelljes; mund të përfshijë një fëmijë, një grup në paralele ose tërë paralelen, madje edhe tërë shkollën.

Shembull i aktivitetit 2.14. Vëzhgimi i orientuar kah puna e ndonjë fëmije

Fusha programore:	Gjuhë
Lënda mësimore:	Gjuhë angleze
Tema mësimore:	Aftësitë dhe vetëbesimi në përdorimin e gjuhës / të shprehurit me gojë Të shprehurit me gojë: zhvillimi i aftësisë dhe vetëbesimit në përdorimin e gjuhës gojore
Njësia tematike:	Kompetenca dhe vetëbesimi në përdorimin e gjuhës
Detyra programore:	Fëmija të aftësohet të zgjedhë fjalë të qëlluara që të emërtojë dhe përshkruajë sende dhe ndodhi.
Niveli klasor:	Klasat fillestare

Eni i ka katër vjet e gjysmë. Arsimitarja e saj, Sjoban, është e brengosur për zhvillimin e aftësive gjuhësore të saj, por në veçanti është e brengosur për aftësitë e dallimit të ngjyrave. Ajo planifikon që ditën e ardhshme ta vëzhgojë Enin dhe shoqen e saj më të mirë Ketin derisa ato zbaviten duke luajtur ndonjë lojë të lirë. Sjobani e di se Eni dhe Keti dëshirojnë të vishen me rroba të ngjyrave të ndryshme, andaj ua sjell disa rroba me ngjyra të ndryshme që t'i provojnë. Keti e zgjedh një pallto të kaltër nga varësja, i çel pullat dhe e vesh. Pastaj me kujdes i mbyll pullat dhe me kënaqësi shikohet në pasqyrë. *E dua ngjyrën e kaltër* – i thotë ajo Enit, e cila mundohet ta veshë një xhemper ngjyrë trëndafil. Eni e vesh xhemperin mbi kokë, por nuk mund t'i fus duart në mëngë. Sjobani e pyet a ka nevojë për ndihmë. *Jo* – ia kthen ajo. *Vetë do ta vesh*. Keti qeshet dhe i ndihmon ta veshë xhemperin si duhet. *Çfarë ngjyre është xhemperi yt* – e pyet Sjobani. *I gjelbër* – thotë ajo. *Jo* – thotë Keti. *Xhemperi yt është ngjyrë trëndafil! Dukemi bukur me këto rroba!*

Atë pasdite, pasi të shkojnë në shtëpi nxënësit e klasës, Sjobani e hap një faqe të re në fashikullin e saj në kompjuterin klasës. Ajo e hap dosjen e quajtur: Keti.

Duke e kontrolluar dokumentin ajo në fund shkruan:

Shembull i shënimeve të arsimtarit për Ketin

21 tetor

Mirë i mbyll pullat.
E njeh ngjyrën e kaltër dhe ngjyrën e trëndafil.
U ndihmon shokëve.

Në dosjen e Enit ajo shkruan:

Shembull i shënimeve të arsimtarit për Enin

21 tetor

Shfaq vonesë të caktuar në gjuhë.
Ka nevojë për ndihmë në veshje.
Nuk e dallon mirë ngjyrën e gjelbër dhe ngjyrën e trëndafil.
Dëshiron vetë t'i bëjë punët.

Sjobani i regjistron informacionet e reja dhe i mbyll dosjet në kompjuter. .

Shembull i aktivitetit 2.14. (Vazhdim)

Para përfundimit të javës, Sjobani punon me klasën për ngjyrat të cilat tashmë i kanë punuar. Përmes pyetjeve plotësuese ajo e kupton se duhet të bëjë dallim ndërmjet fëmijëve të cilët njohin shumë ngjyra dhe atyre të cilët ende “mundohen” me ato ngjyra të cilat janë përpunuar nëpër orët e mësimi. Ajo e vëren se Keti dhe tre fëmijë të tjerë i dallojnë dhe mund t’i thonë emrat e të gjitha ngjyrave të cilat ajo planifikon t’i përpunojë gjatë orëve në paralelen e atij viti shkollor. Derisa fëmijët punojnë në çifte në një program të kompjuterit për ngjyra, Sjobani bën përsëritje të atyre ngjyrave të cilat tashmë i kanë përpunuar. Ajo i përkushton vëmendje të posaçme Enit e cila ende “mundohet” me to. Ndërkohë e nxit t’i thotë emrat e ngjyrave dhe të përdorë sa më shumë fjalë lidhur me ngjyrat.

Derisa Sjobani vazhdon ta vëzhgojë Enin dhe të mbajë shënime për atë se si ajo e shfrytëzon të shprehurit me gojë, e kupton se ka vonesë në zhvillimin e saj gjuhësor. Ajo e informon drejtorin e shkollës për këtë rast dhe me të merren vesh se duhet të diskutojnë me nënën e Enit lidhur me rastin e bijës së saj. Sjobani pajtohet se ajo duhet ta nxisë Enin të përdorë forma më të komplikuarra gjuhësore. Ajo ia huazon nënës së Enit një libër nga biblioteka e shkollës i cili ka të bëjë me ngjyrat. Ata arrijnë në përfundim se Eni do të ketë nevojë për ndihmë të posaçme profesionale në zhvillimin e gjuhës dhe pajtohen që do ta përcjellin përparimin e saj gjatë disa muajve të ardhshëm.

Shpesh herë Sjobani i kontrollon në kompjuter dosjet e fëmijëve para se ta përgatisë planifikimin e orëve. Në takimet me prindërit ajo ua hedh një vështrim dosjeve të cilat i ka përgatitur gjatë disa javëve për secilin fëmijë. Ajo konsideron se dosjet janë jashtëzakonisht të dobishme me rastin e përgatitjes së raporteve për fëmijët në librezat e shkollës në fund të vitit shkollor.

Shembull i aktivitetit 2.15. Vëzhgimi më afatgjatë

Fusha programore:	Arsimimi shoqëror, ekologjik dhe natyror-shkencor
Lënda mësimore:	Histori
Tema mësimore:	Studim i rajonit tim
Njësia tematike:	Vendi im nëpër shekuj
Detyra programore:	Të aftësohet fëmija të studiojë ndonjë periudhë të caktuar të fshatit lokal, qytetit, rrethinës së qytetit, komunës, qarkut ose shtetit.
Niveli klasor:	Klasa e tretë dhe e katërt

Në grupet e klasës së tretë dhe të katërt ka njëzet e katër fëmijë të cilëve u mban mësim z. O'Grejdi. Në shtator ai e ndan paralelen në dy ekipe që të bëjnë udhëtim nëpër historinë e muzeut lokal. Secili ekip përbëhet nga fëmijë me shkathtësi të përziera dhe ka së paku nga një nxënës të klasës së tretë dhe nga një nxënës të klasës së katërt. Ekipet e kanë për detyrë t'i përcjellin drejtimet e dhëna, t'i kërkojnë përgjigjet dhe të gjejnë ndonjë eksponat të ekspozuar që t'i plotësojnë fletët e punës të cilat paraprakisht ua ka përgatitur z. O'Grejdi. Gjatë disa javëve të ardhshme ekipet do të përgatisin modele për disa eksponate të muzeve dhe do të japin raport për konceptimin dhe përpunimin e modelit. Z. O'Grejdi e fton në paralele edhe një prind që t'u bashkëngjitet në vizitën e muzeut. Së bashku me paralelen shkon edhe një nxënës i vitit të fundit të një shkolleje të mesme vendore, i cili është duke e kryer praktikën e shkollës.

Z. O'Grejdi ka planifikuar ta përcjellë punën e njërit nga ekipet. Meqenëse janë në fillim të vitit shkollor, ai dëshiron ta studiojë bashkëveprimin social të anëtarëve të ekipit që të shohë se a mund të punojnë ata mirë duke bashkëpunuar mes vete. Ai gjithashtu planifikon t'i përcjelljë prirjet e tyre individuale. Z. O'Grejdi e vëren se Grejti dallohet si udhëheqës gjatë fazës së parë të projektit. Ajo cakton detyra dhe e organizon regjistrimin e konstatimeve të tyre. Një fëmijë tjetër, Xhejmsi, shfaq interes të vogël për mbajtjen e shënimeve ose për leximin e fjalëve themelore. Erini, e cila punon për çdo ditë me arsimtarin për mbështetjen e saj në mësim, gëzohet që mund t'i ndjekë fëmijët e tjerë në ekip prej një eksponati në eksponatin tjetër, mirëpo ajo është e ngadalshme në sugjerimet e saj. Antonio pyet se a mund ta përdor kamerën digjitale të shkollës të cilin z. O'Grejdi e ka sjellë nga shkolla që të jetë në shërbim të fëmijëve. Antonio me kujdes e incizon një videoklip të ekipit derisa ata punojnë. Ai i fotografon eksponatet e ekspozuara sipas të cilave ekipi do të duhet të përpunojë modele.

Xhejmsi duket si i painteresuar derisa ata janë në muze. Mirëpo, kur kthehen në klasë, në fazën e konceptimit dhe përgatitjes, ai jep sugjerim për mënyrën e përpunimit të modelit. Pas diskutimit, anëtarët e ekipit tjetër pranojnë t'i ndjekin idetë e tij. Antonio i bën edhe disa fotografi derisa ekipi e përpunon modelin. Me pak ndihmë nga nxënësi i shkollës së mesme, Grejti dhe Antonio i hedhin fotografitë dhe videoklipin në kompjuterin e paraleles dhe i skanojnë fletët e tyre të plotësuar. Kur fëmijët e përfundojnë projektin, ftohen prindërit e tyre në shkollë që ta shohin punimin. Erini me krenari e informon paralelen dhe prindërit për mënyrën se si ka punuar ekipi në muze dhe si do ta përpunojnë ata modelin. Xhemsi i thekson karakteristikat e veçanta të modelit. Antonio dhe Grejti, përmes slajdeve, i paraqesin fotografitë dhe fletët e punës të skanuara dhe kështu e paraqesin videoklipin e shkurtër.

Shembull i aktivitetit 2.15. (vazhdim)

Derisa fëmijët punojnë në modelin e tyre, z. O'Grejdi merr shënime të shkurt-ra. Pastaj ai merr shënime plotësuese derisa ata punojnë në shkollë. Merr shënime edhe për prirjet e tyre dhe për aftësitë për mësim. Mban shënime edhe për kontri-butin e secilit fëmijë në punën grupore, me çka i paraqet aftësitë dhe interesat e tij/saj.

Shembull i shënimeve të arsimtarit

Grejni	Ka dëshirë për rol udhëheqës – është e organizuar – posedon shkathtësi të mira kompjuterike.
Antonio	Posedon shkathtësi të mira kompjuterike – është fotograf shumë i mirë – dëshiron të punojë në mënyrë individuale.
Erini	Bën prezantim shumë të mirë gojor të ideve.
Xhejmsi	Siç duket, ka interes të vogël për lexim dhe shkrim – posedon ide të mira për përpunimin e modelit – gjithashtu ka aftësi të marrë rol udhëheqës.

Z. O'Grejdi i fut shënimet e bëra në dosjet e kompjuterit. Pastaj e nxit secilin fëmijë të grupit të punojë në përmirësimin e anëve të fuqishme të tij gjatë pjesës tjetër të gjysmëvjetorit. Ai zhvillon diskutim me kolegët e tij për prezantimin gojor të Erinit dhe për mbështetjen e saj në mësim. Ata pajtohen t'i ndihmojnë Erinit në zhvillimin e aftësive të saj për prezantim verbal tani për tani duke u kushtuar më pak kujdes detyrave të saj më shkrim. Ai dhe Xhejmsi pajtohen për mënyrat alternative për mbajtjen e shënimeve. Xhejmsi është i kënaqur që përdor harta mendore cilat kërkojnë më pak shkrim në një periudhë të shkurtër kohore. Më pas, gjatë vitit shkollor, Grejni ndihmon në punën e shtypjes së gazetës së shkollës. Aftësitë fotografuese të Antonios shfrytëzohen gjatë manifestimeve të veçanta në shkollë, siç është Dita e Sportit dhe ekskursionet shkollore.

Z. O'Grejdi planifikon ta përcjellë punën e grupeve gjatë tërë gjysmëvjetorit derisa ata i realizojnë detyrat e tyre. Ai i përdor shënimet që të fitojë informacione për planifikimin e orëve dhe kur t'ua dorëzojë raportet prindërve.

Shembull i aktivitetit 2.16. Vëzhgimi i aktiviteteve të caktuara

Fusha programore/ lënda mësimore:	Edukatë fizike
Tema mësimore:	Lojëra
Njësia tematike:	Gjuajtja, pranimi dhe hedhja e topit
Detyra programore:	Të aftësohet të zhvillojë dhe praktikojë shkathtësi të ndryshme për manipulim me top.
Niveli klasor:	Klasa e tretë dhe e katërt

Paralelja e Liamit, e përbërë nga fëmijët e klasës së tretë dhe të katërt, tashmë disa javë punon në shkathtësitë për driblim dhe gjuajtje të topit në lojën e basketbollit. Para se të kalojë në shkathtësitë e ardhshme, Liam dëshiron ta kontrollojë përparimin e secilit fëmijë.

Ai në kompjuter përgatit fletë kontrolluese. I fut emrat e fëmijëve, datën dhe shkathtësitë të cilat dëshiron t'i përcjellë. E shtyp fletën kontrolluese në printer dhe gjatë dy orëve të ardhshme të edukatës fizike ai e shënjon secilin katror gjegjës përderisa e përcjellë se si e demonstroi fëmija secilën shkathtësi. Aty ku ka nevojë ai bën shënime shumë të shkurtra të cilat do t'i ndihmojnë atij në planifikimin e orëve të ardhshme të basketbollit. (Shih shembujt e dhënë më poshtë).

Shembull i fletës kontrolluese për klasën e tretë që është përgatitur nga arsimtari

Klasa e tretë, data: 25.09.07				
Emri	Driblim	Gjuajtje përmbi kokë	Udhëheqje dhe gjuajtje e topit	Hedhje me gjoks
Majkëll	✓	✓	✓	✓
Brin	E humb topin nëse nuk shikon në të tërë kohën.	✓	✓	✓
Xhejn	✓	✓	✓	✓
Brajan	✓	✓	✓	✓
Meri	Koordinim i dobët sy – dorë.	✓	Nuk mund ta kontrollojë topin.	✓

Shembull i fletës kontrolluese për klasën e katërt që është përgatitur nga arsimtari

Klasa e katërt, data: 25.09.07				
Emri	Driblim	Gjuajtje përmbi kokë	Udhëheqje dhe gjuajtje e topit	Hedhje me gjoks
Sile	E humb topin nëse nuk shikon në të tërë kohën.	✓	Nuk mund ta kontrollojë topin.	✓
Oisin	Koordinim i dobët sy – dorë.	✓	Nuk mund ta kontrollojë topin.	✓
Kllaudija	✓	✓	✓	✓
Kumar	✓	✓	✓	✓
Olivija	Koordinim i dobët sy – dorë.	✓	Nuk mund ta kontrollojë topin.	✓

Ai i ruan fletët që individualisht t'ua tregojë fëmijëve nivelin e aftësive të tyre, si dhe t'ua tregojë ato prindërve të tyre në takimet me ta në atë vit shkollor. Ai gjithashtu i shfrytëzon këto fletë me rastin e përgatitjes së raporteve me shkrim për nxënësit.

Detyra dhe teste të përgatitura nga arsimtari

Çka paraqesin detyrat dhe testet e përgatitura nga arsimtari?

Detyrat dhe testet mund të kenë formë të notimeve me shkrim ose me gojë ose mund të paraqesin detyra praktike të përgatitura nga arsimtari për ta notuar mësimin e fëmijëve. Ato mund të shfrytëzohen gjatë tërë viti shkollor si bazë për notim të vazhdueshëm (**NSHM**). Detyrat dhe testet gjithashtu mund të shfrytëzohen edhe në fund të vitit shkollor ose në fund të ndonjë periudhe të caktuar për mësim të temës programore për shkak të **NAM-it**. Megjithatë detyrat dhe testet mund të shërbejnë njëkohësisht për **NSHM** dhe **NAM**, ngase arsimtarët fillimisht duhet të raportojnë për rezultatet e detyrave dhe testeve, e pastaj t'i shfrytëzojnë rezultatet që të vendosin se çka do të ligjërojnë dhe si t'i qasen secilës temë.

Cila është vlera e detyrave dhe testeve të përgatitura nga arsimtari si metodë notimi?

Detyrat dhe testet u japin mundësi fëmijëve ta shfaqin nivelin e tyre të të kuptuarit (ose të keqkuptuarit) dhe aftësitë e tyre, si dhe ofrojnë informacione të vlefshme të cilat mund të përdoren për planifikimin e punës së mëtejshme të orientuar kah nevojat e nxënësve.

Drejtimet e përgjithshme për përgatitjen e testeve të titipit laps e letër të përgatitura nga arsimtari

- Në fillim përcaktojeni qëllimin e testit dhe konceptojeni testin që të mund ta arrini atë qëllim.
- Orvatuni t'i formuloni ato pyetje të cilat kanë të bëjnë me interesat e fëmijëve për shkak se kjo ndihmon që testi të jetë relevant dhe motivues për fëmijët.
- Filloni me disa pyetje të lehta në të cilat secili fëmijë mund të përgjigjet; në këtë mënyrë do t'u ndihmoni ta tejkalojnë nervozën dhe të ndjenjë vetëbesim se mund të arrijnë sukses.
- Përfshini së paku dy lloje të problemeve në teste. Kur ka vetëm një lloj problemi në fletë, fëmijët e plotësojnë shpejt skemën e tillë dhe kjo i dekurajon që të lexojnë më shumë dhe të mendojnë për problemet. Problemet e reja duhet të përzihen me ato të cilat fëmijët tashmë mund t'i zgjidhin që t'u jepen mundësi t'i shfaqin nivelet e ndryshme të integritit të diturive dhe nivelet e ndryshme të aftësive.
- Përpiloni sa më shumë pyetje duke e përdorë strukturën e thjeshtë të fjalisë kryefjalë-kallëzues-strukturë kundrinore, madje edhe nëse kjo bën që të përdoren më shumë fjalë. Për shembull, në vend se të shkruani:

Shembulli A

*Ngjyra e kaltër për vizatim i shtohet një kavanozi i cili përmban ujë me ngjyrë të verdhë.
Ngjyra e ujit ndryshohet.
Çfarë ngjyre ka ajo tani?*

Pyetja mund të formulohet kështu:

Shembulli B

*Laura ka kavanoz në të cilin ka ujë me ngjyrë të verdhë.
Ajo në kavanoz fut ngjyrë të kaltër për ngjyrosje.
Ngjyra e ujit në kavanoz ndryshohet.
Çfarë ngjyre ka tani?*

Përdorimi i emrit të fëmijës, siç është në shembullin B, gjithashtu mundëson shfrytëzim të strukturave me të thjeshta të drejtpërdrejta të fjalive.

- Shmanguni nga përdorimi i dyfishtë i formave mohore të pyetjeve.
- Mendoni për pamjen grafike të testit dhe për atë se si do të prezantohen informacionet. Për shembull, një pyetje e ndarë duhet të jetë një faqe që t'u mundësojë fëmijëve që më lehtë t'i përcjellin pyetjet.
- **Informacionet kryesore jepni me shkronja të errëta.** Shfrytëzimi i fotografive dhe i diagrameve të titulluara do të mund të ndihmojnë që pyetjet të bëhen më të qarta.
- Kombinoni pyetje të ndryshme që të mund të notohen aftësitë e fëmijëve për të menduar dhe metodat e përdorura. (Për më shumë informacione lidhur me përgatitjen e test-pyetjeve, shih Shtojcën A, fq. 83-84.)

Si përdoren detyrat e përgatitura nga arsimtari?

Shumica e detyrave të përgatitura përfshijnë punë të fëmijëve në grupe më të vogla. Që të notohen ato, rekomandohet nivel i lartë i ndërveprimit ndërmjet arsimtarit dhe grupit të nxënësve. Që të mundësohet kjo, arsimtari do të mund të vendosë që vetëm një grup do të punojë në atë aktivitet, ndërsa fëmijët e tjerë të angazhohen në aktivitet tjetër i cili nuk kërkon praniose mbikëqyrje të madhe nga arsimtari. (Shih Shtojcën A, fq. 88, për një udhëzim për përdorimin e shembullit të fletës për planifikimin e detyrave dhe Shtojcë B, fq. 88, për fletën e planifikimit që mund të fotokopohet.)

Informacionet kthyesë për detyrat dhe testet

Përdorimi i notave ose shpërblimeve eksterne, siç janë kartat për informacione kthyesë për detyrat dhe testet, zakonisht ka kohë të kufizuar për fëmijët në NSHM. Qëllimi kryesor i dhënies së informacioneve kthyesë është që fëmijëve t'u jepen informacione për atë se ku kanë arritur ata sukses lidhur me qëllimet arsimore dhe ku do të mund të përmirësoheshin. Fëmijët kanë nevojë për kohë të caktuar që t'i lexojnë ose të bisedojnë për informacionet kthyesë, si dhe që të bëjnë përmirësime duke u bazuar në informacionet e tilla.

Shembull i aktivitetit 2.17. Përdorimi i testeve

Fusha programore:	Arsimimi shoqëror, ekologjik dhe natyror-shkencor
Lënda mësimore:	Shkencat natyrore
Tema mësimore:	Bota e gjallë
Njësia tematike:	Bimët dhe shtazët
Detyra programore:	Të aftësohet fëmija ta grupojë dhe ta klasifikojë botën e gjallë sipas karakteristikave të caktuara.
Niveli klasor:	Klasa e parë dhe e dytë

Zonja Sojers mban mësim në paralele të kombinuara me njëzet e pesë nxënës të klasës së parë dhe të dytë. Duke u ndërlidhur me përvojën e fëmijëve në kalsifikim dhe krahasim, ajo e fillon aktivitetin me tërë paralele duke kërkuar që të gjithë të ulen në qilim dhe ta shikojnë ilustrime me fotografi të kafshëve të varura në tabelë. Ajo kërkon nga fëmijët të zgjedhin një fotografi të pazakonshme dhe të thonë se pse e kanë zgjedhur pikërisht atë. Fotografitë e kafshëve janë të zgjedhura që t'i orientojnë fëmijët drejt një fjalori të caktuar (për shembull: gjitarë, vezëbërës, karakteristika sipas të cilave dallohen insektet etj.). Ajo e vëren se fëmijët e kanë më lehtë t'i përcaktojnë dallimet e bazuara në karakteristikat vizuale, andaj i nxit që t'i thonë ato në mënyrë verbale dhe të shpjegojnë se cilat janë ngjashmëritë përkatëse.

Ajo e përgatit një test të shpejt joformal i cili përfshin aktivitete të diferencuara me qëllim që ta notojë të menduarit e fëmijëve për karakteristikat të cilat janë relevante për klasifikim shkencor. Ky test u jep fëmijëve mundësi të përdorin fjalor specifik në mënyrë që të zbulohet se si i kuptojnë ata termat e rëndësishëm për klasifikim.

Për fëmijët më të vegjël ose për fëmijët me aftësi më të vogla, zonja Sojers e sajton një lojë të quajtur "Në rreth". Fëmijët punojnë në çifte me një rreth për kategorizim dhe një pako të letrave për lojë me fotografitë e kafshëve. Ajo u jep për detyrë t'i gjejnë ato të cilat kultivohen në ferma dhe i fut në rreth. Zonja Sojers parashton pyetje për kafshët brenda dhe jashtë rrethit. Pastaj u thotë fëmijëve t'i nxjerrin të gjitha kafshët nga rrethi dhe të vendosin kafshë të tjera (për shembull, kafshë të cilat e kalojnë dimrin në gjumë të thellë).

Pastaj znj. Sojers, fëmijëve më të rritur dhe atyre me aftësi më të mëdha, ua prezanton një tabelë (të pazakonshme që nuk gjendet në tabelën e klasës) i cili përmban emra të kafshëve (shih më poshtë).

Shembulli i tabelës me emrat e kafshëve


ketri	ariu polar	lopa
iriqi	pinguini	lakuriqi
dallëndyshja	flutura	pula

Ajo kërkon nga fëmijët ta zgjedhin një rresht ose një kolonë dhe ta dallojnë kafshën që nuk përket këtu duke i shënuar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre. Pastaj duhet ta theksojnë arsyen e zgjedhjes së tillë.

Shembull i aktivitetit 2.17. (vazhdim)

51

Shembull i formularit të plotësuar



Xhoni dhe Fiona e mbaruan shpejt këtë detyrë, andaj znj. Sojers ua parashtrori një detyrë tjetër me sfidë më të madhe. Ajo kërkoi prej tyre ta vizatojnë një tabelë të tyre me kafshë të pazakonshme dhe të gjejnë diçka që është e ngjashme për dy nga kafshët, gjegjësisht që është e ndryshme për kafshën e tretë.

Nga një grup prej gjashtë fëmijëve të klasës së dytë kërkohet ta zgjedhin nga një kafshë nga tabela dhe të përgatisin raport duke e shfrytëzuar formularin që ua ka dhënë znj. Sojers. (Shih shembullin e raportit në fq. 52). Çdo informacion që nuk e dinë e kërkojnë në internet. Tereza e kërkon fjalën ketër në portalin Google dhe i gjen disa ueb-faqe me informacione për këtë shtazë. Zonja Sojers e vëren se Tereza posedon aftësi t'i lexojë dhe t'i kuptojë informacionet e prezantuara në ueb-faqe që të mund ta përfundojë detyrën.

Kur të përfundojë me testet dhe me detyrat, znj. Sojers i mbledh të gjitha tabelat dhe raportet. Në raportet e saj si arsimtare ajo shkruan shënime të shkurtra për atë që e ka bërë çdo fëmijë dhe me çfarë vështirësish është ballafaquar. Për shembull, ajo zbulon se Klodaga nuk punon me aq sukses sa ka pritur ajo prej saj. Përkundër asaj se Klodaga i ka theksuar disa karakteristikat, siç është ngjyra, ajo nuk e ka përmendur asnjë nga karakteristikat kryesore shkencore të cilat i kanë përpunuar në paralele. Zonja Sojers i bën vërejtje Klodagas se duhet t'i theksojë disa nga karakteristika kryesore të klasifikimit të kafshëve.

Shembull i aktivitetit 2.17. (vazhdim)

52

Shembull i raportit

Raporti për qeniet e gjalla	
Emri: <i>Tereza</i>	Data: <i>21/06/07</i>
Titulli: <i>Ketri</i>	
Definicioni: <i>Ketri</i> është një <i>kafshë e vogël</i> Ai është një lloj i <i>gjitarëve.</i>	
Pamja: Si duket?	Ai është <i>kafshë e vogël me lëkurë të përhimët dhe të kuge dhe me bisht të dendur.</i>
Vendbanimi: Ku jeton?	Ai jeton <i>në strofull në drurë.</i>
Cikli i jetës: Si lind?	Jetën e fillon si <i>një qenie e vogël e gjatë 2 centimetra e gjysmë pa qime dhe pa dhëmbë.</i>
Si ndryshohet?	<i>7 rriten qimet, dhëmbët dhe bëhet i madh.</i>
Ushqimi: Me çka ushqehet?	<i>Ha arra, fara dhe pemë.</i>
Unë e di se <i>ato kafshë e kalojnë dimrin në gjumë të thellë.</i>	

Zonja Sojers ua kthen tabelat dhe raportet fëmijëve dhe gjatë disa ditëve të ardhshme ajo i ndan nga disa minuta që të bisedojë me secilin fëmijë lidhur me punën e tij. Ajo u rikthehet shumë pikave të cilat janë iniciuar në bisedat e këtilla mes arsimtarit dhe nxënësit që ta planifikojë punën e mëtutjeshme lidhur me ciklin e jetës së kafshëve. Njëra nga vërejtjet e saj është se fëmijët e kanë më lehtë ta përshkruajnë ciklin e jetës së kafshëve që kanë faza të posaçme të zhvillimit, siç është bretkosa ose flutura, ndërsa kanë vështirësi më të mëdha me gjitarët. Zonja Sojers i shqyrton rezultatet e procesit jetësor me qëllim që të parashtrijë detyra të ndryshme dhe t'i japë theks të veçantë ciklit jetësor të gjitarëve.

Testimi i standardizuar

Çka paraqet testimi i standardizuar?

Testet e standardizuara përdoren për matjen e shkathësisive të fëmijës në lexim dhe matematikë që ashtu të përcaktohet përparimi i fëmijëve në ato fusha⁴. Informacionet e testeve janë të rëndësishme për shkak të rolit vital që e ka njohja e leximit dhe e matematikës në mësimin e të gjitha lëndëve mësimore.

Testi i standardizuar paraqet instrument notimi i cili përmban procedura të standardizuara për zbatimin dhe dhënien e pikëve, si dhe për interpretimin e rezultateve. Me fjalë tjera, testi zbatohet, notohet dhe interpretohet pavarësisht se ku ose kur përdoret. Një numër i konsiderueshëm i testeve të standardizuara të cilat përdoren në shkollat e Irlandës janë të normuara për shkollat fillore të Irlandës dhe arsimtarët njoftohen me to. Termi të normuar d.m.th. se testet i mundësojnë arsimtarit ta krahasojë suksesin e ndonjë fëmije në test me suksesin e fëmijëve të atij niveli ose të asaj moshe në shkollat e tjera të Irlandës. Detyrat e testit, gjithashtu, kanë të bëjnë me përmbajtjen e *Planeve dhe programeve mësimore për shkollë fillore*. Rezultatet e notimit të standardizuar kur përdoren në kombinim me informacionet e metodave të tjera për notim kontribuojnë në precizitetin e përcjelljes nga ana e arsimtarit dhe ndihmojnë në identifikimin e nevojave individuale të fëmijëve.

Si grumbullohen dhe regjistrohen informacionet e notimit duke përdorur testim të standardizuar?

Të gjitha shkollat fillore në Irlandë e kanë për detyrë që dy herë gjatë vitit shkollor në arsim fillor të zbatojnë teste të standardizuara për gjuhë angleze dhe matematikë – në fund të klasës së parë ose në fillim të klasës së dytë dhe në fund të klasës së katërt dhe në fillim të klasës së pestë. Testet zakonisht i zbaton kujdestari i klasës, ndërsa kjo bëhet në bazë të kushteve të specifikuara në doracakun për testim që ashtu të sigurohet vlefshmëria e rezultateve të testit. Është e rëndësishme të bëhen përgatitje të mira për zbatimin e testeve.

Doracaku për testim jep udhëzime të hollësishme, mirëpo është shumë me rëndësi që të sigurohen kushte përkatëse në klasë dhe të zgjidhet koha më e mirë dhe paraprakisht të përgatiten të gjitha materialet e domosdoshme.

Arsimtarët i notojnë dhe u japin pikë testeve ashtu siç është përcaktuar në doracakun për testim. Doracaku gjithashtu përmban formularë për informacionet e testit të standardizuar. Rezultatet e ndara të testit të secilit fëmijë regjistrohen në dosjen e tij. (Për më shumë informacione për dosjen e nxënësve shih Temën 4, fq. 73). Për evidentimin e rezultateve të këtylla në librezën e nxënësve do të bëhet fjalë më tej në Temën 4.

Si interpretohen rezultatet e testeve të standardizuara?

Gjatë interpretimit dhe regjistrimit të rezultateve të testeve arsimtari duhet t'i njohë nocionet themelore, siç janë: rezultatet e përafërta, pikët e shkallës standarde, shkallët me përqindje dhe pikët në shkallën dhjetënivelëshe gjatë interpretimit dhe shënimit të rezultateve të testeve. Këto koncepte janë shpjeguar në doracakun për testim dhe janë përmbledhur në tabelën 1.



⁴ Në Irlandë në arsimin fillor realizohen testime të standardizuara vetëm për këtë lëndë (shënim i redaktorit).

Tabela 1: Shqyrtimi nocioneve që kanë të bëjnë me rezultatet e testeve të standardizuara

Nocioni	Domethënia e pikëve
Rezultati i përafërt	Është mbledhje e thjeshtë e pikëve për përgjigje të sakta. Ai përdoret pak në raportin për suksesin e fëmijës.
Pikët e shkallës standarde	Janë transformim i rezultatit të përafërt në shkallë tjetër dhe zakonisht sillet ndërmjet 55 dhe 145 pikë, ndërsa mesatarja është 100.
Shkalla e përqindjes	Shkalla e përqindjes e tregon përqindjen e fëmijëve të një moshe të grupit që ka fituar njësoj ose më pak pikë se fëmija. Ajo nuk e paraqet përqindjen e detyrave të testit në të cilët fëmija ka dhënë përgjigje të sakta.
Pikët e shkallës dhjetënivelëshe	Në dhënien e pikëve në sistem dhjetënivelësh numri 1 e paraqet kategorinë më të ulët, ndërsa numri 10 shkallën më të lartë. Këto burojnë nga shkallët standarde të pikëve. (Shih tabelën 3, fq. 56, për përshkrimet të cilat e shpjegojnë pikët e sistemin dhjetënivelësh.)

Gjatë marrjes së vendimeve për përparimin e të arriturave të fëmijës me rëndësi është të përdoren një sërë informacionesh për notim. Përcjellja e rregullt e arsimitari ndaj punës dhe pjesëmarrjes së nxënësit në orë, si dhe të dhënat e evidentuara për mësimin fëmijës, duhet ta plotësojnë rezultatin e testit të standardizuar. Arsimtarët shpeshherë (por jo gjithnjë) konsiderojnë se rezultatet e testeve i vërtetojnë vlerësimet dhe opinionet e tyre. Me rëndësi është që gjithashtu arsimtarët klasor ëtë konsultohen me arsimtarët e tjerë për mbështetje dhe/ose me arsimtarët lëndorë të sigurojnë pasqyrë më të saktë lidhur me përparimin dhe anët e dobëta dhe të fuqishme të fëmijës. Kjo ka rëndësi të veçantë gjatë përgatitjes së raporteve për prindërit.

Arsimtarëve shpeshherë u jepen këshilla që të mos mbështeten shumë në rezultatin e një testi të vetëm. Atyre u rekomandohet të jenë të kujdesshëm për shkak se duhet të merren parasysh faktorët vijues:

- Një test i standardizuar mund ta matë suksesin e ndonjë fëmije vetëm për atë test dhe vetëm për atë ditë, mirëpo kjo nuk është masë e sigurt për aftësinë e fëmijës.
- Në testet e standardizuara ekziston hapësirë e caktuar për gabim, që do të thotë se rezultatet mund të jenë gabim deri në ndonjë shkallë ose nën pikët e testit të fëmijës.
- Me kalimin e kohës suksesi i fëmijëve bëhet gjithnjë e më i qëndrueshëm.
- Në suksesin e testit të fëmijëve mund të ndikojnë edhe faktorë ekstern; për shembull; ndoshta fëmija nuk është ndier mirë ose ka qenë nervoz.
- Ndiham ndaj fëmijës në test ndoshta do t'i shtrembërojë rezultatet.
- Përkundër vigjilencës së arsimitarit mund të ndodh që ndonjë fëmijë të përshkruajë (kopjojë).
- Niveli i zhvillimit gjuhësor të fëmijës paraqet faktor të rëndësishëm për suksesin e testit. Për shembull, fëmija i cili ka aftësi të pakta për lexim mund të ketë vështirësi gjatë leximit të tekstit me pyetje të matematikës. Fëmijët të cilët nuk e kanë gjuhën angleze gjuhë amtare, testi i gjuhës për ta mund të mos jetë adekuat. Doracak i testimit do të ofrojë detaje lidhur me situatat në të cilat testet nuk janë të përshtatshme. (Arsimtarët gjithashtu mund ta përdorin letrën qarkore të Ministrisë së Arsimit 0138/2006 nga dhjetori i vitit 2006 "Mbështetja e notimit në shkollë fillore".)

Si mund të përdoren rezultatet e testeve të standardizuara?

Rezultatet e testeve të standardizuara në Irlandë zakonisht përdoren për këto qëllime:

- Të identifikohen fëmijët me vështirësi në mësim që të mund t'u sigurohet mbështetje e duhur, madje, nëse është e nevojshme, të përfshihet mbështetje e veçantë në mësim. Përkundër asaj se rezultatet e testeve mund të shërbejnë për përzgjedhje preliminare, megjithatë do të ketë nevojë edhe për testim plotësues diagnostifikues që ashtu të përcaktohen nevojat specifike arsimore të fëmijës. (Arsimtarët do të duhet t'i shfrytëzojnë *Udhëzimet për ndihmë të fëmijëve në mësim* (Ministria e Arsimit, 2000).
- Të identifikohen ata fëmijë me rezultate jashtëzakonisht të larta që për ta të mund të sigurohen përvoja adekuate në mësim. (Për t'iu ndihmuar fëmijëve të këtyllë, arsimtarëve mund t'u shërbejnë *Udhëzimet për arsimtarë për punë me fëmijët me aftësi të veçanta* (NCCA, 2007)).
- T'i informojnë prindërit për të arriturat dhe përparimin fëmijëve të tyre.

Testimi i standardizuar zakonisht konsiderohet si **NAM**, i cili jep tregues për suksesin e nxënësit në fund të një periudhe të caktuar arsimore. Testet e standardizuara shfrytëzohen edhe nga disa shkolla pas fillores, ku fëmijët transferohen pas përfundimit të shkollës fillore. Në këso raste, rezultatet e testit mund të shfrytëzohen që fëmijët të ndahen në grupe të kombinuara ose të identifikohen ata fëmijë të cilët kanë nevojë për mbështetje. Këshilla e dhënë se duhet pasur kujdes gjatë marrjes së vendimit në bazë të pikëve të një testi të vetëm të standardizuar tani është më e rëndësishme meqenëse kontributi është më i madh.

Testet e standardizuara gjithashtu mund të shfrytëzohen edhe për NSHM, me çka arsimitarit i sigurohen informacione të cilat janë të dobishme për planifikimin e orëve të mëtejme të matematikës dhe gjuhës. Për shembull, arsimtarët mund ta kontrollojnë një grup të rezultateve të paraleles që të shohin se a ka aty ndonjë rregull të dukshme ose ndonjë karakteristike, në veçanti gjatë shpërndarjes së rezultateve. Kjo mund t'i sigurojë arsimitarit informacione që ai mbi atë bazë t'i përshtatë metodat e tij mësimore, strategjitë për diferencim, përmbajtjen etj., me qëllim që kështu t'i përbushë nevojat arsimore të fëmijëve në mënyrë më

Shembull i aktiviteti 2.19. Interpretimi i rezultateve të testit të standardizuar për kontrollimin e aftësisë për lexim të gjuhës angleze

Fusha programore: **Gjuha**
Lënda mësimore: **Gjuhë angleze**
Niveli klasor: **Klasa e tretë dhe katërt**

Mund të ndodhë që pikët e fëmijës për lexim dhe kuptim të asaj që e ka lexuar të dallohen shumë mes vete; shih, për shembull, rezultatet e testit të Stiven O'Braenit (për klasën e tretë) të dhëna më poshtë.

Lexim / fjalor			Kuptimi i asaj që e lexon			Gjithsej lexim		
RP	SHS	SHPR	RP	SHS	SHPR	RP	SHS	SHPR
25	109	73	14	93	32	39	102	55

RP= Shkalla e përafërt SHS= Shkalla standarde SHPR = Shkalla me përqindje

Duke e vërejtur dallimin ndërmjet rezultateve të Stivenit, mësuesja e tij i bëri një vështrim doracakut për testim lidhur me interpretimin e pikëve.

Edhe pse e dinte se dallimet e këtu mund të paraqiten rastësisht, ajo e pyeste veten mos ndoshta ai mund të ketë vështirësi në lexim. Në fakt, për lexim Stivenit i kishte gjithsej 102 pikë në shkallën standarde, që sugjeron se ai kishte aftësi mesatare për lexim. Këtu është e dobishme të shihet dallimi ndërmjet pikëve të shkallës standarde. Nëse ato dallohen mes vete deri në 15 pikë – siç është rasti me Stivenin në lexim/fjalor dhe në kuptim të asaj që e lexon – atëherë është i mundshëm të bëhet dallim real në të arriturat. Prandaj mund të rekomandohet testim plotësues që do ta përcaktojë se a ka nevojë Stiveni për ndihmë. Gjithashtu duhet të vërehet se rezultati i përgjithshëm për lexim gjithsej mund të jenë tregues për nevojat arsimore të fëmijës, për shkak se ato paraqesin përmbledhje të pikëve për fjalor dhe kuptim të asaj që lexohet.

efektive. Këshilla e dhënë se duhet të jemi të kujdesshëm gjatë vendosjes në bazë të rezultateve të një testi të veçantë të standardizuar është më e rëndësishme aq më tepër kur duhet të merret një vendim i rëndësishëm.

Shembulli i aktivitetit 2.19. tregon se si interpretohen rezultatet e ndonjë grupi të caktuar të testeve të standardizuara për kontrollimin e aftësisë për lexim dhe për gjuhë angleze.

Si duhet të informohen prindërit për rezultatet e testeve të standardizuara?

Informimi i prindërve paraqet njoftim i tyre lidhur me notimin i cili është i dobishëm për fëmijën. Me rëndësi të veçantë në këtë rast është që arsimtarët të shfrytëzojnë gjuhë të tillë me çka rezultatet e testit të standardizuar do të jenë të kuptueshme për të gjithë prindërit. Mund të jetë në favor të theksohet se suksesi i fëmijës në testin e standardizuar nuk dallohet ose dallohet nga përparimi i fëmijës i notuar në mënyrë tjetër nga arsimtari, duke i përfshirë edhe detyrat e tjera të testeve, si dhe përmes përcjelljes së punës

së fëmijës. (Për informacione rreth metodave tjera të notimit shih Temën 2, fq. 14-52.)

Shkalla me përqindje mund të duket atraktive për shkak të thjeshtësisë së dukshme, mirëpo për t'ua shpjeguar prindërve dallimin ndërmjet përqindjes së caktuar dhe përqindjes së pikëve të marra nuk është gjithnjë e lehtë. Sfidë e njëjtë paraqitet edhe gjatë shpjegimit të dallimit ndërmjet rezultatit të përafërt dhe rezultateve të paraqitura në shkallën standarde. Ndoshta shumë më lehtë është të jepen informacione dhe të interpretohen shkallët dhjetënivelëshe, të cilat së bashku e integrojnë një përmasë të përqindjes së pikëve. (Termi Shkalla dhjetënivelëshe (dhjetore) buron nga Standardi DHJETË). Me rëndësi është që arsimtari të thirret në doracakun gjegjës për testim, ngase ai përmban tabela të cilat e paraqesin suksesin e fëmijës në këto mënyra të ndryshme.

Gjatë raportimit të prindërve për rezultatet e testit të standardizuar dhe në shpjegimin se çka nënkuptojnë ato pikë lidhur me të arriturat e fëmijëve të tyre, përshkrimet ver-

bale janë më se të dobishme. Tabelat 2 dhe 3 në faqen 63 japin pasqyrë të rezultateve të testit, gjegjësisht tregojnë se çka paraqesin ato rezultate në raport më të arriturat e fëmijëve. Doracakët gjithashtu u japin arsimtarëve informacione se është shumë me rëndësi që arsimtarët ta përdorin doracakun e përmendur gjatë shfrytëzimit të këtyre përshkrime-

ve. Në disa teste përshkrimet janë të ndërlidhura me shpërndarjen e pikëve të shkallës standarde me të cilat arsimtarët do të mund të informohen përmes raporteve të psikologëve. Përshkrimet e përdorura në tabelën 2 i reflektojnë ato që shfrytëzohen në testet standarde të normuara për nxënësit e shkollave fillore në Irlandë.

Tabela 2: Interpretimi i rezultateve të shkallës standarde për informimin e prindërve

Shtrirja e shkallës standarde	Shtrirja e shkallës dhjetënivelëshe	Përfshirja
130 e më shumë	Shumë lart mbi mesatare / Tepër e lartë	2% të nxënësve
120-129	Mbi mesatare / E lartë	7% të nxënësve
110-119	Mesatarisht e lartë	16% të nxënësve
90-109	Mesatare	50% të nxënësve
80-89	Mesatarisht e ulët	16% të nxënësve
70-79	Nën mesatare / E ulët	7% të nxënësve
Nën 70	Shumë më ulët së nënmesatarja / Tepër ulët	2% të nxënësve

Në tabelën 3 kemi paraqitje të ndryshme të rezultateve në pesë kategori në vend se në shtatë. Secili rresht mbi dhe nën mesatare e paraqet një të gjashtën e nxënësve, ndërsa rreshti me mesataren e tabelës e paraqet një të tretën e nxënësve.

Kjo qasje e paraqitjes së rezultateve e ka përparësinë e barazimit të rezultateve të shkallës dhjetënivelëshe me përshkrimin i cili mund të japë bazë të njohur për informimin e prindërve për të arriturat e fëmijëve të tyre.

Tabela 3: Interpretimi i rezultateve të shkallës dhjetënivelëshe për prindër

Shtrirja e shkallës standarde	Shtrirja e shkallës dhjetënivelëshe	Përshkrimi	Përfshirja
115 e më shumë	8-10	Shumë lart mbi mesatare	Një e gjashta më e mirë e nxënësve
108-114	7	Lart mbi mesatare	Një e gjashta e nxënësve
93-107	5-6	Mesatare	Një e treta e nxënësve
85-92	4	Mesatare e ulët	Një e gjashta e nxënësve
84 e më pak	1-3	Mesatare shumë e ulët	Një e gjashta më e dobët e nxënësve

Pavarësisht së cili rezultat për matje të pikëve përdoret, është shumë më me rëndësi që prindërit ta kuptojnë domethënien e rezultateve sesa atyre t'u jepet shpjegim i plotë për mënyrën sipas secilës janë nxjerrë pikët.

Shembujt e aktiviteteve 2.20. dhe 2.21. në faqet e ardhshme tregojnë se si do të mund t'u raportojnë arsimtarët prindërve për rezultatet individuale të fëmijëve në testet e standardizuara.

Shembull i aktivitetit 2.20.

Raportimi i rezultateve të testit të standardizuar për lëndën e matematikës

Fusha programore/
lënda mësimore: **Matematikë**
Niveli klasor: **Klasa e pestë dhe e gjashtë**

Najll e ka zgjidhë një test të standardizuar të matematikës në maj në fund të klasës së pestë.

Këto ishin rezultatet e tij:

Rezultati i përafërt	Pikë të shkallës standarde	Shkalla me përqindje	Pikë të shkallës dhjetënivelëshe
72	116	86	8

Kur nëna e Nialit ka ardhur në shkollë në fund të vitit shkollor që ta marrë raportin për suksesin vjetor të birit të saj, arsimtari Jamon ia ka shpjeguar rezultatet e testit. Ai i ka thënë se Niali ka treguar sukses shumë të mirë në test për shkak se rezultati 8 në shkallën dhjetënivelëshe paraqet mesatare të lartë. Ai ka qenë i ngjashme me rezultatet e testeve të standardizuara gjatë viteve të kaluara, si dhe me suksesin e Nialit në testet mësimore të përgatitura nga arsimtari.

Jamoni e ka përdorur elementin diagnostik të testit të standardizuar. Ai e ka njehsuar saktësisht “% e saktë” për secilën pjesë të testit, andaj ka mundur ta identifikojë zgjidhjen e problemeve si një fushe të cilës duhet t’i kushtohet vëmendje te Niali. Këto shifra janë përputhur me shënimet e tij të rregullta nga përcjellja e rregullt gjatë orëve. Nëna e Nialit ka pyetur se a mund ajo në ndonjë mënyrë t’i ndihmojë atij në shtëpi. Jamoni ia ka treguar disa strategji për zgjidhjen e problemeve të cilat Niali i ka përdorur në orë, andaj ajo do të mund t’ia nxisë ato strategji edhe kur t’i bëjë djali i saj detyrat e shtëpisë. Arsimtari ka shtuar se këtë rekomandim, si dhe rezultatet e testeve, do t’ia përcjellë arsimtarit i cili do t’i mbajë mësim Nialit në vitin e ardhshëm.

Shembull i aktivitetit 2.21.

Raportimi për rezultatet e testit të standardizuar për lexim në gjuhën angleze

Fusha programore: **Gjuha**
 Lënda mësimore: **Gjuha angleze**
 Niveli klasor: **Klasa e parë dhe dytë**

Ja rezultatet e Kjarës në një test të standardizuar për lexim në gjuhë anglezë në fund të klasës së parë kur ajo i kishte 6 vjet e 10 muaj.

Rezultatet e bazuara në nivel të klasës				Rezultatet e bazuara në nivel të moshës				Moshë gjatë të lexuarit	
RP	SHS	SHDHN	SHPR	RP	SHS	SHDHN	SHPR	RP	ML
18	77	3	6	18	87	4	19	18	5.08

*RP= Rezultati i përafërt SHS= Shkalla standarde SHPR = Shkalla me përqindje
 ML = Moshë gjatë të lexuarit SHDHN = Shkalla dhjetënivelëshe*

Zonja Runi i ka kontrolluar rezultatet e doracakut për testim. Për dilemat e saj ajo ka diskutuar me drejtorin e shkollës. Ata e kanë vërejtur se rezultatet e Kjarës të bazuara në moshë kanë qenë më të larta se rezultati i saj i bazuar në nivel klasor dhe kështu e kanë kuptuar se kjo ka ngjarë për shkak se moshë e Kjarës ka qenë më e vogël se moshë mesatare e nxënësve në fund të klasës së parë, ndërsa rezultatet e bazuara në moshë e marrin parasysh atë se a është ndonjë fëmijë nën ose mbi moshën mesatare për atë nivel klasor. Rezultatet e testit kanë dëshmuar qartë se Kjara ka probleme kur suksesi i saj krahasohet në nivel shtetëror me atë të fëmijëve të tjerë të klasës së parë. Zonja Runi dhe drejtori e kanë kuptuar se është mjaft e rëndësishme që të koncentrohen në pikët më të ulëta nga të dyja testet gjatë dhënies së rekomandimit sipas të cilit Kjara do të duhet të dërgohet për testime të mëtejshme diagnostike. Pastaj z-nja Runi ka pasur një takim me babain e Kjarës.

Ajo ia ka shpjeguar atij rezultatet, duke i thënë se ato dëshmojnë se ajo ka nevojë për ndihmë në mësimin e gjuhës angleze për shkak se rezultatet e saj do të klasifikohen si të ulëta gjegjësisht do të kenë mesatare të ulët. Zonja Runi i ka treguar se Kjara pas pushimeve verore do të takohet me arsimtarin i cili merret me ndihmën e nxënësve në mësim. Ai do ta udhëzojë atë në teste diagnostike të cilat do të japin pasqyrë më të qartë për nevojat e saj arsimore në këtë fushë.

Vazhdimësia e metodave

Kjo temë e prezanton vazhdimin e tetë metodave të notimit në disa prej të cilave rol kryesor ka nxënësi, siç është vetënotimi dhe më shumë metoda në të cilat rol kryesor ka arsimtari, duke i përfshirë këtu edhe detyrat dhe testet e përgatitura nga arsimtari si dhe testet e standardizuara. Secila prej këtyre metodave mund të japë informacione të cilat do t'i ndihmojnë arsimtarit të bëjë vlerësim të plotë për të mësuarit e programeve mësimore nga nxënësi si për **NSHM**, ashtu edhe për **NAM**.

Tabela 4 bën rezymë të **disa** karakteristikave të cilat duhet të merren parasysh gjatë shfrytëzimit të tetë metodave. Kolona *Planifikimi dhe organizimi* ka të bëjë me aktivitetet afatshkurtra, siç janë shpjegimi i qëllimit të notimit e deri te aktivitetet më afatgjate, siç janë ndihma e proceseve zhvillimore dhe e përvojave të fëmijëve. Kolona *Resurset* ka të bëjë me resurse reale, siç është koha, Përfundimisht, kolona *Anët e fuqishme* i prezanton disa lloje të përfitimeve gjatë zbatimit të secilës metodë.

Tabela 4: Disa karakteristika të cilat duhet të merren parasysh gjatë shfrytëzimit të tetë metodave

	Planifikimi dhe organizimi	Resurset	Anët e fuqishme
Vetënotimi	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegojeni qëllimin; vendosni se cilat informacione do të regjistrohen dhe ku do të regjistrohen. Merruni vesh për kriteret e suksesit. Zhvilloni aftësitë e fëmijëve për vetanalizë. 	<ul style="list-style-type: none"> Pyetje për përkujtim dhe instrumente për fëmijët. Koha e fëmijëve që ta analizojnë punën e tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> E nxit pavarësinë dhe motivacionin e fëmijës. Siguron informacione nga pikëpamja e fëmijës.
Biseda me nxënësi	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegojeni qëllimin, vendosni se cilat informacione do të regjistrohen dhe ku do të regjistrohen. Organizoni aktivitetet arsimore për të gjithë fëmijët. Zhvilloni aftësitë e fëmijëve për vetanalizë. Përdorni gjuhë adekuate gjatë bisedave. 	<ul style="list-style-type: none"> Shembull(j) i/të punimeve të fëmijëve. Koha për bisedë me fëmijën, prindërit ose kolegun (kolegët). 	<ul style="list-style-type: none"> Siguron informacione nga pikëpamja e fëmijës. Zhvillon lidhje ndërmjet shkollës dhe shtëpisë. Nxit kolegjalitet – duke mësuar dhe shkëmbyer përvoja me kolegët.
Notimi i portofolit	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegojeni qëllimin, vendosni se cilat informacione do të regjistrohen dhe ku do të regjistrohen. Zhvilloni aftësitë e fëmijëve për vetënotim dhe drejtim të bisedave. 	<ul style="list-style-type: none"> Materiale dhe/ose softuer për përpunim të portofolave. Hapësira për ruajtjen e portofolave. Koha për bisedë me secilin fëmijë lidhur me portofolin e tij. 	<ul style="list-style-type: none"> E nxit pavarësinë dhe vetëiniciativën e fëmijës . E mbështet vetënotimin. Ofron shembuj të punimeve të fëmijëve si material dëshmues për të mësuarit. Ofron informacione nga këndvështrimi i fëmijës.
Përgatitja e hartave mendore	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegojeni qëllimin, vendosni se cilat informacione do të regjistrohen dhe ku do të regjistrohen. Zhvilloni aftësitë e fëmijëve për përgatitje të hartave mendore. Zgjidhni harta adekuate mendore. 	<ul style="list-style-type: none"> Materiale dhe/ose softuer për përgatitjen e hartave mendore. Koha për interpretimin e hartave mendore. 	<ul style="list-style-type: none"> Siguron paraqitje vizuale për atë se si dhe çka mendojnë fëmijët. Siguron materiale lidhur me ndryshimet e të menduarit të fëmijës me kalimin e kohës.

	Planifikimi dhe organizimi	Resurset	Anët e fuqishme
Parashtrimi i pyetjeve	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegojeni qëllimin, vendosni se cilat informacione do të regjistrohen dhe ku do të regjistrohen. Formuloni llojet e ndryshme të pyetjeve. Përcaktojeni kohën për pyetje. 	<ul style="list-style-type: none"> Pyetjet të cilat nxisin të menduar më të ndërlikuar. Koha për shfrytëzimin e llojeve të ndryshme të pyetjeve me fëmijë të ndryshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> Siguron informacione të drejtpërdrejta kthyesë për të mësuarit e fëmijës. Zakonisht kërkon disa resurse konkrete. Modelon parashtrim të mirë të pyetjeve për fëmijët.
Vëzhgimi i punës së nxënësve nga arsimtari	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegojeni qëllimin, vendosni se cilat informacione do të regjistrohen dhe ku do të regjistrohen. Planifikoni detyra të përshtatshme për fëmijët të cilët do të vëzhgohen. Organizoni aktivitete për ata fëmijë që nuk do të vëzhgohen, që të mos pengojnë. 	<ul style="list-style-type: none"> Formularë ose fletë kontrolluese gjatë mbikëqyrjes. Koha për vëzhgim gjatë orës. 	<ul style="list-style-type: none"> Siguron informacione të drejtpërdrejta kthyesë për të mësuarit e fëmijës. Mund të jetë e planifikuar dhe spontane.
Detyra dhe teste të përgatitura nga arsimtari	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegojeni qëllimin, vendosni se cilat informacione do të regjistrohen dhe ku do të regjistrohen. Përgatitni pyetje dhe detyra për testin të cilat do të demonstrojnë kuptim ose aftësi të caktuar. 	<ul style="list-style-type: none"> Resurset për detyrat dhe testet e përgatitura nga arsimtari. Koha për vëzhgim gjatë orës. 	<ul style="list-style-type: none"> Siguron material për të mësuarit në kontekst (të detyrave). Siguron shembuj të punimeve të nxënësve si material dëshmues për mësimin (teste).
Testimi i standardizuar	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegojeni qëllimin; merruni vesh se kur do të mbahen teste gjatë vitit shkollor; vendosni se cilat informacione do të regjistrohen dhe ku do të regjistrohen. Lexoje doracakun për testim. Caktoni një ditë dhe një kohë të përshtatshme dhe organizojeni paralelen. Planifikoni aktivitetet për ata fëmijë të cilët nuk do ta zgjedhin testin. 	<ul style="list-style-type: none"> Librezë testi për secilin fëmijë. Doracak për testim. Koha e mbajtjes së testit. Koha e notimit dhe e interpretimit të rezultateve. 	<ul style="list-style-type: none"> I paraqet të arriturat në krahasim me suksesin në nivel shtetëror. Ndihmon të identifikohen anët e fuqishme dhe ato të dobëta individuale të fëmijëve.





TEMA 3:

**QASJE MË E AFËRT
NDAJ NSHM-SË
DHE NAM-IT**

Tema 3:

Qasje më e afërt ndaj NSHM-së dhe NAM-it

Në këtë temë krahasohen të dyja qasjet e notimit (të paraqitura në Temën 1), **NSHM** dhe **NAM**, kjo në bazë të aktiviteteve të përfshira në përkufizimin e notimit, që janë të dhëna në Temën 1 dhe më poshtë në tekst. Siç u paraqit në pika të shkurtra në Temën 1, këto aktivitete ndërthuren dhe shpesh ndodhin në mënyrë simultane.

Notimi paraqet proces të **grumbullimit, regjistrimit, interpretimit dhe shfrytëzimit** të informacioneve, si dhe proces të **raportimit** për përparimin dhe të arriturat e nxënësit në përvetësimin e diturive, aftësive dhe qëndrimeve.

Në këtë temë janë vënë edhe shembuj së bashku me qasjet për metodat e notimit të përshkruara në Temën 2. Diskutimi fillon me aktivitetin e parë për notim – *grumbullim të informacioneve*.

1. Grumbullimi i informacioneve

Grumbullimi i informacioneve për **NSHM** kryesisht paraqet pjesë të praktikës së orëve dhe nuk e ndërpret rrjedhën e mësimdhënies dhe mësimin. Për fëmijën një orë me pyetje dhe përgjigje me arsimtarin mund të paraqesë bisedë, mirëpo arsimtari i shkathtë nga ajo bisedë mund të grumbullojë informacione të vlefshme për notimin lidhur me atë se çka dhe si mëson fëmija. Një arsimtar për t'i dhënë mbështetje leximit shpjegon: *Unë vazhdimisht i vëzhgoj dhe i dëgjoj fëmijët dhe rregullisht bëj ndryshime në planet e mia që ta marr parasysh atë që e dëgjoj ose e vërej. Në shembujt vijues arsimtarët përshkruajnë se si ata pa imponime i grumbullojnë informacionet e notimit.*

Gjatë orës së dytë, kur punuam në shënjimin e dhjetëshve si numra decimalë, unë kërkova nga fëmijët ta bëjnë me hije presjen e decimaleve te pika e pestë e diagramit të fletës së tyre të punës. Pasi që i kontrollova disa përgjigje, e kuptova se shumica e paraleles nuk e kanë kuptuar atë nocion. Vazhdova ta shpjegoj më tej nocionin themelor duke përdorur ngjithëse të shiritave të kartonit me ngjyra. Nga pyetjet e mëtejme e vëreja se kjo mënyrë është më efektive. (Një arsimtar i nxënësve të klasës së tretë)

Gjatë leximit të punimeve me shkrim të fëmijëve në gjuhën angleze vëreja disa gabime gramatikore të bëra nga fëmijët. Planifikova aktivitete të caktuara dedikuara për mirësimin të gabimeve të tilla, duke e drejtuar vëmendjen vetëm në një gabim për secilin javë. (Një arsimtar i nxënësve të klasës së pestë)

Pasi që e vëreja se disa ushqime që i hanë fëmijëve për drekë kanë vlerë të ulët ushqyese, planifikova një

sërë njësisht mësimore në të cilat i integrova përmbajtjet e arsimit shoqëror, personal dhe shëndetësor, si dhe ato të shkencave natyrore për planifikimin dhe përgatitjen e ushqimit të shëndoshë. (Një arsimtar i fëmijëve më të rritur)

NSHM-ja e përfshin fëmijën në mënyrë aktive. Arsimtari duhet të bisedojë me fëmijët për qëllimet arsimore, gjë që përfshin diskutim me arsimtarin për atë se çka duhet të mësojnë ata. Gjatë kësaj fëmija së bashku me arsimtarin duhet të shqyrtojë se çka duhet të mësojë. Për shembull, ata mund t'i përcaktojnë elementet kryesore të një punimi të mirë me shkrim duke përdorur me këtë rast një fletë për notim analitik. Këto elemente të **NSHM-së** ofrojnë mënyra për përfshirjen e fëmijës në analizën dhe notimin e punës së tyre personale.

Përkundër kësaj **NAM-i** zakonisht atë e bën në fund të një periudhe kohore. Arsimtari mund të shfrytëzojë instrumente të llojllojshme për notim duke përfshirë edhe teste për kontrollimin e drejtshkrimit ose teste të standardizuara. Gjithashtu arsimtari mund të shfrytëzojë edhe metoda të tjera, siç janë parashtrimi i pyetjeve dhe vëzhgimi i punës së fëmijës. Ai ka rol udhëheqës në notim, ndërsa fëmija është i vetëdijshëm se po e notojnë. Më tej disa arsimtarë të caktuar i përshkruajnë disa mënyra për atë se si ata grumbullojnë informacionet përmes **NAM-it**.

Pas disa mësimëve të njëpasnjëshme për normanët, unë i dërgova fëmijët e klasës së pestë në vizitë të kështjellës sonë vendore normane. Paraprakisht u përgatitëm për vizitën që të mund t'i shohim disa nga detajet kryesore të ndërtesës. Kur u kthyem në shkollë, kërkova prej tyre t'i shënojnë përshtypjet e tyre nga kështjella, si dhe të theksojnë sa më shumë detaje në të cilat do të mund të kujtohen. (Arsimtar i nxënësve të klasës së katërt)

Pasi që disa javë e përpunuam temën "Njehsimi", fëmijëve të paraleles ua parashtrova disa detyra për zgjidhje dhe kërkova prej tyre ta zbatonin operacionin e njehsimit. Kjo më dëshmoi se përkundër asaj se pjesa më e madhe e tyre mirë e kuptojnë zbatimin e njehsimit, megjithatë ka nevojë që më shumë të punohet në aftësinë për llogaritje. (Arsimtar i nxënësve të klasës së pestë)

2. Regjistrimi i informacioneve të notimit

Qëllimi i notimit përcakton se çka do të regjistrohet dhe si do të regjistrohet. Arsimtari mundet që në mënyrë të drejtëpërdrejtë të shfrytëzojë një pjesë të madhe të informacioneve të grumbulluara nga **NSHM-ja** gjatë strukturimit dhe mbështetjes së fëmijës në mësim. Arsimtari mund të vlerësojë se cilat informacione të notimit janë të rëndësishme që

të mund të regjistrohen. Për shembull, ai nuk duhet t'i regjistrojë detajet e parëndësishme të diskutimit në një orë, por do të duhet ta regjistrojë pjesëmarrjen e papritur entuziaste të ndonjë fëmije i cili rrallëherë merr pjesë në diskutim. Po kështu arsimtari me siguri se nuk do t'i vërejë në mënyrë të hollësishme gabimet në punën e detyrave të matematikës, por mund të vërejë se një pjesë e madhe e paraleles ka nevojë për ndihmë plotësuese në zhvillimin e aftësive për llogaritje. Fëmija gjithashtu mund të regjistrojë informacione për përparimin e tij në mësim, kjo si pjesë e notimit të portofolit të tij.

Në rastin e **NSHM-së** rezultatet e një periudhe të caktuar arsimore zakonisht evidentohen nga arsimtari, përgatitja për përgatitje të raporteve dhe futen në dosjen e nxënësit. Shembujt e informacioneve të notimit të evidentuara në këtë mënyrë mund të përfshijnë rezultate të testit të standardizuar si dhe pikë të fëmijëve të marra në testet e përgatitura nga arsimtari.

3. Interpretimi i informacioneve të notimit

Njohuritë e arsimtarit nga puna e nxënësve të paraleles shfrytëzohen për interpretimin e informacioneve të tij të **NSHM-së**. Arsimtari vendos se cilat informacione janë të rëndësishme dhe si mund të shfrytëzohen në përmirësimin e mësimit të fëmijës. Informacionet e marra nga **NSHM-ja** mund të japin pasqyrë të hollësishme për të mësuarit e fëmijës dhe kështu t'i mundësojnë arsimtarit të marrë vendime më të informuara gjatë planifikimit të mësimit të diferencuar.

Fëmijët dhe prindërit e tyre mund të kontribuojnë në interpretimin e informacioneve të notimit. Aftësitë për vetënotim duhet zhvillohen te të gjithë fëmijët që ata të mund të notojnë se sa i kanë përvetësuar mirë aftësitë dhe dituritë. (Shih Temën 2, f 16-23) Kur informacionet kthyese i theksojnë kriteret për mësim të suksesshëm, atëherë u ndihmohet fëmijëve ta notojë punën e tyre dhe u japin udhëzime për punën e ardhshme. Prindërit gjithashtu mund të ndihmojnë që të krijohet një pasqyrë më e plotë për mësimin e fëmijës gjatë bisedës me arsimtarin, për atë se si mëson fëmija në shtëpi dhe për interesat të cilat ai i shfaq jashtë shkollës. Kjo mund të jetë e dobishme për arsimtarin me çka ai e njeh natyrën e mbështetjes që prindërit ua japin fëmijëve në përgatitjen e detyrave të shtëpisë.

Interpretimi i informacioneve të **NSHM-së** mund të varet nga natyra e ndonjë testi ose detyre. Në testet e standardizuara të matematikës dhe gjuhës, përveç pikëve të dhëna, shënohet edhe domethënia e tyre. Në tabelat statistike pikët e fëmijës kategorizohen sipas normave në nivel shtetëror ose sipas normave në nivel të klasës ose moshës së fëmijës. Arsimtari shfrytëzon gjuhë teknike në interpretimin e normave të këtyre dhe bën vlerësim profesional. Në interpretimin e informacioneve ai jep vlerësime të vlefshme dhe të besueshme të bazuara në prova të mjaftueshme. (Shih Temën 2, fq. 53-58). Për shembull, disa pikë të një nxënësi të caktuar të cilat dallojnë tepër nga suksesi i përgjithshëm paraprak i nxënësit në atë lëndë, meritojnë kujdes më të hollësishëm. Arsimtari gjithashtu mund ta kërkojë opinionin e kolegëve të tij lidhur me interpretimin e pikëve të testit. Detyrim profesional i arsimtarëve është që t'u ndihmojnë prindërve që t'i kuptojnë këto informacione.

4. Përdorimi i informacioneve të notimit

Qëllimi kryesor i **NSHM-së** është ta përmirësojë të mësuarit e përditshëm të fëmijës. Kur arsimtari të vërejë vështirësi të caktuara te fëmija ose kur të marrë të dhëna për mënyrat e mësimit të cilat i preferon fëmija, ai mund t'i shfrytëzojë informacionet e këtyra për ta adaptuar mësimin tij që t'i përshtatet fëmijës, ashtu siç është dhënë më poshtë:

Konsideroj se kur i vëzhgon fëmijët se si punojnë kam përshtypje se edhe unë mësoj diçka nga të mësuarit e tyre. Kjo mund të ketë lidhje me situatat kur Kjara nuk dëshiron të përfshihet në grupet punuese të cilat unë i përcaktoj ose kur pyetja e Shejnit më bën me dije se ai nuk e ka kuptuar atë që unë ua kam ligjëruar atë orë. Gjatë aktiviteteve të ardhshme në orët që vijjnë duhet të planifikoj t'i kushtoj më shumë vëmendje Shejnit. (Një arsimtar i nxënësve të klasës së dytë)

NSHM-ja duhet ta përfshijë edhe fëmijën edhe arsimtarin. Përveç marrëveshjes së ndërsjellë lidhur me qëllimet arsimore dhe kriteret për të arriturat, arsimtari gjithashtu u jep fëmijëve informacione kthyese. Informacionet kthyese të cilat fokusohen në mësim ose në detyrën rrjedhëse na bëjnë me dije për hapat vijues, për fazat e arritjes dhe sfidat, por edhe kanë ndikim pozitiv ndaj mësimit të fëmijëve.

Kur z-nya Rajan m'i jep rezultatet e testeve të mia, ajo gjithnjë më jep edhe vërejtje për diçka që unë e kam shkruar mirë, mirëpo më tregon edhe për mënyrat se si mund ta përmirësoj shkrimin tim herëve të tjera. Unë dëshiroj të di se si mund ta përmirësoj punën time. (Keti, klasa e pestë)

Zhvillimi i aftësive të fëmijëve për vetënotim është një proces gradual i cili mund të fillojë qysh në moshën më të hershme. Kur arsimtari i pyet fëmijët në një rën nga klasat fillestare se çka është ajo që atyre u pëlqen më së shumti në punën e tyre ose në punën e fëmijëve të tjerë, ai në fakt i ndërmer hapat e parë në zhvillimin e aftësive për notimin e tyre.

Të gjitha informacionet duhet të shpijnë drejt përmirësimit të mësimit të fëmijës. Vetë mënyra se si përdoren informacionet është e ndërlidhur me qëllimin parësor të aktivitetit të notimit. Qëllimi i **NAM-it** shpeshherë shfrytëzohet për ta përcaktuar shkallën në të cilën realizohen qëllimet e programit të mësimdhënies. Arsimtari mund t'i përdorë informacionet e këtyra në mënyra të ndryshme brenda planifikimit të hapave tjerë të arsimimit të fëmijës. Për shembull, informacionet e notimit mund të tregojnë se ka nevojë për ripërpunim të përmbytjeve për ndonjë nocion të caktuar matematikor ose në rast se ka nevojë t'u kushtohet më shumë vëmendje aftësive të të kuptuarit. Informacionet e këtyra i shërbejnë arsimtarit nëse i grumbullon ato gjatë vitit shkollor. Informacionet të cilat i grumbullon në fund të vitit shkollor gjithashtu janë të dobishme për arsimtarin gjatë planifikimit të programit për vitin e ardhshëm shkollor. Informacionet e grumbulluara të testimit të standardizuar mund të përdoren për planifikimin e aktiviteteve për gjuhë dhe matematikë në nivel të shkollës. Një drejtor e bëri këtë koment:

Së bashku më një anëtar të kolegjiut të shkollës, i cili është përgjegjës për programin mësimor të matematikës, i kontrollova rezultatet e testeve të standardizuara të cilat u zbatuan në matematikë. Nga kjo na u bë e qartë se aftësitë për llogaritje në nivel të shkollës nuk janë aq të mira, prandaj e ftuam këshilltarin i cili na ndihmoi të formulojmë strategji për përmirësimin e gjendjes. Këta strategji i zbatuam këtë vit, duke u fokusuar në ndërhyrjet në klasë të parë, të dytë dhe të tretë.

Informacionet e **NAM-it** shfrytëzohen për ta përgatitur raportin për ndonjë fëmijë të caktuar, në të cilin jepen informacione për bisedën e arsimtarit me prindërit lidhur me anët e forta dhe të dobëta të mësimin të fëmijës.

5. Raportimi për informacionet e notimit

Arsimtarët dhe fëmijët për çdo ditë i shkëmbejnë informacionet e **NSHM-së**. Fëmijët vazhdimisht ua përcjellin arsimtarëve informacionet. Kjo gjë arsimtarëve mund t'u paraqesë sfida për përshtatjen e mënyrave të shumfishta për komunikim me fëmijët dhe kështu ta kuptojnë se çfarë domethënie kanë informacionet për secilin fëmijë. Zhvillimi i aftësive për vetënotim dhe përdorimi i rregullt i portofolave, fletëve për vlerësim analitik dhe ditarëve për mësim, i aftëson fëmijët të përcjellin informacione nga notimi – informacione për të cilat arsimtarët mund të reagojnë. (Shih Shtojcën A, fq. 78-79).

Për shembull, për disa informacione të këtylla prindërit informohen përmes detyrave të shtëpisë. Kjo mundëson vazhdimësi të mësimin në shkollë dhe në shtëpi. Arsimtarët mund t'ua bëjnë me dije prindërve disa metoda me të cilat ata do të mund t'u ndihmojnë fëmijëve gjatë mësimin në shtëpi, veçanërisht përmes aktiviteteve për zhvillimin e shkathësive gjuhësore dhe atyre të matematikës. Arsimtarët gjithashtu rregullisht mund t'i informojnë fëmijët, prindërit, arsimtarët e tjerë, si dhe profesionistët tjerë relevantë, lidhur me procesin e notimit.

Informacionet që kanë të bëjnë me **NAM-in** zakonisht prezantohen në mbledhjet prindërore, në librezat e nxënësve, në mbledhjet e kolegjiut të arsimtarëve etj. Arsimtarët mund t'ua interpretojnë prindërve rezultatet e notimit duke i udhëzuar se si mund t'i përdorin ato për përmirësimin e mësimin të fëmijëve. Prindërit, gjithashtu mund të reagojnë në rezultatet e notimit. Në këtë mënyrë mundësohet një proces i dyanshëm ndërmjet arsimtarit dhe prindit.

Ekziston një proces i vazhdueshëm përmes të cilit përvoja formale e mësimin të fëmijës në shkollë bashkëvepron me përvojën jo aq formale zhvillimore të përvetësuar në shtëpi dhe në familje. (Planet dhe programet mësimore për shkollë fillore, Hyrje, fq. 21)

Në këtë temë janë definuar dhe përshkruar dy qasje komplementare të notimit: *Notimi për shkak të mësimin* dhe *Notimi i asaj që është mësuar*, të cilat u shtohen informacioneve për notim të prezantuara në *Planet dhe programet mësimore për shkollë fillore*. Të dyja qasjet së bashku u mundësojnë arsimtarëve të dhëna për përpërimin dhe të arriturat e nxënësve në mësim. Informacionet e këtylla u mundësojnë arsimtarëve të marrin vendime për përshtatjen më

efektive të mësimin drejt nevojave mësimore të fëmijëve. Në esencë, **NSHM** dhe **NAM** u mundësojnë arsimtarëve të krijojnë mjedis më të përshtatshëm për mbështetje në të cilin fëmijët gjithnjë e më tepër motivohen për të mësuar.



TEMA 4:

**POLITIKA
SHKOLLORE
E NOTIMIT**

Tema 4: Politika shkollore e notimit

Qëllimi i kësaj teme është t'u ndihmojë shkollave në krijimin e politikës së tyre për notim. Në Ligjin për arsim (prej vitit 1998) parashihet që secila shkollë ka për detyrë të përgatisë plan shkollor.


Plani shkollor paraqet dokument për filozofinë arsimore të shkollës, për qëllimet e saj si dhe propozon mënyrë se si të arrihen ato. Ky dokument i përfshin të gjitha planet dhe programet mësimore si dhe organizimin e resurseve të shkollës... (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 1999, fq. 8)

Andaj, zhvillimi i politikës shkollore të notimit është vënë në kontekst më të gjerë të zhvillimi dhe planifikimit të shkollës dhe e ndjek modelin e planifikimit zhvillimor të shkollës të paraqitur në diagramin 4. Informacionet plotësu-ese për këtë model mund të gjenden në ueb-faqen e School Development Planning Support (Plani për Mbështetje të Zhvillimit të Shkollave (Fillore)) (SDPS) <http://www.sdps.ie>.

Procesi i planifikimit është ciklik dhe u mundëson shkollave të përfshihen në fazën e cila është relevante për gjendjen e tyre. Disa shkolla tashmë e kanë përgatitur politikën e tyre për notim dhe ndoshta janë në fazë të rishqyrtimit të politikës së tyre në aspekt të këtyre drejtimeve, ndërsa shkollat e tjera mund të jenë ende në fazën e përgatitjes së draftit.

Me rëndësi është se të gjithë anëtarët e kolegjiut arsimor duhet të përfshihen në zhvillimin, zbatimin dhe rishqyrtimin e politikës së notimit. Gjithashtu me rëndësi është që politika e formuluar nga shkollat të vlerësohet dhe të rishqyrtohet rregullisht që në vazhdimësi të mund t'i përmbushë nevojat e ndryshueshme të shkollave dhe nxënësve të tyre. Prindërit gjithashtu duhet të përfshihen në politikën e notimit. Kjo e zhvillon ndjenjën e pronësisë lidhur me politikën dhe mundëson implementim më efektiv. Ngjashëm me të gjitha llojet e tjera të politikave, politika shkollore e notimit i reflekton vlerat esenciale dhe karakterin e shkollës.

Diagrami 4: Modeli i planifikimit zhvillimor të shkollës



Përmbajtja e politikës për notim

Ligji për arsim (1998) kërkon që shkollat *regullisht t'i vlerësojnë dituritë e nxënësve dhe t'u dorëzojnë atyre dhe prindërve të tyre raporte periodike për rezultatet e evaluimit*. Për ta përmbushur këtë detyrim, shkollat përgatisin procedura zhvillimore të cilat sigurojnë përshkrim të saktë të përparimit të të arriturave të fëmijëve. Komponentët si, kur dhe ku të këtyre procedurave janë ekspozuar në pika të shkurt-ra në politikën e shkollës për notim.

Thënë në përgjithësi, politika shkollore e notimit përmban paraqitje me shkrim të qëllimeve dhe në pika të shkurtra përcakton se si do ta shfrytëzojnë shkollat notimin që t'u dalin krah fëmijëve, arsimtarëve, prindërve dhe subjekteve të tjera relevante. Ai dokument mund të përfshijë pasqyrim të shkurtër të:

- mënyrës së krijimit të politikës;
- lidhshmërisë së politikës me dispozitat për misionin dhe karakterin e shkollës;
- qëllimin e politikës;
- rolin dhe përgjegjësitë e kuadrit për atë politikë;
- përmbajtjen e politikës – procesin e notimit në shkollë;
 - qëllimet e notimit;
 - metodat e notimit (grumbullimi i informacioneve nga notimi);
 - interpretimi, regjistrimi, shfrytëzimi dhe raportimi për informacionet e notimit;
- implikimet për trajnimin e kuadrit dhe për resurset;
- procedurat për rishqyrtim dhe evaluim.

Kjo pjesë është adaptuar nga dokumenti *Pyetjet që nxisin zhvillim të një politike për notim* i cili gjendet në ueb-faqen e SDPS-së (Primary) në www.sdps.ie/policies/Assessment.doc.

Politika e notimit gjithashtu duhet të japë shpjegime për atë se kur dhe si do ta shfrytëzojë shkolla TIK-në në notimin e fëmijëve, në regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave të notimit dhe për shkakun i cili e përcakton këtë proces.

Pyetjet që mund të ndihmojnë në përgatitjen e politikës së notimit gjenden në ueb-faqen e SDPS-së (Primary) në <http://www.sdps.ie>. Është me rëndësi të thuhet se politika duhet t'u referohet të gjitha aspekteve të cilat u theksuan më lart. Detajet e procesit të notimit duhet të paraqesin element kryesor të politikës. (Shih komponentin e pestë e theksuar më lart në pasqyrën e shkurtër). Nga ky këndvështrim politika duhet të japë përgjigje në pyetjet vijuese për praktikën e shkollës në notimin e mësimit të fëmijëve:

- Pse duhet të notohet mësimi i fëmijëve?
- Çka duhet të notohet?
- Kur duhet të realizohet notimi?
- Si duhet të notohet mësimi i fëmijëve?
- Ku duhet të regjistrohen/evidentohen të dhënat e notimit?
- Si duhet të regjistrohen/evidentohen të dhënat e notimit?
- Kush duhet të informohet për të dhënat e notimit?

- Si duhet të informohen subjektet e tjera për të dhënat e notimit?
- Sa kohë duhet të ruhen të dhënat e notimit?

Më poshtë në këtë temë jepen përgjigjet e pyetjeve të parashtruara. Në të janë theksuar plotësisht edhe implikimet e normës ligjore ndaj politikës dhe praktikës.

Pse duhet të notohet mësimi i fëmijëve?

Siç u paraqit në pika të shkurtra në Temën 1, notimi është pjesë e mësimit dhe mësimit të mirë. Ai i siguron arsimtarit informacione për të marrë vendime për atë se çka dhe si mëson fëmija. Nga ana tjetër informacionet e këtuja i mundësojnë arsimtarit t'i përcaktojë hapat e ardhshëm të përparimit të mësimit të fëmijës dhe që në mënyrë adekuate t'i përshtatë strategjitë dhe aktivitetet e veta arsimore. Përdorimi i informacioneve të notimit për përparimin e mësimit dhe mësimit mund të kontribuojë për kënaqësi më të madhe nga mësimi dhe përvojë interesante për fëmijën, por njëherazi mund ta rrisë edhe përvojën e pasur dhe të dobishme profesionale të arsimtarit.

Çka duhet të notohet?

Politika shkollore e notimit duhet t'i kushtojë vëmendje secilës fushë programore/lëndë mësimore të *Planeve dhe programeve mësimore për shkolla fillore* dhe t'i përfshijë dituritë dhe aftësitë të cilat i përvetëson fëmija, qëndrimet dhe vlerat të cilat i zhvillon si dhe prirjet të cilat i shfaq. Me rëndësi është të theksohet se në të gjitha fushat programore/lëndë mësimore duhet të theksohen metodat e qëlluara. Disa metoda janë më të përshtatshme për qëllime të caktuara të notimit dhe për lëndë të caktuara mësimore, siç është theksuar në Temën 2 të këtyre udhëzimeve.

Vendimi se çka duhet të notohet bazohet në qëllimet e programeve mësimore të secilës lëndë, si dhe në atë me çka arsimtari e ka për qëllim t'u ndihmojë fëmijëve të mësojnë. Arsimtari përdor metoda adekuate për notim që kështu ta matë nivelin sa i ka arritur fëmija ato qëllime. (Shih shembuj të metodave të notimit në Temën 2.)

Kur duhet të realizohet notimi?

Notimi paraqet proces të vazhdueshëm gjatë tërë përvojës së fëmijës në shkollë fillore. Ky proces formësohet sipas moshës së fëmijës dhe sipas fazës së arsimit dhe zhvillimit të tij. Këndvështrimi i fëmijës drejt botës dhe përvoja e tij në mësim janë më shumë holistike (tërësore) në klasat e para të shkollës fillore. Në këtë fazë të ndarjes së mësimit në lëndë të ndryshme mësimore për fëmijën thuhet nuk ka fare rëndësi. Programet mësimore e theksojnë domethënien e përvojave të ndërlidhura arsimore për fëmijët më të vegjël dhe konsiderojnë se me rritjen e fëmijëve edhe mësimi lëndor bëhet më i kuptueshëm për ta. Politika shkollore e notimit duhet ta pasqyrojë zhvillimin e këtyre të ndryshmeve për atë se si i qasen dhe e përjetojnë fëmijët mësimin, ndërsa metodat e notimit që i përdor shkolla duhet të dallohen në fazë të ndryshme të zhvillimit të fëmijëve. Gjithashtu politika e notimit duhet të sigurojë se gjykimi i mësimit dhe zhvillimit të fëmijëve duhet të bëhet gjatë periudhave të caktuara mësimore në vend që të jetë sporadik, ndërsa informacionet e notimit të përdoren që të intervenohet dhe të jepet mbështetje e nevojshme lidhur me fazën arsimore të fëmijës.

Duke i pasur parasysh dispozitat e Ligjit për arsim (1998) dhe ato të Ligjit për persona me nevoja të posaçme arsimore (2004), shkolla duhet t'i përmbushë nevojat arsimore të të gjithë fëmijëve, duke i përfshirë edhe ata me pengesa në zhvillim ose me nevoja të posaçme mësimore. Prandaj politika shkollore e notimit duhet ta marrë rolin e notimit diagnostik, t'i specifikojë instrumentet diagnostike që duhet të përdoren si dhe afatet kohore për ndërhyrje. Në të njëjtën mënyrë duhet të specifikohen edhe procedurat shkollore për identifikimin dhe përmbushjen e nevojave të fëmijëve me aftësi të veçanta. Sipas dispozitave të Ligjit për arsim të fëmijëve me nevoja të posaçme (2004), duhet kthyer plan individual arsimor për notim të secilit fëmijë me nevoja të posaçme. Politika shkollore e notimit duhet t'i përcaktojë procedurat për përgatitjen dhe zbatimin e këtij plani për mbështetjen e arsimimit të fëmijës. Në përgatitjen e planit arsimor patjetër duhet të konsultohen prindërit e fëmijës, Organizatori i Nevojave të Posaçme Arsimore (SENO) i cili është përgjegjës për ndonjë shkollë të caktuar si dhe *personat tjerë për të cilët drejtori konsideron se janë adekuatë*. (EPSN Act, 2004, Section 9 (a))

Notimi i klasave fillestare

Notimi në klasat fillestare paraqet pjesë joformale natyrore të bashkëveprimeve të arsimtarit dhe fëmijës. Një pjesë e madhe e notimit bëhet përmes përcjelljes / vëzhgimit të fëmijës, bisedave me fëmijën dhe përmes dëgjimit aktiv të fëmijës në situatat e ndryshme arsimore.

Meqenëse moshë e hershme siguron bazë për mësim të mëtutjeshëm, me rëndësi është që sa më shpejt të identifikohen fëmijët me vështirësi në mësim. Për ta mundësuar këtë, shkolla duhet të implementojë politikë kontrolluese të testimit të vitit të dytë shkollor. Kontrolli përfshin përcjellje të fëmijëve nga arsimtari dhe zbatim të testeve grupore dhe individuale për mësim të hershëm të gjuhës dhe matematikës, si dhe për zhvillim të shkathhtësive. Informacionet e marra përmes testeve të këtyra kontrolluese së bashku me përcjelljen e përditshme të fëmijëve të vegjël, mundësojnë notim më të saktë të anëve të fuqishme dhe të nevojave të fëmijës. Kjo është shumë me rëndësi për fëmijët e vegjël kur përparimi zhvillohet sipas një tempore të zakonshme.

Kontrolli mundëson identifikim të hershëm të vështirësive në mësim dhe mundëson komunikim efektiv me prindërit e fëmijës. Identifikimi i hershëm i mundëson arsimtarit të organizojë mbështetje të caktuar të bazuar në *Modelin e fazës së intervenimit* (nga Shërbimi Shtetëror Arsimor i Psikologëve). Ky model e përfshin punën e arsimtarit me prindërit e fëmijës, konsultimet me psikologun nga Shërbimi Shtetëror Arsimor i Psikologëve (NEPS) dhe, në rast se ka nevojë, organizim të mbështetjes në mësim ose në mësimdhënien e resurseve dhe/ose qasje në terapi të llojllojshme. *Udhëzimet për mbështetje në mësim* (2000) sigurojnë informacione për përgatitjen e plotë të planit mësimor të shkollës dhe e theksojnë domethënien e implementimit të programeve për ndërhyrje në moshë të re.

Udhëzimet më të hollësisht për notimin e moshës së re do të botohen si pjesë e Kornizës për mësim të hershëm të vitit 2008.

Notimi i klasave të mesme dhe atyre më të larta

Si edhe me klasat më të ulëta, metodat e notimit të fëmijëve të klasave të mesme dhe të larta duhet të paraqiten në politikën e shkollës. Gjatë kësaj duhet të dokumentohen planet për testim të standardizuar në shkollë. **Shkollat duhet të përmbushin minimumin e kërkesave për zbatimin e testeve të standardizuar të gjuhës dhe matematikës në fund të klasës së parë/në fillim të klasës së dytë dhe në fund të klasës së katërt/fillim të klasës së pestë.** Politika e notimit duhet të përcaktojë se cilat teste do të përdoren, kur do të zbatohen dhe si do të shfrytëzohen rezultatet.

Përcaktimi i kohës për testim, pa marrë parasysh se a është në fillim ose në fund të vitit shkollor, do të varet nga qëllimi i testimit. Sa më herët që bëhet notimi për qëllime diagnostike, aq më herët rritet mundësia e intervenimit, gjë që është në favor të fëmijës. Testimi në fillim të vitit shkollor u mundëson shkollave t'i planifikojnë ndërhyrjet e duhura për fëmijë të caktuar, ndërsa testimi në fund të vitit shkollor u mundëson shkollave të marrin vendime lidhur me shpërndarjen e nxënësve nëpër paralele dhe mundëson përparim të tyre duke u bazuar në rezultatet e notimit. Edhe pse përcaktimi i kohës për testim bëhet nga arsimtarët, megjithatë përfshirja e elementeve të ndryshme të programeve mësimore mund të shkaktojë probleme në përcaktimin e kohës për realizimin e testeve gjatë vitit shkollor. Sidoqoftë qëllimi i notimit duhet të ketë rol vendimtar.

Si duhet të notohet mësimi i fëmijëve?

Informacionet e grumbulluara përmes metodave të ndryshme të notimit, gjatë një periudhe të caktuar kohore mund t'i ndihmojnë arsimtarit të fitojë pasqyrë të qartë për përparimin dhe të arriturat e fëmijës. Tashmë siç u theksua, kjo në veçanti ka të bëjë me fëmijët më të vegjël, ngase mësimi i tyre në masë të madhe është i lidhur me situatën konkrete për shkak se informacionet për notimin (përfshirë këtu edhe rezultatet e testeve) janë më pak të besueshme sesa të fëmijët më të rritur. Njohja e kontekstit në të cilin realizohet notimi e pasuron interpretimin e informacioneve të grumbulluara nga arsimtari. Kjo mundëson që ai më lehtë ta kuptojë procesin e mësimin nga këndvështrimi i fëmijës.

Pjesa e 2-të e këtyre udhëzimeve i siguron shkollës informacione për një sërë metodash të notimit. Me rëndësi të veçantë është që metodat e zgjedhura të jenë adekuate me qëllimin e notimit dhe me moshën (fazat e zhvillimit të fëmijës). Ligji për status të barabartë (2000) gjithashtu ka implikime për shkollat në kryerjen e zgjedhjes së këtyre. Ky ligj mbështetet në barazi dhe ndalon lloje të caktuara të diskriminimit, siç është për shembull ai fetar, i moshës, invaliditetit ose përkatësisë etnike. Prandaj metodat e notimit të cilat përdoren për grumbullim të informacioneve për fëmijët nuk kanë të drejtë që të bëjnë çfarëdo diskriminimi ndërmjet tyre. Shkollat do të duhet të njohohen me ndikimin e kontekstit të kulturës dhe të gjuhës së notimit dhe të orvaten të mundësojnë që notimet të realizohen në rrethana adekuate për fëmijët. Për shembull, kuadri arsimor duhet t'i identifikojë dhe t'u kushtojë vëmendje atyre aspekteve të notimit të cilat kanë domethënie të veçantë për fëmijët me nevoja të posaçme arsimore, si dhe të mundësojë alternativa adekuate nëse ka nevojë për to.

Për disa fëmijë, arsimtari ndoshta do të duhet t'i shqyrtojë/studiojë mënyrat për notimin e përparimit dhe të arriturave të cilat janë mjaft të ndjeshme për nivelin e aftësive të secilit fëmijë. Kjo mund të përfshijë vëmendje me të madhe të mënyrës se si fëmija e përjeton dhe reagon ndaj ndonjë aktiviteti të caktuar ose dhënia e kohës plotësuese fëmijës që ta përfundojë ndonjë aktivitet të caktuar. Në mënyrë alternative kjo mund ta përfshijë edhe atë fëmijë i cili ka nevojë për më pak ndihmë që ta përfundojë ndonjë aktivitet të caktuar. Më shumë informacione për notimin e nxënësve me pengesa të përgjithshme për mësim mund të gjenden në *Udhëzimet e arsimtarëve të nxënësve me pengesa të përgjithshme në zhvillim – Hyrje* (NCCA,2007), dhe në uebfaqen e NCCA-së www.ncca.ie/uploadedfiles/Publications/SEN_introduction.pdf.

Ku duhet të regjistrohen/evidentohen të dhënat e notimit?

Në plotësimin e dispozitave të Ligjit për arsim (1998) shkollat parashtojnë dhe mbajnë evidencë të veçantë për arsimimin e fëmijëve derisa ata i ndjekin mësimet në shkollë. Ata u dorëzojnë prindërve raporte të notimit të cilat përmbajnë informacione të sakta dhe qasje të qartë lidhur me përparimin dhe të arriturat e fëmijëve. Shkollat i mbajnë tre lloje të evidencave:

- shënime të përditshme të cilat i mbajnë arsimtarët;
- dosje për nxënësit;
- librezat e nxënësve.

Shënime të përditshme të cilat i mban arsimtari

Arsimtari zakonisht mban shënime të përditshme për observimet, vërejtjet, ndodhitë etj., të cilat ndodhin në orët e mësimi dhe në oborrin e shkollës. Ky lloj i shënimeve i siguron arsimtarit informacione plotësuese për fëmijën dhe i ndihmon që në mënyrë më efektive t'i përmbushë nevojat e tyre individuale arsimore. Ky lloj i evidencës jep informacione për organizimin e orëve të arsimtarit

Dosja e nxënësit

Dosja e nxënësit përdoret nga arsimtarët që të shënojnë informacione për të gjitha aspektet e mësimi të fëmijës. Dosja paraqet historikun konciz arsimor për përparimin dhe për të arriturat e fëmijës gjatë vitit shkollor, andaj duhet krijuar dosje për secilin nxënë. Në të ruhen dokumente nga arsimtari i klasës, arsimtari për mbështetje në mësim dhe arsimtari për resurse (kudo që është e zbatueshme). Funkcionet kryesore të dosjes së nxënësit janë:

- t'u jepet arsimtarëve dhe fëmijëve mbështetje në përcjelljen dhe strukturimin e mësimi;
- të sigurojë informacione për përgatitjen e raporteve për prindërit;
- të sigurojë informacione për arsimtarët të cilët më vonë do t'i japin mësim fëmijës.

Dosja e nxënësit i përfshin anët e fuqishme të nevojave të fëmijës, përparimin të cilin e arrin ai dhe secilën fushë të arsimit dhe të zhvillimit të cilës duhet t'i kushtohet vëmendje. Në dosjen e nxënësit mund të futen edhe informacione të tjera të dobishme dhe relevante, siç janë detajet për kontakte me shtëpinë, regjistrimi në shkollë, evidenca

për ardhjen e rregullt nëpër orë, historiku i gjendjes shëndetësore (në rast se është e nevojshme), informacione lidhur me përvojën parashkollore (nëse janë siguruar nga shkolla në të cilën kalon fëmija) dhe materiale me rezultate të notimeve (për shembull, zgjidhja e test-librezave të standardizuara). Shkolla mund të zgjedhë ta orientojë dosjen e nxënësit në formë me shkrim (në fashikuj) ose në formë elektronike. Nëse mbahet dosje elektronike, ajo duhet të printohet në fashikull të posaçëm.

Libreza e nxënësit

Libreza e nxënësit paraqet element të rëndësishëm të dosjes së nxënësit; në të regjistrohen informacionet më të rëndësishme dhe më karakteristike për përparimin arsimor dhe për të arriturat e fëmijës (duke përfshirë edhe interesat, anët e fuqishme dhe nevojat). Qëllimi kryesor i librezës së nxënësit është informimi i prindërve përmes një forme gjegjëse që ata të mund t'i shfrytëzojë informacionet e tilla për t'u ndihmuar fëmijëve të tyre në mësim që kështu ta përforcojnë lidhjen ndërmjet shkollës dhe shtëpisë.

Libreza e nxënësit mundëson regjistrim të informacioneve të notimit dy herë në vit. Në librezat e regjistrojnë shënime të tyre të gjithë ata që i japin mësim fëmijës. Rezultatet e notimit të fëmijëve regjistrohen që të lehtësohet njoftimi i prindërve, arsimtarëve dhe subjekteve të tjera të interesuara për mësimin e fëmijës lidhur me informacionet e dobishme dhe më relevante për përparimin e fëmijës. NCCA-ja aktualisht punon së bashku me shkollat në përgatitjen e formularëve të librezave të nxënësve në nivel shtetëror.

Si duhet të regjistrohen/evidentohen të dhënat e notimit?

